

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

110–VJET ALFABET SHQIP

(Aktivitete të mbajtura më 21–22.11.2018 në Shkup dhe Manastir)

23

Bashkëorganizatorë:



Shkup, 2018

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 23 – 2018
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Prof. dr. Sevdail Demiri

Këshilli redaktues:
Prof. dr. Xhevat Lloshi
Prof. dr. Hysen Matoshi
Prof. dr. Sabile Basha–Keçmezi
Prof. dr. Izaim Murtezani
Dr. sc. David Hosaflook
Mr.sc. Nora Maliqi
Nuer Arslani

Copyright©ITSHKSH, 2018
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978-608-4653-82-0

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

110–VJET ALFABET SHQIP

(Aktivitete të mbajtura më 21–22.11.2018 në Shkup dhe Manastir)

23

SCUPI

Shkup, 2018



TRYEZA E LËNDËS:

PARATHËNIE.....	7
Skender Asani: ...NJË DITË URIMI DHE FALËNDERIMI.....	17
David Hosaflook: “ALFABET I DASHUR, ATDHE I DASHUR”, ORIGJINA E PANJOHUR E “HIMNIT TË ALFABETIT” (1909) ...	23
Skender Asani: VULËN E KOMBNDËRTIMIT TË SHQIPTARËVE E BËRI KONGRESI I MANASTIRIT	37
Nuer Arslani: “GJUHA ËSHTË RROJTJA A VDEKJA E KOMBIT”!	41
Floresha Dado: TË RISHOHIM NË NJË NDRIÇIM MË TË QARTË RAPORTIN ME HISTORINË TONË.....	47
Marenglen Verli: NË KONGRESIN E ALFABETIT U HODH IDEJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË.....	51
Hysen Matoshi: NJË PËRVJETOR MES PËRVJETORËSH	55
Sabit Syla: ME ALFABETIN E MANASTIRIT U BOTUAN KRYEVEPRA KOMBËTARE	59
Shaban Sinani: PROCESI I LATINIZMIT GRAFEMATIK TË SHQIPES DERI NË KONGRESIN E MANASTIRIT	65
Beqir Meta: RRUGËTIMI DREJT KONGRESIT TË MANASTIRIT	83
Avzi Mustafa: PROPOGANDA SERBE KUNDER ALFABETI TË GJUHËS SHQIPE.....	89
Xhevat Lloshi: RAPORTIMET PËR KONGRESIN E MANASTIRIT	101
Nebi Dervishi: PERSONALITETI I AHMET NJAZIUT TË RESNJËS (1865 – 1913).....	113

Sabile Keçmezi – Basha: QIRIAZËT – FAMILJE PATRIOTIKE DHE ATDHETARE.....	121
Marenglen Verli: INFORMACIONE NGA ARKIVAT E AUSTRO–HUNGARISË PËR KONGRESIN E MANASTIRIT, të 14–22 nëntorit 1908.....	131
Fehari Ramadani & Nazmije Shaqiri: ÇËSHTJA SHQIPTARE NË FOKUSIN E DIPLOMACISË VJENEZE (TETOR–NËNTOR 1908).....	141
Memli Krasniqi: DY RAPORTE TË SHOQËRISË BIBLIKE BRITANIKE MBI ENVER PASHËN DHE MID’HAT FRASHËRIN.....	159
Entela Komnino: SHQIPJA, GJUHA RETORIKE	163
Besnik Rameti & Isamet Bakiu: KLUBI “BASHKIMI”, PROMOTOR I ZGJIMIT KOMBËTAR	175

PARATHËNIE

Kongresi i Manastirit, ose Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe, ishte dhe mbeti një prej akteve më të rëndësishme historike dedikuar ardhmërisë së kombit shqiptar. Ai mbeti një ndër monumentet, apo kodet më sinjifikative të trashëgimisë sonë historike dhe kulturore, pasi atëbotë hapi rrugën e unifikimit të një alfabeti të vetëm me të cilin do të shkruhej në të ardhmen gjuha shqipe. Njësimi i alfabetit ishte një fillim ogurmbarë edhe për njësimin e gjuhës si instrument tejet i rëndësishëm në funksion të njësimit dhe sendërtimit të qenësisë sonë kombëtare, nënkuptohet nëpërmjet shkollës, letërsisë, kulturës e kështu me radhë. Jo rastësisht, një ndër filozofët më të mëdhenj botëror, Martin Hajdeger theksonte se gjuha është shtëpia e qenies, andaj lëvrimi i saj nëpërmjet shkrimit, përkatësisht shkronjave latine hapi rrugën e emancipimit të përgjithshëm kombëtar.

Vendimi i Kongresit në fjalë, përkatësisht eliminimi nga diskutimi i alfabeve arabo-turk e grek dhe përzgjedhja e alfabeve me bazë latinishten, ishte një akt gjithsesi vizionar dhe pragmatik. Në të vërtetë, përcaktimi për alfabetet latine kishte mbështetje në përhapjen e tyre më të madhe, por edhe në traditën që ishte krijuar, sidomos me autorët e vjetër. Ndërkaq, përcaktimi kundër alfabeve të mësipërme kishte si synim parësor njëkohësisht – edhe distancimin territorial, por edhe fqinjësor ndaj vendeve të cilat manifestonin haptazi orekse grabitqare dhe shkomhtarizuese. Njëherit, një përcaktim i tillë, përkatësisht një alfabet larg fqinjësisë territoriale ishte një garanci më shumë për një autonomi veprimi dhe gjithsesi një pavarësi kombëtare që do të kulmonte së shpejti me shpalljen e shtetit shqiptar, nënkuptohet me kufijtë e cunuar duke lënë jashta territorit të tij pjesën më të madhe të viseve me popullsi shqiptare.

Vendimi i Kongresit të Manastirit përçonte mes tjerash edhe mesazhin me prapavijë simbolike se shqiptarët përfundimisht duhej të

orientoheshin kah vlerat perëndimore si vlera progresive dhe qytetëruese në funksion të emancipimit të mirëfilltë të shoqërisë njerëzore në përgjithësi. Jo rastësisht edhe motoja: “Për ne dielli lind në perëndim” i manifestimeve kulturore dhe shkencore dedikuar Ditës së Alfabetit, apo 110 – Vjetorit të mbajtjes së tij, afirmon pikërisht një logjikë dhe filozofi të kësaj natyre. Nënkuptohej se një filozofi e tillë ishte edhe pjesë përbërëse e programit të Rilindjes Kombëtare, kurse rilindësi më i madh i saj, Naim Frashëri, një shekull e gjysëm më parë, theksonte në mënyrë tejet të drejtpërdrejtë se shqiptarët duhej të orientoheshin kah përthithja e vlerave perëndimore. Ai në një poezi të tij e afirmonte një filozofi të kësaj natyre nëpërmjet vargjeve si vijon: *Jak’o o dit’ë uruar / që lind nga perëndon. / At’an e ke ndrituar / E ne pse na harron.*

Kongresi i Manastirit në cilësinë e një dite tejet të rëndësishme të kalendarit tonë historik përkujtohet çdo vit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe shkencore, kurse Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, paraqitet si organizator i manifestimeve të kësaj natyre. Edhe sivjet Instituti në fjalë, në bashkëpunim edhe me institucionet tjera simotra të kësaj natyre, organizoi një numër të caktuar të aktiviteteve kulturore dhe shkencore dedikuar Ditës së Alfabetit, kurse ky vëllim i periodikut “Scupi” i përmbledh në brendinë e tij të gjitha frytet e aktiviteteve në fjalë, nënkuptohet në trajtë të shkruar, por edhe vizuele, kryesisht nëpërmjet disa fotografive. Në vija të përgjithshme, nga tekstet e fjalimeve përshëndetëse të krerëve të institucioneve simotra shqiptare në Shkup, Tiranë dhe Prishtinë, si dhe trajtesat shkencore që janë përfshirë në këtë numër të periodikut “Scupi”, me rastin e shënimit të 110 – Vjetorit të Kongresit të Manastirit, rezulton e dhëna se rruga e shkronjave të gjuhës shqipe ishte tejet e vështirë, madje e larë edhe me gjak, pasi sfidonte synimet ogurzeza të atyre që pretendonin të gllabëronin gjithçka që i përkiste qenësisë shqiptare. Si rrjedhojë, një e arritur e këtillë, nuk ka sesi të mos konsiderohet si pjesë e rëndësishme e kujtesës sonë kolektive. Në të vërtetë, nëpërmjet përmbajtjes së kumtesave shkencore në vazhdim

edhe njëherë rifreskohen njohuritë tona dedikuar kësaj ngjarje madhore historike dhe kulturore, por njëkohësisht shpalosen edhe risi dhe njohuri të ndryshme që gjithsesi se do ta begatojnë dukshëm tryezën e literaturës përkatëse.

Ky numër i periodikut “Scupi” hapet me tekstin e dr. Skender Asanit, përkatësisht fjalimit të tij, të pagëzuar me sintagmën “Një ditë urini e falënderimi”, mbajtur në cilësinë e nikoqirit dhe drejtorit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup me rastin e 11-Vjetorit të themelimit të Institutit në fjalë dhe 110-Vjetorit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Me këtë rast, mes tjerash, nëpërmjet fjalimit të apostrofuar, vihet në dukje kontributi i SHBA-ve në drejtim të mbarëvajtjes së aktiviteteve shkencore të Instituti në fjalë. Në të vërtetë, në objektin e ish-ambasadës amerikane tanimë një kohë të gjatë zhvillon veprimtarinë e tij shkencore Instituti i sipërpërmendur, andaj shpalosja e një pllake falënderuese u dedikohej pikërisht SHBA-ve dhe popullit amerikan. Ndërkaq, në vazhdim të përmbajtjes së periodikut në fjalë prezentohet punimi shkencor i David Hosaflook-ut nga Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante – Tiranë, i cili shpalos një risi që ndërlidhet me Alfabetin e Gjuhës Shqipe, përkatësisht himnin e alfabetit në fjalë, të shkruar nga Parashqevi Qiriazi. Autori i punimit rreket të zbulojë origjinën e panjohur (deri tani) të muzikës së himnit, si edhe të hedhë dritë mbi kontekstin e shkrimit të tekstit nga Parashqevi Qiriazi, një rilindëse dhe pioniere e arsimit të gruas shqiptare. Përmbajtja e mëtejme e periodikut i dedikohet Akademisë Shkencore për nder të Ditës së Alfabetit duke sjellur fjalimet përshëndetëse të titullarëve të institucioneve më të larta akademike-shkencore nga Shkupi, Prishtina dhe Tirana. Më konkretisht, publikohen fjalimet përshëndetëse të Skender Asanit – Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Nuer Arslanit – Drejtor i Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir, Floresha Dados – Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike), Marenglen Verlit – Rektor i Aka-

denisë së Studimeve Albanologjike të Republikës së Shqipërisë, Hysen Matoshit – Drejtor i Institutit Albanologjik të Kosovës, Sabit Sylës – Drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës.

Pjesa tjetër dhe njëkohësisht më e madhe e përmbajtjes së këtij vëllimi të periodikut “Scupi” i dedikohet Sesionit shkencor të zhvilluar me rastin e shënimit të 110–Vjetorit të Kongresit të Manastirit. Me këtë rast janë prezentuar kumtesat e lexuara në këtë tubim shkencor të cilat nga këndvështrime të ndryshme shpalosin të dhëna konkrete që i dedikohen Kongresit në fjalë. Punimi i parë shkencor i studiuesit, Shaban Sinani nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë është fokusuar në dhënien e detajeve rreth procesit të latinizimit grafematik të shqipes deri në Kongresin e Manastirit. Ai shpalos të dhëna të shumta rreth kakofonisë që ekzistonte te autorë të ndryshëm në kontekst të përdorimit të grafemave të gjuhës shqipe. Divergjenca e grafemave të ndryshme ishte një pengesë e madhe në rrugën e kombndërtimit, përkatësisht unifikimit të elementeve, apo simboleve me përmasa kombëtare. Punimi tjetër me radhë i studiuesit Beqir Meta nga Instituti i Historisë – Akademia e Studimeve Albanologjike, nxjerr në sipërfaqe konditat, apo rrethanat historike që krijuan premisat për caktimin e një alfabeti të gjuhës shqipe. Sipas autorit në fjalë, krahas shumë faktorëve tjerë, një zhvillim madhor që i parapriu Kongresit të Manastirit ishte krijimi i klubeve kombëtare, veçmas “Bashkini” i Manastirit, i cili ishte ndër klubet më të mëdha e më të rëndësishme që luajti një rol të veçantë në formimin e 40 klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare.

Punimi pasues i studiuesit Avzi Mustafa, rreket të trajtojë disa segmente të propagandës serbe kundër alfabetit të gjuhës shqipe. Autori nëpërmjet disa dokumenteve të zyrtarëve serbë demaskon politikën serbe të kohës e cila ishte e interesuar që të mos kishte sukses alfabeti latin, por edhe që të mos hapeshin shkolla në gjuhën shqipe. Dihet se qarqet reaksionare të vendit, si dhe shtetet ballkanike pritin që tani germat të jenë "mollë sherri" për përçarje edhe më të

madhe të shqiptarëve. Ndërkaq, punimi i radhës i studiuesit Xhevat Lloshi, fokusohet në raportimet e ndryshme dedikuar ngjarjes madhore të Kongresit të Manastirit. Vend të theksuar kanë zënë, sidomos raportimet e Gjergj Qiriazit, në cilësinë e një veprimtari i përfshirë thellë në vorbullin e lëvizjes sonë kombëtare. Në të vërtetë, sipas autorit të punimit shkencor, njoftimet e Gjergjit luajnë rol parësor për të mbajtur të gjallë interesimin e të huajve për ecurinë e lëvizjes kombëtare shqiptare, për ngjarjet që lidheshin me synimet e tyre në atë pjesë të Ballkanit, domethënë për të pasur pjesë ndikuese edhe në orientimet e kulturës së vendit, për të ndihmuar shkollën shqipe, për të botuar libra, etj.

Dy punimet pasuese, ai i studiuesit Nebi Dervishi nga Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe autores Sabile Basha – Keçmezi nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, përqendrohen në profilizimin e figurave konkrete historike që ndërlidheshin me ngjarjen në fjalë. Punimi i parë ravijëzon figurën historike të Nijazi Ahmet beut, përkatësisht personalitetit të tij si udhëheqës, apo hero i lëvizjes xhonturke. Siç është tanimë e njohur, kjo lëvizje filloi më 3 korrik 1908, kur ngriti krye reparti ushtarak i Resnjës, i komanduar nga oficeri shqiptar, Ahmet Njaziu. Ndërkaq, punimi tjetër shkencor i Sabile Basha – Keçmezit fokusohet në kontributin e familjes Qiriazit në rrugën e jetësimit të idealeve kombëtare. Dihet se të gjithë anëtarët e kësaj familje patriotike ishin veprimtarë të denjë të lëvizjes kombëtare, madje ishin të përkushtuar me tërë qenien e tyre intelektuale, morale, madje edhe materiale në jetësimin e aspiratave shqiptare. Punimi tjetër shkencor i studiuesit, Marenglen Verli nga Akademia e Studimeve Albanologjike të Republikës së Shqipërisë sjell informacione të dobishme nga arkivat e Austro-Hungarisë që flasin për veprimtarinë e Kongresit të Manastirit. Në të vërtetë, studiuesi në fjalë është përkujdesur që të ofrojë të dhëna konkrete nga përmbajtjet e telegrameve, letrave e raporteve të ndryshme që i dërgoheshin ministrit të jashtëm hazburgas nga ana e vartësve të tij, të akredituar në katër vilajetet shqiptare dhe nga ambasadori i tij në Stamboll. Po ashtu, edhe punimi tjetër i radhës i

bashkautorëve Fehari Ramadani dhe Nazmije Shaqiri nga Univeriteti i Tetovës, pretendon të pasqyrojë fakte të caktuara dedikuar diplomacisë vjeneze kundruall çështjes shqiptare, përkatësisht si ajo e trajtonte dhe veneronte çështjen në fjalë. Më konkretisht, përmbajtja e punimit shpjegon dy ngjarje kryesore të vitit 1908, nënkuptohet nga prizmi i Perandorisë Austro-Hungareze. E para ishte ajo e aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga qeveria vjeneze dhe e dyta mbajtja e Kongresit të Alfabetit në Manastir dhe interesimit të shtetit danubian për arritjen e një konsensusi midis intelektualëve shqiptarë të kohës, për përcaktimin e tyre për një alfabet unik për gjuhën shqipe.

Me interes është edhe punimi shkencor i studiuesit Memli Krasniqi nga Instituti Albanologjik i Kosovës, i cili shpjegon dy raporte të Shoqërisë Biblike Britanike dedikuar Enver Pashës dhe Mid'hat Frashërit. Shoqëria në fjalë vinte në dukje se nëpërmjet përkthimeve të Shkrimeve të Shenjta në gjuhët amtare kishte ndikuar që dy personalitetet e sipërpërmendura të afirmonin tolerancën ndërfetare si rrugë e vetme drejt qytetërimit, edukimit dhe progresit paqësor. Punimi i radhës i studiuses, Entela Komnino nga Tirana përqëndrohet në vlerat e gjuhës shqipe, por në rrafshin e një gjuhe retorike, kurse punimi i fundit shkencor i bashkautorëve, Besnik Rameti dhe Isamet Bakiu nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, fokusohet në shpjellimin e aktivitetit patriotik të klubit “Bashkimi” në cilësinë e një promotori të mirëfilltë dhe të denjë të zgjimit të ndërgjegjes kombëtare.

Të gjitha punimet shkencore që në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo tërthorazi i referohen ngjarjes madhore të Kongresit të Alfabetit edhe njëherë afirmojnë dhe përçojnë mesazhin që përmbledhet në trinomin: një alfabet, një gjuhë, një komb. Në të vërtetë, Kongresi i Manastirit, veneruar nga prizmi i çështjeve që diskutoi e miratoi vlerësohet me të drejtë si një ndër kuvendet më të rëndësishme kombëtare në historinë politike e kulturore të shqiptarëve. Ai jo vetëm që zgjidhi çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe, por njëherit

elaboroi dhe shoshiti edhe çështje të tjera me rëndësi jetike kombëtare duke u shndërruar në një mekanizëm tejet të fuqishëm në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Në këtë kongres merrnin pjesë shqiptarë të të gjitha komuniteteve fetare, si: myslimanë, katolikë, ortodoksë, protestantë, etj., apo njerëz të ditur që ishin bashkuar vetëm për një qëllim të madh kombëtar.

Njëri ndër historianët më të njohur botëror, Entoni Smith, duke u ndalur në veçoritë më të rëndësishme të çdo identiteti kombëtar thekson se memorja, apo kujtesa historike është elementi më thelbësor i kultivimit të ndjenjave kombëtare, andaj Kongresi i Manastirit do të mbetet padyshim si një pikë e rëndësishme referuese e biografisë sonë identitare duke na përkujtuar vazhdimisht se rruga e shkronjave të gjuhës shqipe ishte edhe rruga e sendërtimit të qenësisë sonë kombëtare.

Redaksia

11-VJETORI I THEMELIMIT TË INSTITUTIT
110-VJETORI I ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE

“Kujtojmë Alfabetin dhe falënderojmë Amerikën!”

21 nëntor 2018,

ITSHKSH, Shkup



SKENDER ASANI

Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup

...NJË DITË URIMI DHE FALËNDERIMI...

Të nderuar kolegë, zonja e zotërinj,

Më lejoni së pari t’ju falënderoj që sot jeni në Institutin tonë. Nuk do të jem i singertë nëse nuk e pranoj se miqtë e vërtetë të Institutit janë ata që më 21 dhe 22 nëntor janë tek ne. Sepse, sa herë që vjen kjo datë, përveç që e shënojmë festën e alfabetit të shqipes, që nuk është vetëm një kremte linguistike, por është një festë historike kombëtare, kjo datë është edhe një moment që e përkujton theme-limin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Dhe, kjo për neve nuk është pak. Sepse, kjo është një ditë kur ne mblidhemi për të bërë evaluimin e vitit tonë të punës shkencore, për të bërë bilancet dhe për ta parë veten se si ka qenë rruga jonë gjatë vitit. Dhe, kur t’ju them se këtë vit po e përmbyl-lim me afër 20 botime, me disa konferenca shkencore, me një varg vizitash, ekspozitash e aktivitetelesh, do më ndjeni që të mos jem patetik nëse them se në këtë mënyrë edhe jeta e Institutit tonë është bërë pjesë e jetës së festave shqiptare të nëntorit. Prandaj, ju fale-minderit nga zemra që sot jeni këtu.

Me këtë rast i falënderoj edhe kolegët e mi, sepse falë entuziazmit dhe punës së tyre të palodhshme dhe vetëmohuese sot kemi mundësi të bëjmë një pushim kremtimi ose, shprehur në mënyrë amerikane, ky është për ne një “Thanksgiving day”, pra një “Ditë falënderimi”.

Të dashur të pranishëm,

Gjëja e dytë që dua ta them është se këtë vit kemi dy momente të veçanta që e kanë madhështuar këtë festë. E para është një risi dhe

një moment i panjohur për opinionin shqiptar, ndërsa e dyta ka të bëjë me shpalosjes e pllakës përkujtimore që e shënon një histori të këtij objekti dhe që flet për marrëdhënien tonë me objektet.

Sa i takon pikës së parë, unë kam kënaqësi që sot ta prezantoj një zbulim të mikut tonë, prof. David Haseflook, që sjell një risi për himnin e alfabetit, melodia e të cilit është përdorur nga studentët e kolegjit Jale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Parashqevia jonë, si duket, këtë këngë dhe melodinë e saj i kishte mësuar në kolegjin protestant të Stambollit dhe më 1909 atë e kishte përshtatur me një tekst shqip, që do të ishte himni i alfabetit të shqipes dhe do të bëhej aq popullor ndër gjithë shqiptarët. Përkimi i këtij himni me një këngë nga Shtetet e bashkuara të Amerikës për neve nuk është një rastësi e parëndësishme, sepse bëhet fjalë për një shtet, i cili drejtpërdrejt ka asistuar në shpëtimin e jetës së kombit tonë dhe është garantues i paqes në botë. Por, për këtë më shumë do të flasë profesori Hosaflook. Andaj unë do të njaftohem me kaq.

Megjithatë, kur jemi këtu, meqë ne jemi të vendosur në një objekt që për vite të tëra ka qenë seli e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, dëshirojmë t'ju themi se ky për shqiptarët nuk është një objekt dosido, por ai është një monument që shënon dhe shënjon një histori, një kujtesë dhe që flet edhe me muret dhe kthinat e veta. Në këtë objekt kanë ardhur zyrtarët më të lartë amerikanë në kapërcyell të shekujve, këtu ka punuar miku i shqiptarëve dhe zgjidhësi i konfliktit të Kosovës, Ambasadori Hill, Ambasadori Riker e shumë të tjerë. Prandaj, ne konsiderojmë se ky objekt sot më ka peshë dhe rëndësi historike dhe për këtë arsye ne kemi vendosur që me rastin e festës së alfabetit dhe përvjetorit të Institutit ta vendosim një pllakë që do të jetë shenja mbrojtëse e asaj kujtese dhe ura që do ta lidhë të kaluarën dhe të tashmen tonë. Puna jonë në këtë objekt, në një mënyrë, është për shkak të shtytjes që e krijon ky mjedis i punës, sepse marrëdhënja jonë me objektin tonë nuk është vetëm fizike. Ajo i tejkalon këto dimensione dhe

krijon një frymë të punës, të përkushtimit dhe të devocionit ndaj misionit që e kemi marrë mbi vete.

Prandaj, po e përfundoj fjalën time duke ju falënderuar të gjithëve për mbështetjen që i jepni Institutit, duke jua uruar festën e madhe të Alfabetit dhe duke uruar që gjithmonë të takohemi për festa dhe suksese.

Ju faleminderit!



SHPALOSJA E PLLAKËS FALËNDERUESE



Zëvendësambasadorja e SHBA–ve në Maqedoni, znj. Mikaela Shfajcerblum, drejtori i ITSHKSH–së, Skender Asani, dhe drejtori i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante, David Hosafllok, shpalosin pllakën falënderuese, ku shkruan:

“Në këtë objekt, në vitet 1996–2010, ka qenë e vendosur Ambasada e SHBA–ve në Shkup.

Kjo pllakë vendoset në shenjë mirënjohjeje për popullin amerikan.”

Shkup, 21.11.2018



ISShP
INSTITUTI për STUDIME
SHQIPTARE dhe PROTESTANTE

Shkup, 2018

DAVID HOSAFLOOK

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante – Tiranë

“ALFABET I DASHUR, ATDHE I DASHUR”, ORIGJINA E PANJOHUR E “HIMNIT TË ALFABETIT” (1909)

Muzika ka fuqi për të kthyer bindje dhe parime në emocione dhe veprime. Ajo është si një “linjë transporti” që përcjell bindjet e kokës në rrugën e gjatë nga mendja për te zemra. Për këtë arsye, kombet kanë himne, ushtritë kanë banda, kishat kanë kore dhe xhamitë kanë myezinë. Rrallë mund të shikohet një film (qoftë artistik apo edhe dokumentar) që nuk përcillet me muzikë, sepse regjisorët dëshirojnë që shikuesit të *ndiejnë* emocione: qoftë frikë, gëzim, dhimbje, adrenalinë, mall, humor etj.

Himni kombëtar i Shqipërisë, ose “Himni i flamurit”, u shkrua nga Asdreni më 1908, si poezi, dhe thuhet se u këndua për të parën herë nga kori i kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Më vonë, himni erdhi në trojet shqiptare dhe, pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, ai u njoh si himni kombëtar. Është shkruar në disa punime mbi “Himnin e flamurit”, se nuk njihet asnjë tjetër himn kombëtar në botë, i cili i është kushtuar flamurit¹; por njihet fare mirë se edhe himni kombëtar i Amerikës i kushtohet flamurit të saj, me titull: “The Star Spangled Banner” (Flamuri që shndrit me yje). Në këtë aspekt, himnet kombëtare të Shqipërisë dhe të Amerikës i ngjasojnë njëri-tjetrit, por ka edhe një tjetër ngjasim: muzika e tyre është marrë prej një vendi të huaj. Për himnin kombëtar shqiptar është përdorur muzika e kompozitorit rumun Ciprian Porumbescu; kurse për himnin kombëtar amerikan është

¹ P.sh., te: Tole, Vasil, “Edhe një herë rreth himnit tonë kombëtar”, te: http://www.vasiltole.com/Albanian/NationAnthem-AL.html#_ftn5 (lexuar më 3 dhjetor 2018).

përdorur muzika e kompozitorit anglez/britanik John Stafford Smith. Pra, muzika nuk duhet doemos të jetë autoktone, që të shfrytëzohet si himn kombëtar. Për çudi, së paku tri herë janë bërë përpjekje o konkurse në Shqipëri për ndryshimin e himnit kombëtar (1922, 1937 dhe 1945), pikërisht sepse u mendua se ndikimi i huaj në himnin ekzistues ishte një “cen”, por këto përpjekje dështuan.² Muzika nuk njeh kufi.

Më 1909, një himn tjetër filloi të këndohej anembanë Shqipërisë, me vlerën e një himni kombëtar: “Himni i alfabetit”, shkruar nga Parashqevi Qiriazi. Të dyja himnet, “Himni i flamurit” dhe “Himni i alfabetit” përcjellin temat e *bashkimit* dhe *vetëmbrojtjes*, por ka ndryshime midis tyre në imazhet e përzgjedhura, si edhe në strategjinë e vetëmbrojtjes. I pari, shkruar nga një burrë, bën thirrje për bashkimin e shqiptarëve rreth flamurit, me armë në dorë; kurse i dyti, shkruar nga një grua, bën thirrje për bashkimin e shqiptarëve rreth alfabetit, me penë në dorë. Të dyja himnet kanë luajtur, dhe luajnë ende, një rol të rëndësishëm simbolik në përgatitjen e popullit shqiptar për t’u bërë ballë sulmeve ushtarake dhe politike, si edhe për rrënjosjen e ndjenjave patriotike.

“Himni i alfabetit” u shkrua menjëherë pas Kongresit të Parë të Manastirit, në të cilin mori pjesë Parashqevi Qiriazi si krahu i djathtë i vëllait të saj Gjergj Qiriazi dhe, nga ana zyrtare, si sekretarja e Komitetit të Alfabetit. Ky kongres nderohet sot si një ndër kuvendet më të rëndësishme në gjithë historinë politike dhe kulturore të kombit shqiptar,³ jo vetëm për bashkimin e alfabetit, por edhe si një hap madhështor drejt bashkimit kombëtar dhe politik.⁴ Parashqevia e njihte shumë mirë lodhjen, mundimin dhe

² Ibid.

³ P.sh., te: Prifti, Kristaq, red. *Historia e popullit shqiptar*, vëll. II. Tiranë: Toena, 2002, f. 391–396.

⁴ Njihet gjerësisht se u zgjodhën dy alfabete, si kompromis, por shumica e figurave shqiptare letrare të kohës e dinin se kjo zgjidhje ishte e përkohshme. Ndaj, zakonisht flitej në atë kohë për zgjedhjen e *alfabetit* (njëjës), p.sh.: “*Alfabetin tonë ta mbrojmë, shpejto burrani ...*” [jo “*Alfabetet tona*”].

vështirësitë që u tejkaluan për të arritur vendimin e famshëm. Ndër frytet e papritura kulturore që dolën pas Kongresit, spikat “Himni i alfabetit”. Ai i ka qëndruar kohës, dhe sot është një ndër këngët më të njohura në llojin e himneve patriotike shqiptare.⁵ Anasjellas, mund të themi se “Himni i alfabetit” ka luajtur një rol të fuqishëm në përforcimin e suksesit popullor të Kongresit të Parë të Manastirit. Pra, vendimi i Kongresit e lindi himnin, dhe himni e mbështeti vendimin e Kongresit. Ky punim synon të zbulojë origjinën e pan-johur (deri tani) të muzikës së himnit, si edhe të hedhë dritë mbi kontekstin e shkrimit të tekstit nga Parashqevi Qiriazi, një rilindës dhe pioniere e arsimit të gruas shqiptare, e cila është dekoruar më vonë: me “Urdhrin e Lirisë” (1958); me medaljen “Për veprimtari patriotike” (1962); me titullin “Mësues i Popullit” (më 1987); dhe me urdhrin “Nderi i Kombit” (më 2017).

Është një fakt mjaft interesant që alfabeti shqip nuk ishte njësuar deri në fillim të shekullit XX. Vetëm në Shkodër përdoreshin së paku tri alfabetë.⁶ Nuk është qëllimi i këtij punimi të rithuhet çka është thënë në dhjetëra libra e qindra artikuj për nevojën e ngutshme të njësimin të alfabetit, jo vetëm si çështje praktike e kulturës librore, por edhe si çështje e mbijetesës kombëtare. Megjithatë, nuk mund të kuptohet suksesi i “Himnit të alfabetit” pa pasur parasysh kushtet aktuale të kohës, sidomos luhatjet emocionale që ndjeu populli shqiptar, së pari: hare, me shpalljen e lirisë së Hyrietit dhe me suksesin e Kongresit të Manastirit; e pastaj: zhgënjim, me ndryshimin e qëndrimit të xhonturqe kundrejt shqiptarëve pas Kongresit. Duhet të kihet parasysh, gjithashtu, se Kongresi i Alfa-

⁵ Disa versione të Himnit të alfabetit në internet janë: Kori “Lira” në Korçë (<https://youtu.be/ZjDSqY4hvdw>); Kori i shkollës “Udha e Shkronjave” në Tiranë (<https://youtu.be/dMvnJ19Bj9Q>); Kori i burrave të Prishtinës (<https://youtu.be/iNoWGpivQKo>), të gjitha të aksesuara më dt. 18 nëntor 2018.

⁶ Në Shkodër përdoreshin alfabetet e shoqërisë “Agimi”, “Bashkimi” dhe alfabeti i Shkrimtarëve të Vjetër. Ishin në qarkullim në Shkodër edhe botimet e K.Kristoforidhit (botime që përhapeshin në Shkodër nëpërmjet Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vende të Huaja), pra duke paraqitur një alfabet të katërt.

betit u zhvillua në një kontekst kaotik që përfshinte: rënien e Perandorisë Osmane, ngritjen e nacionalizmit, përpjekje për zgjerime territoriale në Ballkan dhe pozicionimin strategjik të Fuqive të Mëdha për interesat e tyre në Ballkan. Të gjithë këto ishin si një lojë shahu politike, që e çoi botën në prag të Luftës së Parë Botërore (pas së cilës do të rishkruhej harta politike e botës). Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët ballkanike po e shikonin kombin shqiptar gjithmonë e më shumë si pjesë e domosdoshme e strategjive të tyre madhore në ndeshjet e tyre me njëri-tjetrin, dhe fati i kombit shqiptar, i përçarë dhe i paorganizuar, ishte në fije të perit. Vështirë se mund të merrej seriozisht një projekt i shqiptarëve për vetëqeverisje (qoftë me autonomi, qoftë me pavarësi) nëse ata nuk mund të binin dakord me njëri-tjetrin për një element aq themelor sa alfabeti.

Pa pasur parasysh gjithë këto faktorë, nuk mund të kuptohet një çudi e veçantë e kulturës shqiptare. Çudia është kjo: ndërsa shumë kombe kanë himne për mbrojtjen e *atdheut* të tyre, shqiptarët paskan një himn patriotik kushtuar mbrojtjes së *alfabetit* të tyre! Në vitin 2018 u përkuan tri përvjetorë me rëndësi kombëtare: 550-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, 140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit dhe 110-vjetori i Kongresit të Manastirit. Mund të konstatojmë një dallim të qenësishëm midis tyre, në karakter dhe në suksesin përfundimtar. Lidhja e Lezhës dhe Lidhja e Prizrenit shquhen për bashkimin e kombit me anë të kuvendeve ku mbizotëronte nevoja e luftës së armatosur për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Ato dy lidhje e përforcuan kombin shqiptar në kohën e tyre, dhe sot, me të drejtë, ato kremtohen dhe kujtohen me një ndikim frymëzues për kombin. Megjithatë, ato dy lidhje u shpërbënë relativisht shpejt si lëvizje, pa arritur qëllimin e tyre përfundimtar.

Ndryshe ishte Kongresi i Parë i Manastirit dhe alfabeti i tij që ende përdoret. Ai shquhet për një lloj tjetër arme – pena jo pushka – dhe kundër një hasmi tjetër, jo kundër armiqve fqinjë, por kundër disa të metave që ishin të rrënjosura brenda karakterit shqiptar, të meta

që po paralizonin kombin, duke rrezikuar edhe asimilimin përfundimtar të tij. Ndër këto të meta ishin: naiviteti, xhelozia, letargjia, mosveprimi, prirja për t’u joshur nga të tjerët, mungesa e vizionit, përçarja etj. Te Kongresi, këto të meta u vënë në shënjestër si armiq të vërtetë që duheshin luftuar. Gjergj Qiriazi, përgjegjësi i Shoqërisë Biblike, i cili mund të quhet edhe iniciatori kryesor i Kongresit, e njihte mirë parimin e thënë nga Jezus Krishti në Bibël: “Çdo mbretëri e përçarë në vetvete shkatërrohet dhe çdo shtëpi e përçarë në vetvete rrëzohet”.⁷ Zgjidhja e problemit të alfabetit ishte çështja praktike që i bashkoi delegatët shqiptarë në Manastir, por problemi e alfabeve të shqipes ishte një pasqyrim në mikrokozmos i problemeve të tjera themelore që duheshin zgjidhur.

Kongresi i Parë i Manastirit synoi të dëbonte disa nga këto të meta nga mendësia shqiptare. Bashkimi i aq shumë figurave të shquara shqiptare në një vend, për një vendim aq të rëndësishëm, ishte “filimi i mbarë” i kapitullit të ri të shkrimit të shqipes. Fryma e unitetit mbarëshqiptar u përfordua në Kongres me anë të çasteve prekëse, si fjalimi bujar i At Gjergj Fishtës dhe mënyra se si Ibrahim Efendi u përqafoi dhe e puthi pas fjalimit.⁸ Dihet se Kongresi nuk u mbyll me suksesin e plotë të synuar (u pranuan dy alfabetet, jo vetëm një), por ai ishte një hap aq i madh në drejtimin e bashkimit, një sukses aq i papritur, sa që shkaktoi madje një reagim kundërshtar nga qeveria e xhonturqve dhe nga forcat e irredentizmit grek, siç përshkruhet nga Parashqevi Qiriazi në një relacion mbi Kongresin:

“Që në Kongresin e Manastirit turqit edhe grekërit treguan planet e tyre ndaj shqiptarëve. Bënë çmos që të merret alfabeti arab edhe grek për të shkruar gjuhën shqipe. Për të

⁷ Dhiata e re, Ungjilli sipas Lukës 11:17.

⁸ Kyrias, George D. “Report of the Albanian Congress held in Monastir 1/14 of November 1908”, Manastir, 20 January 1909, HHStA, PA xiv/15, Albanien xi/6. Krhs: George Kyrias to Rev. T. R. Hodgson te koleksioni i Shoqërisë Biblike në Kembrixh (BSA/F2/8/1/6/2).

luftuar punën e vlefshme të Kongresit të Parë të Manastirit dhe për të penguar mbrothësinë e popullit shqiptar t'arsyer me gjuhën amtare, xhonturqit nisën fushatën kundër abecës shqipe duke botuar një abetare të tyren me shkronja arabe. E zemëruar nga kjo punë e keqe e xhonturqvet kundër abecës aty për aty shkrova himnin e alfabetit kombëtar.”⁹

Me këtë shkrim, del i qartë motivimi i Parashqevisë për shkrimin e “Himnit të alfabetit”: *luftë për mbrojtjen e kombit*. Ajo kishte sakrifikuar shumë për alfabetin dhe për arsimin në gjuhën shqipe, bashkë me delegatët e kongresit. Vëllai i saj, Gjerasimi, kishte dhënë jetën e tij për predikimin e Ungjillit në gjuhën amtare dhe për arsimimin e shqiptarëve në gjuhën shqipe. E tani, pas një periudhe jetëshkurtër me shpresën e lirisë dhe të autonomisë pas Shpalljes së Hyrietit, fryma e bashkimit mbarëshqiptar, të arritur me aq vështirësi në Manastir, po sulmohej sërish. Ndryshe nga luftërat e tjera, në këtë betejë mund të luftonte një grua, sidomos një grua e arsimuar. Parashqevia, e cila rrëfen se ishte “e zemëruar”, i rroku “armët” e saj të preferuara – penën dhe muzikën – dhe shkroi himnin:

1. Sot është dita shqipëtare të përpiqemi

Alfabetin ton’ të mbrojmë, shpejto burrani.

Shkronjat tona jan’ të arta, këto duamë.

Shqipëri, atdhe i dashur, ne s’të lemë ty të varfër.

Shkronjat ton’ kanëpër të mbrojtur me gjithë shpirt shqipëtarisht.

⁹ Kujtimet e Parashqevi Qiriazit mbi Kongresin e Manastirit, AQSH F. 57 (Parashqevi Qiriazit), D. 1 (Veprimtare krijuese), f. 4.

2. Arëmiqtë o shqipëtarë po përpiqenë
Shkronjat turçe dhe gërqishte të na japinë.
Le t’i mbajnë ato për vete, kemi tonatë.

3. Ata duan shqiptarë ndarjenë tonë.
Këtë punë shumë kthjellët e treguanë.
Ngrihuni pra t’u tregoni se ju s’i ndroni¹⁰

Ndonëse njihen mirë rreshtat e ëmbla të himnit të alfabetit – “*Shqipëri, atdhe i dashur, ... Shkronjat tona jan’ të arta*” – qëllimi i këngës nuk ishte për të brumosur një frymë të ëmbël atdhedashëse me idealizma. Përkundrazi, himni ishte një thirrje për luftë. Ai lexohet pak si fjalimi i një gjenerali në fushëbetejë, mu para përleshjes, për t’i motivuar ushtarët për të mos u lëshuar. Mund të vihen re elementet e luftës në himnin e saj:

Antagonistët: shqiptarët kundër “armiqve” (atyre që donin t’ua impononin shqiptarëve shkronjat turke dhe greke).

Fushëbeteja: alfabeti (përmendet dy herë mbrojtja e alfabetit, si tokë e sulmuar).

Urgjenca: “*Sot është dita ... shpejto burrani ... Ngrihuni pra*” (sepse sulmi i armiqve nuk po pritej, por kishte filluar).

Taktika e armikut: Parashqevia synoi të demaskonte taktikat e armiqve. Sipas asaj, qëllimi i tyre përfundimtar ishte ndarja e shqiptarëve. Ajo kishte dëshirë që shqiptarët të mos e bënë syrin qorr, duke theksuar se ky qëllim i tyre po tregohej “shumë kthjellët”.

¹⁰ Kujtimet e Parashqevi Qiriazit mbi Kongresin e Manastirit, AQSH F. 57 (Parashqevi Qiriazit), D. 1 (Veprimtare krijuese), f. 4–5. Himni u botua edhe te: Koti, Dhori. *Këngëtore e re: përmban këngët e vjetra, dhe të reat* (botimi VII). Korçë: Dhori Koti, 1935, f. 20–21.

Strategjia e shqiptarëve: Për t'i bërë ballë sulmit të armikut, Parashqevia nxiti shqiptarët që të mbronin alfabetin shqip, duke përdorur folje veprimi dhe ndajfolje të goditura: *përpiguni*, *mbroni*, *shpejtohuni*, *ngrihuni*, *tregoni*, mos i *ndroni* armiqtë – e t'i bëni këto *shqiptarisht* dhe *me gjithë shpirt*.

Motivimi: Parashqevia shfrytëzoi motivet e krenarisë kombëtare për t'i nxitur shqiptarët për mbrojtjen e alfabetit. Duke përdorur përmirën pronor “shkronjat *tona*,” ajo deshi të ushqente frymën e krenarisë për alfabetin kombëtar. Nuk ishte alfabeti i komisionit, as alfabeti i kongresit, por alfabeti i të gjithë atdhetarëve. Ndonëse alfabeti ishte i ri, ishte qenësisht *shqiptar*, falë unitetit të shfaqur në kongres. Ajo e thellon më tepër këtë frymë krenarie me rreshtin sarkastik: “Le t'i mbajnë ato për vete, *kemi tonatë*.” Pra, Parashqevia nuk deshi që shqiptarët të tregoheshin servilë dhe pasivë, si gurë shahu për kombet e tjera, sepse kështu fati i Shqipërisë do të ngelej në gjendje të njeruar. Vini re që Parashqevia nuk kishte frikë që Shqipëria do të *bëhej* e varfër, por që do të *mbetej* e varfër (“Nuk të *lëmë* ty të varfër”).

Teksti i Parashqevi Qiriazit ishte i fortë, por nuk do të arrinte suksesin aq të madh mbarëkombëtar sikur të ishte vetëm një thirrje nga një grua e re shqiptare, botuar në një revistë. Ndryshe nga “Himni i flamurit”, i cili u shkrua nga Asdreni si vjershë, e më vonë u përshtat për himn, Parashqevia synoi që në fillim të shkruante një himn që do të këndohej. Ajo ka shfrytëzuar fuqinë e muzikës për të përcjellë thirrjen e saj. Që në fëmijërinë e saj, Parashqevia e njohte mirë këtë fuqi. Ajo ishte rritur në gjirin e shkollave dhe kishave ungjillore protestante në Manastir, në Korçë e në Stamboll, takimet e të cilave gjithmonë përfshinin këndimin e himneve në gjuhët amtare, jo nga një kor profesionistësh, por nga gjithë nxënësit dhe besimtarët. Kudo ku shkonin misionarë ungjillorë, botonin dy libra në gjuhën amtare: Biblën dhe një libër himnesh. Vëllai më i madh i Parashqevisë, Gjerasim Qiriaz, nuk ishte vetëm predikuesi i parë protestant shqiptar i cili kishte themeluar kishën e parë ungjillore

shqiptare, por ishte edhe autori dhe përkthyesi i dhjetëra himneve të krishtera. Madje, para Kongresit të Manastirit, më 1908, qenë botuar dy libra himnesh për kishat ungjillore shqiptare, i pari me 44 himne (më 1893), dhe i dyti me 121 himne (më 1907).¹¹ Gjergj Qiriazi, Sevasti Qiriazi dhe vetë Parashqevi Qiriazi përkthenin gjithashtu himne të krishtera.

Deri tani është hamendësuar se Parashqevia e ka kompozuar vetë “Himnin e alfabetit”, ose se e ka huazuar nga një marsh francez.¹² Por cila është origjina e vërtetë e kësaj muzike? Përgjigjja zbulohet në botën universitare amerikane, madje në disa nga kolegjet më prestigjioze. Në fillim të shek. XX, ndeshjet e futbollit amerikan midis kolegjeve rivale Yale dhe Harvard ishin shumë të forta. Para një ndeshjeje në vitin 1900, një student nga kolegji Yale, Allan M. Hirsh, krijoi një këngë frymëzuese me emrin “Boola” (Bula), për të motivuar studentët dhe tifozët e tjerë të Yale-it.¹³ Teksti i këngës thoshte guximshëm se Yale-i do të fitonte thellë dhe lojtarët e dërrmuar të Harvard-it do të qanin: “Bula bula, bula bu!”. Me të vërtetë, kolegji Yale-i e fitoi ndeshjen kundër Harvardit, 28–0! Si melodi, Hirshi e përshtati këngën e tij prej një kënge popullore me emrin “La Hoola Boola” (La Hula Bula), e kompozuar nga muzikanti afrikano-amerikan Bob Cole.¹⁴ Ky muzikant spikat në histo-

¹¹ *Kënkëtores: Hymna per nde Falëtorët të Ungjillorëve*. Korçë, 1893; *Këngë të shenjtëruara për falëtorët shqip*, Sofje, “Mbrothësia”, 1907. Ky libër pa edhe botimin e tretë, në vitin 1927, përsëri me këngë të shtuara.

¹² P.sh., te [https://sq.wikipedia.org/wiki/Alfabeti_shqip_\(këngë\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Alfabeti_shqip_(këngë)) (lexuar më 17 nëntor 2018), shkruhej si fakt i vërtetuar: “Muzika [e Himnit të alfabetit] është adaptuar nga një marsh i Revolucionit francez”.

¹³ Hirsh, Philip. “The Secret Source of That Silly Tune”. http://archives.yalealumnimagazine.com/issues/00_10/boola.html (lexuar më 15 nëntor 2018).

¹⁴ Shapiro, Fred R. “You Can Quote Them”. http://archives.yalealumnimagazine.com/issues/2009_09/arts_quot057.html (lexuar më 15 nëntor 2018). Shih edhe: Powell, Azizi. “La Hoola Boola, The African American Source of the Yale University Song Boola Boola & The University of Oklahoma song Boomer Sooner”, te: <http://pancocojams.blogspot.com/2014/04/la-hoola-boola-african-american-source.html> (lexuar më 17 nëntor 2018).

rinë e teatrit të Amerikës dhe në historinë e vështirë të diskriminimit ndaj pakicave, sepse ai ka shkruar dhe ka sjellë në skenar të parën dramë muzikore, *A Trip to Coontown (Një udhëtim në Kuntaun)*, e cila ishte shkruar, drejtuar dhe luajtur ekskluzivisht nga artistët zezakë dhe që vazhdoi në skenë prej viteve 1898–1890.¹⁵ Më 1901 kënga e A.M.Hirsh-it u botua për herë të parë si partiturë nga Charles H. Loomis (New Haven, Connecticut), me titullin “Yale (March & Two-Step) Boola”.¹⁶ Më 1905 kënga filloi të përdorej edhe nga Universiteti i Oklahomës, dhe përdoret ende sot nga ky universitet para ndeshjeve të tij të sportit, me titullin: “Boomer Sooner”.¹⁷

Mund të pyesim se si ndodhi që një këngë për stadione të futbollit amerikan do të gjente vend si muzika e “Himnit të alfabetit”? Midis viteve 1900–1901, këngës së A. M. Hirsh-it iu shtuan ca strofa të reja, me nëntitullin “Bright College Years” (Vitet e shndritshme të kolegjit). Këto fjalë të reja nuk ishin për sportin, po për vitet e shkollës, për krenarinë e të qenët student në Kolegjin Yale, për miqësitë që krijoheshin në kolegji, si edhe për besnikërinë që një student duhet të tregojë “ndaj Zotit, atdheut dhe Yale-it”, teksa largoheshin e niseshin për të punuar në “botën e turbullt si deti”. Sigurisht, në kohën kur Parashqevi Qiriazi e shkroi tekstin e “Himnit të alfabetit”, nuk kishte qenë ndonjëherë studente në Kolegjin Yale, por ajo, si motra e saj e madhe Sevasti, ishte diplomuar në një kolegji tjetër amerikan, një shkollë protestante për vajza në

¹⁵ Hill, Errol G. dhe James V. Hatch. *A History of African American Theater*. Cambridge: Cambridge University Press, 2013 (ribotim), 156–158. Shih edhe: https://web.archive.org/web/20080727023125/http://beinecke.library.yale.edu/LetItResound/art_rmt_cole_b.html (lexuar më 4 dhjetor 2018).

¹⁶ Mund të shkarkohet partitura origjinale te: <https://levysheetmusic.mse.jhu.edu/sites/default/files/collection-pdfs/levy-045-079a.pdf> (lexuar më 4 dhjetor 2018).

¹⁷ Autori i këtij punimi e “zbuloi” origjinën e “Himnit të alfabetit” kur e dëgjoi rastësisht muzikën që po luhej nga banda e Universitetit të Oklahomës, para një ndeshjeje të futbollit amerikan.

Stamboll, me emrin “Constantinople Women’s College” (Sevastia u diplomua më 1891, Parashqevia më 1904). Ky kolegji kishte drejtorë dhe profesorë nga Amerika. Ende nuk kemi zbuluar një dëshmi të drejtpërdrejtë për këtë çështje, por duhet të hamendësojmë se amerikanët që punonin në këtë kolegji e kishin sjellë këngën “Boola” të Kolegjit Yale në Stamboll për t’i frymëzuar studentet, dhe se aty Parashqevi Qiriazhi duhet ta ketë dëgjuar e kënduar këngën.

Kur erdhi koha që Parashqevisë i duhej një muzikë e mirë për të frymëzuar shqiptarët për t’u bashkuar dhe për të ruajtur besën e dhënë në Kongresin e Manastirit, përballë trysisë së krijuar nga xhonturqit kundër alfabetit të ri, ajo e shfrytëzoi melodinë që ende oshtinte në kokën e saj prej vitesh, duke qenë e sigurt se kjo muzikë mund të këndohej lehtë dhe se do të kujtohej për një kohë të gjatë. Sipas Sevasti Qiriazhi–Dakos, kënga u këndua në mitingun e shkronjave në Korçë në shkurt, 1910, kur u mbledhën rreth 12.000 pjesëmarrës. Sevastia shkruan: “Pas fjalimeve, njerëzit kënduan ‘Himnin e alfabetit’, i cili ishte kompozuar posaçërisht për këtë rast prej motrës sime, Parashqevisë. Himni i rrëqethi që të gjithë dhe qysh nga ajo ditë është kthyer thuajse në himn kombëtar”.¹⁸

Ky konstatimi i Sevastisë, shkruar më 1938, qëndron ende sot, 80 vjet më pas. “Himni i alfabetit” ka karakterin e një himni popullor kombëtar, sepse shpreh ndjenjën e bashkimit të të gjithë shqiptarëve para Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, sepse lartëson një luftë që nuk duhet ushtruar me dhunë, por me “shkronjat tona të arta”, dhe sepse ëndërron një Shqipëri që nuk duhet të lihet e varfër. Një mesazh aq i rëndësishëm mund të përcillej me kumtesa, ligjërata dhe kuvende, por Parashqevia e dinte që mesazhi i saj do të *përijetohej* me një këngë.

— — —

¹⁸ Qiriazhi-Dako, Sevasti. *Jeta ime: jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazhi-Dako*. Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2016, f. 171–175).

Në nëntor të vitit 1958 u kremtua 50-vjetori i Kongresit të Parë të Manastirit me një mbledhje solemne në Tiranë. E pranishme në këtë eveniment ishte Parashqevi Qiriazi, e cila kishte sjellë me vete Viktoria Dakon, mbesën 17-vjeçare të Kristo Dakos dhe Sevasti Qiriazi-Dakos. Në një intervistë, Viktoria kujton një çast tepër emocionues të kësaj mbledhjeje.¹⁹ Pas dhënies së kumtesave, Nexhmije Hoxha i kërkoi “Teta Parashqevisë”, asokohe 78 vjeçe, që të këndonte “Himnin e alfabetit” para sallës, dhe “pothuajse të gjithë të pranishmit ishin me lot në sy”. Çasti ishte emocionues jo vetëm sepse Parashqevia e kishte shkruar vetë himnin rreth 50 vite më parë, as vetëm sepse ajo kishte qenë e vetnija femër që luajti një rol zyrtar në Kongresin e Manastirit, por edhe sepse Parashqevia u prezantua si “delegatja e fundit e mbetur gjallë”.²⁰

Sikur Parashqevia 78-vjeçare ta kishte *recituar* tekstin e “Himnit të alfabetit” në mbledhjen e 1958-së, nuk do të ishte aq prekëse, por ajo e *këndoi*.

¹⁹ Intervistë, David Hosaflook me Viktoria Dako-Rulin, më 15 nëntor 2018.

²⁰ Shih edhe rrëfimin e V. Dako-Rulit te: Qiriazi-Dako, Sevasti. *Jeta ime: jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazi-Dako*. Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2016, f. 290. Aty Viktoria rrëfen: “U preka shumë, se gjatë këngës pothuajse të gjithë të pranishmit ishin me lot në sy. Ka qenë një nga momentet më të bukura dhe emocionuese të jetës sime.”

AKADEMIA SHKENCORE

(Fjalë përshëndetëse nga titullarët e institucioneve të larta akademike–shkencore nga Shkupi, Prishtina e Tirana)

21 nëntor 2018

Muzeu i Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir



SKENDER ASANI

Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup

VULËN E KOMBNDËRTIMIT TË SHQIPTARËVE E BËRI KONGRESI I MANASTIRIT

Më vjen mirë dhe jam i lumtur që këtë vit të përvjetorëve po e përmbyllim pikërisht në Manastir. Në të vërtetë, shënimi i përvjetorëve të mëdhenj të këtij viti u fillua në Shkup, në fillim të vitit, pra në janar, kur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, nën patronazhin e Kryetarit të Kuvendit e shënuam 550-vjetorin e vdekjes së Kryeheroit kombëtar, Skënderbeut. Vazhduam pastaj, gjatë qershorit, në Prizren, ku – nën patronazhin e Kryeministrit të Kosovës, shënuam 125-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, më pas kremtuam edhe në Tiranë dhe ja tash sërish po kthehemi përsëri në Maqedoni, kësaj radhe në Manastirin e Kongresit të Alfabetit në përvjetorin e 110-të të tij.

Dhe, kur vijmë në Manastir në një përvjetor kaq të madh, nuk mund të mos ngazëllemi dhe të mos e ndjejmë emocionin që para një shekulli e dhjetë viteve e kishin Mid’hat Frashëri, Gjergj Fishta, Nyzhet bej Vrioni, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Bajo Topulli e intelektualët e tjerë të kohës, që – derisa punonin për ta nxjerrë në dritë një alfabet unik kombëtar – mbase nuk e dinin se ashtu po bëheshin edhe arkitektët e shqiptarizmsë. Nuk mund të mos mahnitesh kur në këtë kongres një 28-vjeçar si Mid’hat Frashëri vinte me një vizion që i mahiste edhe kokat më të ndritura të kombit. Ose, kur një hoxhë ngrihej dhe e përqafonte At Fishtën për fjalimin e tij prekës dhe historik. Janë këto shkëndija historike, që edhe sot na bëjnë të ndjehemi të vegjël para tyre dhe të mahni-temi me punën e këtyre kolosëve.

Prandaj, të respektuar të pranishëm, tash kur në vitin 2018 po e përmbyllim 550-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut, që ngadalë e kemi zbritur nga priqjet ideologjike dhe mitike, për ta rrafshuar me interesat strategjike kombëtare dhe kur Lidhjen e Prizrenit e kemi quajtur skica e shtetit shqiptar në Ballkan, do të ishte e padrejtë të mos themi se vulën e kombndërtimit të shqiptarëve e bëri pikërisht Kongresi i Manastirit. Pikërisht këtu në Manastir u projektua kombi shqiptar në kuptimin modern të këtij termi, sepse hartimi i një alfabeti, që nënkuptonte një kod të përbashkët komunikimi për gjithë kombin, ishte krijimi i indit lidhor të kombit, ishte llaçi që do t'i lidhte të gjitha tullat e fragmentuara të shqiptarisë. Nuk është as patetike as e tepërt nëse themi se pa Kongresin e Manastirit nuk ka shqiptari. Për këtë arsye për mua ky nuk është vetëm një kongres që u mor me çështje të gjuhës, por ai ishte një furrë që e poqi identitetin tonë kombëtar. Dhe, nëse e merrni dhe shihni komisionin për hartimin e alfabetit, nuk mund të mos mrekullohesh që aty në 11–12 emra janë përzgjedhur jo vetëm intelektualët më të mirë të kombit, por aty me kujdes e delikatesë janë përzgjedhur edhe identitetet heterogjene shqiptare, që simbolizonin unifikimin e kombit. Aty keni katolikë, myslimanë, ortodoksë, bektashi, protestantë, gegë e toskë, që nuk besoj të jetë diçka spontane dhe e rastësishme, por që është madhështore, sepse në këtë mënyrë u krijua narracioni ose rrëfimi për shqiptarinë si diçka që del përtej dallimeve krahinore e religjioze, diçka që i bashkon të gjitha diversitetet ndërshtetërore. Nëse për amerikanët është Amerika ajo që i bashkon dhe i shkrin të gjithë dallimet, te shqiptarët është gjuha shqipe, e projektuar në alfabetin e saj në Kongresin e Manastirit, ajo e ngjiz kombin. Prandaj, sipas meje, projekti më i rëndësishëm i kombndërtimit del të jetë pikërisht Kongresi i Alfabetit këtu në Manastir. Rrjedhimisht, edhe ky 110-vjetor mendoj se është vula e përvjetorëve jo vetëm të këtij viti. Kështu po shënojmë 110 vjet komb në kuptimin modern të këtij termi, që – krahasuar me shumë kombe europiane dhe ballkanike – është një sukses që nuk mund të nënvlerësohet.

Gjëja e fundit që dua ta theksoj është se Kongresi i Manastirit është i lidhur edhe me një përvjetor tjetër në Maqedoni. Ai është përvjetori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, që është themeluar pikërisht më 22 nëntor. Dhe, kjo nuk është e rëndësishme vetëm si moment feste për një institucion shkencor, por është diçka më shumë. Duke qenë të themeluar në këtë datë, edhe ne kemi ndjekur hapat e këtij Kongresi dhe jemi përpjekur të qëndrojmë në frymën e këtij vizioni. Vetëm në Institutin tonë gjeni botime për Nënë Terezë dhe familjet katolike shqiptare, për Xhemijetin e myslimanëve shqiptarë, për Qiriazët protestantë, për Nolin ortodoks, për historinë tonë më të re ndërmjet dy luftërave botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore, duke e projektuar veten ashtu siç e shihte Mid'hat Frashëri shqiptarizmin. Përmes punës së Institutit po merr formë dhe pamje edhe identiteti jonë kombëtar në Maqedoni dhe kështu vit për vit, vepër pas vepre, ne po e profilizojmë identitetin tonë dhe po e rizbulojmë veten tonë, për ta parë pa paragjykime, pa komplekse dhe pa stereotipa. Kështu, mendoj unë, po ia bëjmë nderin më të madh shqiptarisë, sepse vetëm kjo është rroba që i bën tamam kombit shqiptar.

Në të vërtetë, edhe tubimi jonë këtu sot i ngjan Kongresit të Manastirit dhe duke qenë ne ftuesit e këtij takimi, kjo pak a shumë është metafora e gjithë kësaj që e thashë më sipër.

Duke jua uruar këtë festë mbarëkombëtare, ju falënderoj për kujdesin dhe ju ftoj që të vazhdoni të na mbështetni dhe përkrahni, sepse vetëm të bashkuar mund t'ia dalim.

NUER ARSLLANI

Drejtor i Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe – Manastir

“GJUHA ËSHTË RROJTJA A VDEKJA E KOMBIT”!

Të nderuar mysafirë dhe të pranishëm!

Sot ndihem krenar, që pas 110 viteve jemi mbledhur institutet albanologjike dhe historike shqiptare nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria, në vendin më të shenjtë të shqiptarëve, për të festuar themelimin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe si dhe Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Nuk kam dyshim se në këto aktivitete shkencore do të nxirren në pah fakte të reja rreth Kongresit të Manastirit.

Prandaj, në emrin im personal dhe në emër të IN “Muzeu i Alfabetit të gjuhës Shqipe” – Manastir, ju përshëndes dhe mirë se na erdhët në këtë Akademi Shkencore kushtuar 110 vjetorit të formimit të shkronjave më të bukura në botë.

Në Këto ditë festive, megjithatë qyteti i Manastirit prapë u pikëllua – e humbëm edhe një zë kumbues të Manastirit! Mbrëmë ndërroi jetë arsintari, gazetari, kronisti i vetmuar në qytetin e konsujve, Qenan Hasani. Prandaj, ju shprehi ngushëllimet e singerta familjes, miqve, shokëve dhe gjithë shqiptarëve që kanë bashkëndjerë këtë humbje!

Të nderuar të pranishëm!

Me zgjidhjen e çështjes së njësimin të alfabetit të gjuhës shqipe, Kongresi i Manastirit i vitit 1908 mbylli një epokë të tërë në historinë e kulturës shqiptare, kurorëzoi me sukses përpjekjet, që mendjet më të ndritura të kombit shqiptarë bënë gjatë shekujve për shkrimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, për përmirësimin e vazh-

dueshëm të sistemit grafik të saj, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e të përshtatshëm për gjuhën shqipe dhe të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, ashtu sikurse edhe vetë populli shqiptarë është një nga popujt më të vjetër të këtij gadishulli. Ashtu si dy gjuhë të tjera indoevropiane, rumanishtja dhe lituanishtja, gjuha shqipe ka filluar të shkruhet relativisht vonë. Libri i parë shqip që njohim deri sot është “Meshari” i Gjon Buzukut i vitit 1555. Por, fakte të ndryshme dëshmojnë se shqipja duhet të jetë shkruar qysh njaft kohë para Buzukut. Këtu nuk është fjala vetëm për dokumentet e njohura si “Formula e pagëzimit” (1462) e Pal Engjëllit, “Fjalorthi i Arnold Fon Harrfit”, “Perikopeja e Ungjillit”, e ndonjë tjetër dëshmi e shkurtër shqip, por për një traditë shkrimi.

Përhapja e shkollave dhe e shkrimit shqip, si dhe sukseset që arritën patriotët shqiptarë në luftën për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptarë, bënë edhe më të ngutshme nevojën e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Nismën për thirrjen e kongresit kombëtar për vendosjen e një alfabeti të vetëm e mori klubi shqiptarë “Bashkimi” i Manastirit, që luante rolin kryesor midis klubeve shqiptare. Qysh në ditët e para pas shpalljes së kushtetutës nga ana e Xhonturqëve, patriotët shqiptarë, e në mënyrë të veçantë drejtuesit e klubit “Bashkimi” të Manastirit, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte çështja e alfabetit të vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare në Shqipëri, e shpallën atë si detyrën e tyre më të ngutshme.

Në 27 gusht të vitit 1908, pas vendimit që kishte marrë që në 21 gusht, kryesia e klubit “Bashkimi” të Manastirit, shpalli Zëdhënien (thirrjen) e saj, me të cilën u bëri të ditur gjithë klubeve dhe shoqërive brenda dhe jashtë Shqipërisë propozimin për mbledhjen e Kongresit të Alfabetit në 14 nëntor të vitit 1908, në të cilin do të ftoheshin të gjithë shqiptarët, gegë e toskë, si dhe të jashtmit e çdo

filolog, që interesohej për këtë çështje, për të marrë pjesë në këtë kongres të madh.

Megjithëse klubet dhe shoqëritë shqiptare u përfaqësuan gjerësisht në Kongres, ai nuk arriti të tërhiqte të gjithë intelektualët më të përgatitur në çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Sipas Gjergj Qiriazit, nënkryetar i klubit “Bashkimi” të Manastirit dhe i Kongresit dhe anëtar i Komisionit të alfabetit, “shumica e njerëzve të ditur të Shqipërisë, që dëgjuan për këtë Kongres, mendonin se nuk ishte koha për një gjë të këtillë”... Pati edhe nga ata, që sipas Gjergj Qiriazit, “në Kongres erdhën vetëm për të qenë të pranishëm, pa pritur ndonjë përfundim të mirë”. Por Gjergji shkruante, se rezultatet e mira të Kongresit provuan se ata që mendonin ashtu kanë qenë në gabim, se rruga që zgjodhën intelektualët e shquar për zgjidhjen e problemit të alfabetit duke thirrur një kuvend kombëtar, ishte më e drejta.

Vepra e kryer në Kongresin e Manastirit i qëndroi kohës, u bë pjesë e pandarë e kulturës shpirtërore të kombit shqiptar. Kjo u bë e mundur sepse të gjithë patriotët të mbledhur në Manastir ishin të vetëdijshëm se kishin marrë përsipër të zgjidhnin një nga detyrat më të mëdha dhe më shqetësuese të kohës për kombin shqiptar. Pa një vetëdije të tillë, s’mund të kuptohet vendosmëria e tyre për të mos u larguar nga Manastiri të përçarë, pa e zgjidhur përfundimisht këtë çështje sa të vështirë aq edhe të rëndësishme. E vendosmëria për të gjetur një gjuhë të përbashkët për njësimin e alfabetit, nuk duhet kuptuar vetëm si pasojë e trysnisë në rritje, që po ushtronin qarqet e ndryshme atdhetare brenda dhe jashtë vendit, por në radhë të parë si fryt i bindjes së tyre të palëkundur se zgjidhja e këtij problemi ishte bërë tepër e ngutshme dhe nuk priste më.

Përpjekja e të gjithë delegatëve të Kongresit të Manastirit për tu ngritur mbi pikëpamjet e ngushta vetjake në të mirë të kërkimit të një zgjidhjeje të pranueshme nga të gjithë, është edhe mesazhi më kuptimplotë, që na ka përcjellë Kongresi i Manastirit i vitit 1908.

Seancën e hapjes së punimeve të Kongresit e drejtuan si kryetar të saj Rexhep Hoxha (Efendiu), dhe Fehim bej Zavalani – kryetar i Klubit “Bashkimi” të Manastirit. Në këtë seancë ishin të pranishëm si të ftuar valiu i Vilajetit të Manastirit Hivzi Pasha, që u zgjodh edhe kryetar nderi i Kongresit, oficerë të lartë si dhe mjaft elementë të kombësive të tjera, grekë, bullgarë e vllah. Mbledhjet e ditës së parë dhe të dytë u zhvilluan të hapura, në to morën pjesë rreth 400 veta. Në seancën e pasdites u zgjodh kryesia që do të udhëhiqte dhe drejtonte punimet e Kongresit: Kryetar i Kongresit u zgjodh Mit’hat Frashëri (Lumo Skendoja), ndërsa nënkryetarë u zgjodhën Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazit, sekretarë: Hilë Mosi, Thoma Avrami dhe Nyzhë bej Vrioni.

Sipas raportit të Gjergj Qiriazit, anëtarët e Komisionit, pasi lidhën besën se do të mbanin në fshehtësi atë që do të bisedonin, derisa të vendosej puna e alfabetit, diskutuan gjerë e gjatë mbi këto tri pika:

1. A do të adaptohet njëri nga tri alfabetet kryesore, d.m.th. alfabeti i “Bashkimit” apo ai i “Agimit”?
2. A të bëhet një kombinim i këtyre tri alfabeteve?
3. A të lihen mënjandë të tria këto alfabete dhe të krijohet një alfabet krejt i ri?

Vendimi i komisionit të alfabetit u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit në 20 nëntor (dita e shtatë e punimeve në Kongres) para dreke. Salla e mbledhjes ishte mbushur plot me shqiptarë, që prisnin me padurim të merrnin vesh përfundimet e Komisionit të Alfabetit. Duke shpallur vendimin e komisionit, kryetari i Kongresit Mit’hat Frashëri, tha se “Komisioni, i zgjedhur nga delegatët e Shqipërisë, e përfundoi detyrën e tij, duke u përpjekur e shpresuar për bashkim. Pas këtyre fjalëve, Luigj Gurakuqi solli dërrasën e zezë, mbi të cilën ishin shkruar shkronjat e alfabetit. Vendimi i Komisionit u miratua nga mbledhja me duartrokitje dhe brohoritjet: “Rroftë Alfabeti!”.

Në këtë mbledhje gjithashtu folën edhe Gjergj Fishta, Abdyl Ypi e Nikollë Kaçorri. Fishta duke vënë në dukje shërbimet që shqiptarët

i kishin bërë Perandorisë Osmane, kërkoi nga qeveria turke dhe nga gjithë personalitetet zyrtare që asistonin në këtë seancë të Kongresit, të ndihmonin në çdo mënyrë për “mbarësinë e qëllimeve të shenjta kombëtare të shqiptarëve”. Sa më shumë të zgjohej e të ngrihet kombi shqiptar, tha Fishta, aq më tepër do të fuqizohet nga ana materiale e mendore.

Kongresi u dha fund punimeve të tij me mbledhjen e ditës së nëntë (në 22 nëntor), që u mbajt me dyer të mbyllura, vetëm me pjesëmarrjen e delegatëve dhe iu kushtua çështjeve organizative. Në këtë mbledhje delegatët miratuan unanimisht dy rezoluta që kishin të bënin me çështjet organizative të lëvizjes kulturore – kombëtare. Në rezolutën e parë thuhej se të gjithë klubet dhe shoqëritë që ekzistonin në Shqipëri, duhej t’i dërgonin çdo muaj nga një raport Klubit Shqiptar të Manastirit, i cili nga ana e tij do t’u dërgonte atyre një raport të përgjithshëm. Me këtë vendim Kongresi e njohu si klub qendror e drejtues të të gjitha klubeve shqiptare atë të Manastirit, i cili edhe me veprimtarinë kulturore – kombëtare që kishte zhvilluar deri në atë kohë, ishte afirmuar tashme si i tillë. Ky vendim, i cili siç informonte në Vjenë konsulli austriak në Manastir, Posfai, të nesërmen, pas përfundimit të punimeve të Kongresit, u morë pas një debati të gjatë mes delegatëve, shënoi dështimin e përpjekjeve të xhonturqve për të caktuar si qendër drejtuese të klubeve dhe të shoqërive shqiptare Klubin e Stambollit, të cilin krerët e “Bashkimit e Përparimit” mendonin se mund ta kishin më lehtë ta vinin nën kontrollin e tyre. Në rezolutën e dytë thuhej që pas dy vjetësh (në 10 korrik 1910) do të mbahej në Janinë një Kongres tjetër për çështjen e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Mendim për mbajtjen e një kongresi të tillë ishte shprehur edhe në vendimin e komisionit të alfabetit. Duke e veshur Klubin “Bashkimi” të Manastirit me atributet e një klubi qendror e udhëheqës për të gjitha klubet dhe shoqëritë e tjera patriotike, Kongresi ndihmoi që shkalla e organizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të ngrihej në një nivel më të lartë, në krahasim me periudhën e mëparshme.

Në mbrëmjen e fundit të Kongresit delegatët dhanë një darkë për udhëheqësit e Klubit të Manastirit dhe për shqiptarët që ndodheshin aty, si një element frymëzues bashkimi e përparimi për të mirën e mëmëdheut. Kështu mbaroj punimet Kongresi i Manastirit, me një festë që s’e kishin parë kurrë më parë.

Po e përfundoj fjalën time me thirrjen e Kryetarit të Kongresit të Manastirit dhe nënkryetar i Komisionit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe, i madhi Mithat Frashëri:

“Duhet të flasim dhe të shkruajmë shqip, se gjuha është rrojtja a vdekja e kombit”!

Urime 110 – Vjetorin e Kongresit të Manastirit!

Qoftë i përjetshëm Alfabeti shqip!

FLORESHA DADO

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

*(Kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore
dhe Albanologjike)*

TË RISHOHIM NË NJË NDRIÇIM MË TË QARTË RAPORTIN ME HISTORINË TONË

Të nderuar kolegë, miq !

Nuk e di se gjatë 110 viteve të historisë së kësaj ndërtese të bekuar sa herë janë mbledhur këtu, ku jemi sot, gjuhëtarë, historianë, njerëz të dijes dhe kulturës shqiptare për të rikujtuar e nderuar aktin historik, të përmasave të ekzistencës së kombit tonë, njësimin e alfabetit të shqipes. Ata që u ndeshën në pikëpamjet dhe propozimet e tyre, që diskutuan me përgjegjësinë më të lartë njerëzore, duke finalizuar aktin dinjitoz të unifikimit të alfabetit të gjuhës sonë janë sot këtu për të na kujtuar ç'do të thotë përgjegjësi kombëtare. Me përkushtimin atdhetar ata ndoshta nuk mendonin ato ditë se vitet e shekujt do risillnin në përvjetorë të rëndësishëm, të pandërprerë, vlerën që mori fjala e tyre, debatet e tyre, mospërputhjet dhe më në fund bashkimi alfabetor. Shoqëria “Bashkimi” e Manastirit në ambicien e saj nuk kishte lavdinë për rolin dhe vendin e veçantë që historia e shqiptarëve do t’u rezervonte në shekuj e në shekuj. Duke marrë rolin e iniciatores ajo promovoi fillimin e një epoke të re në vetëdijen e shqiptarëve. Kongresi i Manastirit dhe 28 nëntori i katër viteve të mëpasshëm, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, dhanë modelin e triumfit të përbashkësisë kombëtare, përtej interesave të veçanta, duke projektuar hapjen e një epoke historike. Sigurisht kjo epokë do ecte, më pas, përmes vështirësish të vazhdueshme, përplasjesh me faktorë antishqiptarë, por ne e dimë: historia njerëzore ka treguar se asnjëherë çështjet e një kombi nuk zgjidhen lehtëazi, pa kurthe, përplasje, iniciativa dhe përpjekje guximtare.

Të nderuar kolegë, duke nderuar 110 vjetorin e Kongresit të Manastirit sigurisht nuk do të përsëris vlerën shumëdimensionale që pati kjo marrëveshje kombëtare, raportin shkencor që u vendos midis gjuhës dhe alfabetit si mjet i bashkimit kombëtar, reflektimin e këtij akti historik në hapjen dhe zhvillimin e arsimit shqip, etj. etj. por të propozoj të rishohim në një ndriçim më të qartë raportin me historinë tonë: dje dhe sot. Duke e konceptuar të gjithë bashkë si akt i përmasave të veçanta historike, mendoj se ne vijmë sot jo thjesht për të ripërsëritur vlerën shumëdimensionale të këtij akti të përgjegjshëm në historinë e shqiptarëve, por për të bërë një qasje të re mbas 110 vitesh, lidhur me historinë tonë në vazhdim, me sukseset dhe problematikat e saj, me reflektime serioze ndaj vetes dhe të huajit. Dua të theksoj se çdo përvjetor nderimi i Kongresit të Manastirit vjen, në mënyrë të veçantë, si çelës për të arsyetuar qëndrime dhe mendime të reja, raporte të ngushta dhe të gjera midis shqiptarëve, kudo janë. Pra, kremtini i këtij përvjetori dhe i atyre që do vinë vite e shekuj më pas do të kërkojë qasje të një konceptimi më të gjerë dhe në një perspektivë të vazhdueshme historike. Them këtë se vlera e një marrëveshjeje të përmasave kombëtare, siç ishte zgjidhja dhe vendosja e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe qëndron: nga njëra anë në ndriçimin e plotë të momentit historik, politik e kulturor të kohës kur u krye. Dhe sigurisht në këtë plan shkencat tona gjuhësore dhe historike kanë ende për të zbuluar, interpretuar rreth rolit dhe marrëdhënieve reale të gjithë protagonistëve të kohës, pa përjashtuar askënd. Jam e bindur se në referimet shkencore të kolegëve do të vinë fakte të reja, qasje që ndriçojnë më tej këtë akt historik.

Nga ana tjetër përkujtimi nderues mbas 110 vitesh kërkon zgjerim të gjykimit mbi këtë marrëveshje, reflektim për dukuri të sotme të situatës së gjuhës shqipe, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Kërkon thellim edhe në problematikat që u shfaqën, sidomos në tre dekadat e fundit, midis gjuhëtarëve shqiptarë, kudo që janë. Vendosja e alfabetit të përbashkët të shqipes duhet parë sot mbas 110 vitesh si një unison gjuhësor, që përcjell në ditët tona vetëdijen e

lartë dhe mirëkuptimin për perspektivën e gjuhës kombëtare. Nga unifikimi i alfabetit dhe përpjekjeve historike për përdorimin e shqipes, pas kaq vitesh problemi kalon te niveli dhe ruajtja e pastërtisë dhe normës letrare të saj. Gjuhëtarët tanë, specialistët më të mirë, kanë detyrë shkencore–kombëtare përpjekjet e përbashkëta si në ruajtjen e vlerave dhe pastërtisë së gjuhës shqipe, ashtu edhe në angazhimin për zgjidhjen e problemeve aktuale që paraqesin realitetet gjuhësore në tre shtetet e shqipes së shqiptarëve, sot në kontekste të tjera historiko–shoqërore–kulturore, ku, gjithsesi, problematikat janë paksa të dallueshme. Ky është misioni më i shenjtë i shkencave tona gjuhësore sot.

Me këtë rast më lejoni të theksoj edhe një çështje shumë të rëndësishme. Akademia e Shkencave të Shqipërisë ndjen detyrimin shkencor dhe kombëtar që të mbështesë bashkëpunimin e të gjitha institucioneve shkencore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në gjithë qendrat e tjera albanologjike nëpër botë. Ne theksojmë se, pavarësisht aktiviteteve, projekteve shkencore që ka çdo institucion shkencor, janë disa problem madhore të planit të historisë dhe aktualitetit kombëtar që duhet të na bashkojnë në tryeza të përbashkëta shkencore. Vlerësimi i ngjarjeve të rëndësishme të historisë së shqiptarëve nuk është pronë e asnjë institucioni më vete, por është bashkëdiskutim, bashkëreflektim, bashkëprojektim i përbashkët. Prandaj në emër të Akademisë së Shkencave përgëzoj Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore Kulturore Shqiptare në Shkup, drejtorin e tij z. S.Asani, për organizimin e këtij takimi të rëndësishëm, sa festiv aq edhe shkencor. Bashkëpunimi me të gjitha institucionet shkencore mbetet një ndër synimet kryesore në projektet e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shqipërisë për çështje madhore të historisë dhe kulturës së shqiptarëve. Urime !

Gëzuar festën e përbashkët !

Ju faleminderit.

MARENGLEN VERLI

*Rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike
të Republikës së Shqipërisë*

NË KONGRESIN E ALFABETIT U HODH IDEJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Kam nderin dhe kënaqësinë të përshëndes këtë tubim përkujtimor e shkencor në emër të Akademisë së Studimeve Albanologjike të Republikës së Shqipërisë.

Nëntori është muaji përplot punë e veprimtari, por i tillë ka qenë edhe më parë, edhe në vitin e largët 1908, kur mendjet më të ndritura e atdhetarët më të spikatur të kombit, u mbledhën në këtë qytet për të zgjidhur një problem në dukje kulturor e arsimor, por në fakt me rezonancë politike e shtetformuese për shqiptarët. Kлубet, shkollat, gazetat e shumta të hapura në shtator – tetor dhe ku vendi i pashoq i alfabetit i 14 – 22 nëntorit, që afirmuan akumulimin patriotik, dhe shpërthimi i energjive për të realizuar aspiratat mbarëkombëtare, në rrethanat e favorshme të krijuara nga Revolucioni i Turqve të Rinj dhe nga kushtetuta e miratuar në gusht 1908, janë dëshmia e arritjeve, por edhe e detyrave, që dilnin para kombit dhe Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Ne sot i dimë mirë ngjarjet e atyre viteve dhe dimë të lexojmë mesazhet që na përcjell historia.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare më 1908, edhe pse e paunifikuar në pikëpamje e veprime, tregoi pjekurinë për të kapur momentin e duhur e për të realizuar gjithçka që ishte e pamundur deri atëherë. Hapat e 2–3 muajve, porsa u hapën shtigjet e lirisë konstitucionale, tregojnë se Lëvizja Kombëtare Shqiptare e kishte të qartë objektivin final, krijimin e shtetit shqiptar. Në Kongresin e Alfabetit u projektua autonomia dhe u hodh ideja e pavarësisë së Shqipërisë.

Synimi final kërkonte mirëkuptim, rrafshimin e diferencave për interesa të vogla krahinore, fetare e sociale dhe Kongresi i Manastirit këtë e arriti.

Synimi final kërkonte të shfrytëzoheshin liritë e shpallura me Kushtetutë, për të kërkuar e siguruar në praktikë këto liri në të gjitha fushat dhe Kongresi i pati në vëmendje të gjitha problemet në arsim, kulturë, ekonomi, politikë.

Synimi final kërkonte mirëkuptimin edhe të kombeve të tjerë të Ballkanit Osman dhe zbatimin e Kushtetutës nga autoritetet, dhe në ditët e Kongresit këto u realizuan (valu, nëpunësit, përfaqësues të maqedonasve, vlllehëve etj., ishin thirrur dhe përshëndetën çeljen e Kongresit).

Koha kërkonte aleatë të mëdhenj, që duhet të përkrahnin kombin shqiptar në rrugën e tij dhe burrat që organizuan Kongresin e çuan më tej lobimin për çështjen shqiptare, veçanërisht në kancelaritë evropiane, që kishin interes të jepnin mbështetjen e tyre. Vjena, Roma, Londra, ishin portat ku kongresistët e nëntorit të vitit 1908 do të shtonin trokitjet e tyre. (Domethënës është impenjimi i Gjergj Qiriazit që, me raporte të detajuara njoftoi njëherësh në dy drejtime, në Vjenë dhe në Londër, se ç'bënë shqiptarët në Kongresin e Manastirit).

Sot, pas 110 vjetësh, ne na duhet ende të mësojmë nga historia e organizimit të zhvillimit të Kongresit të Manastirit. Unë e dëshiroja që shënimi i këtij 110-vjetori të na gjejë në një organizim të konceptuar me përmasa shumëdimensionale, natyrisht me risi shkencore, por, kryesorja, të na gjejë të gjithë bashkë dhe, njëherësh të respektuar nga fqinjët tanë. Vetëm kështu ne do të shkojmë përpara, vetëm kështu Ballkani do të kapërcente ndasitë dhe do të pranohej si pjesë e natyrshme e Evropës.

Falënderoj personalitetet që na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.

I uroj punë të mbarë kësaj konference, pjesë e veprimtarive të shënuara, që filluan dje, dt. 20 nëntor në Shkup, po vijojnë sot më

21 nëntor në Manastir – Bitolë, dhe do të përfundojnë më 22 nëntor përsëri në Shkup, duke dëshmuar vlerësimin për këtë ngjarje madhore të historisë sonë kombëtare, këtij momenti kulmor për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në prag të pavarësisë dhe të hedhjes së themeleve të shtetit modern shqiptar.

Faleminderit organizatorëve të veprimtarive të këtij përvjetori të lavdishëm.

HYSEN MATOSHI

Drejtor i Institutit Albanologjik të Kosovës

NJË PËRVJETOR MES PËRVJETORËSH

I nderuari z. Ali Ahmeti, i nderuari z. Bujar Osmani, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nderuar kolegë, zonja dhe zotërinj, fillimisht, në emër të Institutit Albano-logjik të Prishtinës, dua të përgëzoj Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni dhe Muzeun e Kongresit të Alfabetit të Manastirit, për organizimin e aktiveteve shënuese në nderim të 110-vjetorit të mbajtjes së Kongresit të Manastirit.

Kongresi i Manastirit shënon ngjarjen më të rëndësishme në historinë e kulturës shqiptare si prova e parë e një arritjeje kombëtare të kurorëzuar me sukses. Është pika kthesë në zhvillimet e përgjithshme kulturore mbarëkombëtare, por edhe një shenjë e rëndësishme e paralajmëruese për procesin e shtetformimit shqiptar. Kultura shqiptare, ndonëse kishte shënuar arritje në periudhën e Rilindjes, nëpërmjet kombëtarizimit të saj, ende zhvillohej nën ndikimin e konsiderueshëm të qarqeve të veçanta kulturore. Alfabetet e ndryshme që përdorehin nga autorët e kohës ishin shenja të divergjencave kulturore të këtyre qarqeve, ndërsa mungesa e një alfabeti unik ishte një “argument” i diplomacive fqinje për të dëshmuar se si shqiptarët na qenkëshin fise që nuk përbënin një entitet të qëndrueshëm e homogjen kombëtar.

Intelektualë të shquar shqiptarë të proveniencave të ndryshme kulturore, shoqërore e fetare, e panë si çështje të rëndësishme përzgjedhjen e një alfabeti të përbashkët, me qëllim të krijimit të një njësie unike kulturore, mbi të gjitha funksionale, kombëtare. Tridhjetë vjet pas Lidhjes së Prizrenit, elita e intelektualëve shqiptarë u mbledh në kryeqytetin e Vilajetit të atëhershëm të Manastirit

me qëllim që zhvillimet kombëtare t'i vinte hullinë e mbarë të integritetit gjithëkombëtar dhe të përparimit krahas kombeve të tjera të Evropës. Marrë parasysh rrethanat e përgjithshme shoqërore, që ndërlidheshin me perëndimin e një Perandorie shekullore dhe në vijim edhe me apetitet pansllave për zgjerim në hapësirën etnike shqiptare, një hap i tillë ishte sfidë e madhe socio-kulturore në proceset e modernizimit të kombit.

Sfida e unifikimit të alfabetit, si kërkesë imediate e fillimit të shekullit XX bëhej edhe më e vështirë për faktin se ideologët klasikë të Rilindjes Kombëtare tashmë ishin shuar, ndërsa brezi vijues i shkrimtarëve, dijetarëve, publicistëve dhe intelektualëve shqiptarë ishte në formim e sipër. Personalitete të përmasës së De Radës dhe Naimit, në fushën e letërsisë shqipe, nuk kishte, ashtu sikundër që ende nuk kishim as ideologë të përmasës Sami Frashërit dhe Pashko Vasës, të cilët me traktatet e tyre formësuan bazat e një programi për krijimin e shtetit shqiptar.

Në rrethana të tilla kulturore, pra të mungesës së një autoriteti të gjithëpranueshëm që do të vihej në krye të alfabetizimit të shqipes – si një zgjidhje që shkrinte në një individualitetin e një gjeniu kombëtar në ardhje dhe gjenezën e tij, si pinjoll i familjes që i dha kombit tonë emra të shquar në sferën e politikës, artit dhe dijes – u shfaq Mid'hat Frashëri. Secili përvjetor i Kongresit të Manastirit na kujton në mënyrë të pashmangshme kontributin e tij prijatar dhënë përmasës, organizimit, mbarëvajtjes dhe përfundimeve të Kongresit, por na kujton gjithashtu edhe trashëgiminë e rrallë që ia ka lënë kulturës sonë në sfera të ndryshme të veprimtarisë shkencore, letrare, politike, publicistike, enciklopedike etj. Megjithatë, përvjetori i 110 i më të madhes ngjarje kulturore në historinë tonë e risjell disi më ndryshe në vëmendjen tonë Mid'hat Frashërin. Ka shumë arsye që ky përvjetor të ndërlidhet edhe më fuqishëm me emrin e tij. Dimensionin racional i kësaj ndërlidhjeje, në rend të parë, ka të bëjë me botimin e plotë të dy kolanave të revistave të rëndësishme në historikun e publicistikës shqiptare, sikundër janë “Kalendari kom-

biar” dhe “Diturija”, në të cilat shfaqet qoftë si themelues a drejtues, qoftë si autori identifikues i tyre dhe në rend të dytë me nisimën e Institutit “Lumo Skëndo” të Tiranës që të botojë kompletin e veprave të tij të zgjedhura. Për hir të së vërtetës duhet thënë se ky kolos i letrave shqipe nuk po kthehet zëshëm vetëm me trashëgiminë e tij shkrimore e mendimore, ngase, pas një mërgimi të gjatë e të pakuptimtë, para pak ditësh, eshtrat e tij, me ceremoni të larta shtetërore, u kthyen në gjirin e Atdheut dhe ky fakt përbën dimensionin emocional të këtij viti kulturor mid’hatian. Uroj që kjo riardhje e tij në jetën tonë të pasohet edhe nga një vlerësim objektiv i historiografisë sonë, nga njohja e plotë e kontributit të tij në rrugëtimin kulturor e dituror të kombit shqiptar drejt niveleve të një shoqërie të përparuar. Uroj që trashëgimia e tij shkrimore të na shërbejë edhe në këto kohë të mugëta për të gjetur rrugën e përparimit.

Kur e them këtë kam parasysh faktin se ky personalitet i shquar shqiptar, i njohur për veprimtari të gjithanshme si publicist, shkrimtar, përkthyes, albanolog, diplomat, politikan, nuk gjeti vend në Fjalorin e sapobotuar Enciklopedik të Kosovës, ndonëse rëndësia e veprës dhe e veprimtarisë së Mid’hat Frashërit është me interes edhe për Kosovën dhe viset veriake shqiptare, pastaj ai ishte edhe njohës i shkëlqyer i raporteve shqiptaro-sllave, dhe mbi të gjitha përfaqësues i Pejës dhe firmëtar në emër të saj i Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 në Vlorë.

Përvjetori i sivjetmë i Kongresit të Manastirit ka korresponduar me një varg përvjetorësh të rëndësishëm për historinë dhe kulturën tonë kombëtare. Në krye të herës, 2018-ta ishte shpallur nga qeveritë përkatëse të Shqipërisë dhe të Kosovës si vit i Skënderbeut, në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, por gjithashtu sivjet u shënua edhe 140-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që shënonte të parën përpjekje për unifikim politik në rang kombëtar, me qëllim të krijimit të një strukture autonome shtetërore, pa harruar se njëkohshëm ishte edhe përvjetori i 140 i dhimbjes së madhe të zhbërjes etnike të një pjese të madhe të viseve shqiptare, të cilat, me vendimet e Kongresit të Berlinit, iu

dhuruan fqinjëve. Në vazhdë të përvjetorëve nuk mund të mos e theksojmë edhe jubileun e 100 të themelimit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, i cili në historikun e lëvizjes kombëtare shqiptare hyri si një organizatë që motivoi dhe frymëzoi brezat e tërë të shqiptarëve në përpjekjet vijuese për liri, pastaj sivjet u shënua edhe dhjetëvjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës etj.

Megjithatë, simbolika e përvjetorëve koïncidon në ndërlidhjen e dy ngjarjeve të rëndësishme jubilarë, Kongresit të Manastirit si përpjekje e suksesshme e unifikimit të alfabetit të shqipes dhe Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, e cila mbolli idenë madhore e larghedhëse në jetën e shqiptarëve të përfshirë në sintagmën “një komb – një gjuhë”. Ndaj e them me bindje se, parë në kontekstin kulturor, Kongresi i Manastirit e ka peshën e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ndërsa Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e mbajtur para gjysmë shekulli, ka peshën e aktit të pavarësimit të Kosovës dhe që të dyja, si zhvillime historike, janë një kontribut vendimtar për konfirmimin e njësisë kombëtare shqiptare në Ballkan.

Adresimin tim dua ta përfundoj me disa fjalë të kryetarit të Kongresit të Manastirit, Mit’hat Frashërit, pa asnjë dyshim aristokrat i letrave shqipe, i cili, i entuziazmuar nga arritja e parë e suksesshme kombëtare, më 1909, në tekstin inicial të revistës “Diturija”, të titulluar “Istori e shkrimit shqip”, theksonte: *“Pas kësaj nisje së lumturë, sa do që pak vonë dhe me mundim, e shohëm se gjuha jone merr një vënt mes të gjuhëvet të tjera, zë rrënjë në kompt tënë. Hovi u-dha, rruga u-çel, edhe përparimi nisi, mendimi u-hap, sa arriti në këtë ditë ku kurgjë s’munt ta ndalojë dhe ku na duhetë që të punojmë me më të madh kurajo që të fitojmë kohënë që kemi humburë gjer më sot.”*

Të nderuar kolegë,

Them se edhe sot, në njëqindëdhjetëvjetorin e Kongresit të Alfabetit, kemi nevojë t’i kujtojmë këto fjalë të mençura.

SABIT SYLA

Drejtor i Institutit të Historisë së Kosovës

ME ALFABETIN E MANASTIRIT U BOTUAN KRYEVEPRA KOMBËTARE

Te nderuar, zonja dhe zotërinj,

Në zhvillimet historike, në rrjedhën e viteve dhe shekujve, ka ngjarje që për domethënien e tyre qëndrojnë si udhërrëfyese në udhëkryqet e mëdha të historisë. Pa dyshim, një nga ato ngjarje që i dha popullit shqiptar një dimension të ri e që zë vend nderi në histori, është Kongresi i Alfabetit shqip, mbajtur në nëntor 1908, këtu, në Manastir, qytet me një pozitë të rëndësishme në Gadishullin Ilirik. E sot, shënimi i këtij 110-vjetori, në kalendarin e historisë sonë kombëtare, përkon me 550-vjetorin e vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, 140-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 100-vjetorin e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, 50-vjetorin e demonstratave të vitit 1968, 20-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe 10-vjetorin e shtetësisë së Kosovës.

Për të arritur deri të Kongresi mbarëkombëtar, ishte bërë një rrugë e gjatë dhe shumë e mundimshme. Pengesat vinin nga të gjitha anët, pasi një nga fushat më të rëndësishme padyshim ishte ajo e arsimit dhe unifikimit si faktorë përcaktues të komponentës së zhvillimit kulturor e shpirtëror të një populli, me një rol shumë të rëndësishëm në formimin e karakteristikave themelore të vetëdijes kombëtare dhe të superstrukturës shoqërore.

Gjuha shqipe padyshim është njëra ndër gjuhët më të vjetra evropiane, mirëpo si gjuhë e shkruar është dëshmuar vonë. Fillimet për lëvrimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe fillojnë gjatë epokës së Humanizmit dhe të Renesancës, kurse zhvillimin më të lartë në

shkrime e arriti gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Si pararoje e Kongresit, ishte hapja e shkollave në gjuhën shqipe në Korçë, në vitin 1887, po ashtu ajo e vazave në këtë qytet dhe në qytete të tjera. Atë që shqiptarët e shfrytëzuan për të arritur qëllimin madhor, hapjen e shkollave shqipe dhe unifikimin e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe, ishte Revolucioni xhonturk më 1908. Deri atëherë shkollat ishin organizuar sipas ndarjes fetare; myslimane, ortodokse e katolike, që përdornin shkronja arabe, greke e latine. Por edhe nëse bëhej hapja e shkollave shqipe kishte vështirësi të mëdha, nga se nuk kishte një alfabet të vetëm dhe nuk dinin se cilin alfabet t'ua mësonin fëmijëve. Duke e parë këtë, intelektualë shqiptarë shtruan nevojën e intensifikimit të veprimtarisë së tyre në drejtim të unifikimit sa më parë të alfabetit në gjuhën shqipe. Ata ishin të vetëdijshëm se kjo ishte nevojë imanente, dhe këtu ne Ma-nastir erdhën përfaqësues nga të gjitha trevat, që përfaqësonin klube dhe shoqëri që vepronin brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke vulosur njëherë e përgjithmonë përkatësinë tonë evropiane, përmes këtij alfabeti që ne sot shprehim zgjerimin e dijes, mishërimit, ndihmës së ndërsjellë, ndikimin progresiv të përparimit kulturor, kombëtar e shkencor gjithandej ku çmohet dhe respektohet e drejta e individit.

Te nderuar, te pranishëm!

Vitet 1908 – 1912, për zhvillimin e arsimit shqiptar përbëjnë etapën e fundit dhe më të lartë për epokën e Rilindjes, ku përmbajtja, masiviteti dhe organizimi arsimor arriti në një shkallë të lakmueshme të konsolidimit. Një rol të madh në këtë drejtim ka luajtur pa dyshim unifikimi i alfabetit tonë. Kjo periudhë, si për nga kryengritjet ashtu edhe zhvillimi kulturor – arsimor mund të krahasohet më atë të Lidhjes së Prizrenit. Madje mund të themi se edhe e tejkaloi atë.

E sot, përkujtimi i ngjarjeve më të rëndësishme e më të ndritshme kulturore të popullit tonë është i domosdoshëm, sepse në këtë mënyrë ne drejtohemi kah njohja e vlerave dhe respektimi i tyre. Jemi të lumtur dhe krenarë, që krahas dhe shoqëruar me vlerat

evropiane, historia shqiptare ka krijuar vlera me rëndësi të dorës së parë, sepse me alfabetin e Manastirit janë botuar kryevepra me vlera kombëtare.

Ju faleminderit!

SESSIONI SHKENCOR
110–vjetori i Kongresit të Manastirit
(Kumtesat e studiuesve)

22 nëntor 2018, Manastir



Kryesia e punës: Xhevat Lloshi, Sevdail Demiri, Sabile Keçmezi–Basha

SHABAN SINANI

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

PROCESI I LATINIZMIT GRAFEMATIK TË SHQIPES DERI NË KONGRESIN E MANASTIRIT

I.

Historia e grafematizimit të shqipes është e ndërlikuar. Ndonëse mjeshtëria *ars scribensi* në hapësirën historike shqiptare ka traditë mijëvjeçare, deri tek Kongresi i Manastirit shqipja kaloi nëpër *më shumë se 150 prova alfabetizimi*²¹. Është thjesht një naivitet historik-kulturor të thjeshtosh çështjen dhe të pohosh se kanë qenë vetëm tre alfabetë: latinisht, greqisht e silabik (arabisht, persisht e osmanisht). Konkurrenca e alfabeteve nuk ka ngjarë në gjuhë tjetër si në shqip.

Duke ironizuar dukurinë e marrë të *multialfabetizimit*, Faik Konica, në prag të Kongresit të Manastirit shkruante: ... *atyre që botojnë një libër të ri u duket se e kanë për detyrë të shpikin dhe një alfabet të ri ... Për shqiptarët e shkretë leximi i një libri kërkon një punë përgatitore: mësimin e alfabetit*²². Për saktësi, duhet pohuar se e përkohshmja e Konicës *Albania* nuk kishte ndonjë alfabet të zgjedhur: botonte si shkruante autori. Qëndrimi i tij ndaj Kongresit të Manastirit nuk kishte asnjë lidhje me preferencat vetjake apo qëllimet pragmatike të tij.

²¹ Tomor Osmani, *Udhë e shkronjave shqipe: historia e alfabetit*, në *Vepra themelore në albanologji*, bot. i QSA, Tiranë 2009, f. 39-40. Për rrugën e gjatë prej alfabetizimit deri tek shkolla, prej shkollës në kishë tek shkolla si institucion në Shqipërinë e shekullit XVIII shih në mënyrë të veçantë: Italo Sarro, *La scuola in Albania nel '700*, në *Hylli i Dritës*, XXXI (2011), nr. 3.

²² Faik Konica, *Çështja e alfabetit (letër e hapur drejtuar albanologëve më të njohur)*, në *Albania*, nr. 6, viti 1898.

Àt Gjergj Fishta, në *Ánzat e Parnasit*, e pati ironizuar njësoj pa mëshirë si Faik Konica këtë çrregull atavizëm të botës shqiptare:

Për çdo kaçubë na bijnë nga një letrar,

Qi, ethun trûsh me prralla e me gazeta,

Përfton mâ n'fund e pjell një Abecedâr.

I pari që i vuri detyrë vetes të shkruante me shenja *vetëm të shqipes* që Pjetër Bogdani: *Ndonëse nukë gjeta shkronja arbënisht, possi paçë dëshruem, u shërbyeshë asgja mangut me disa shkronja të greqishtes*²³. Në rrjedhë të shekujve dëshmohej se për të shkruar shqip u përdor edhe alfabeti cirilik e shkrimi *glagolitik*²⁴. Deri në fillim të shekullit XX mbetej i shqiptuar propozimi që shqipja të zgjidhte grafemat e hebraishtes²⁵. Sipas disa studiuesve, edhe alfabeti i Veqilharxhit përmbante disa grafema *hebraike dhe armenë*²⁶. Jeronin de Rada krijoi e përdori vetë tre alfabetë dhe shkroi një broshurë për njësimin e sistemit shkrimor të shqipes²⁷, po aq dhe

²³ Pietro Bogdano, *Cuneus prophetarum de Christo Mundi et eius evangelica veritate*, Pattavi MDCLXXXV, *Të primitë përpara letteraritë: Me duel puna fort mbare, e per te cpejte. E ndone nuke gietta caratterite Arbëniçct, poççi pace deçruem û çcerbççe, as gian' mangu me diçça Lettera te Gerchijçe, tue beççuem, ççe zgheççe i çne i Areneçce me urtjte vet giççe fjaletë ka me i venduem, poççi bagnene Franceçte, e Tuççeçchite; te çijte ndrççe çcruejne ççe ççe i zgheççe*.

²⁴ Henri Barić, *Старина арбанаске писмености (Lashtësia e shkrimit shqip)*, në *Време*, 1. I, Београд 1941. Stanišić, Vanja, *Из историје примене словенске писмености за албански језик (Nga historia e alfabetizimit të gjuhës shqipe)*, në *Баштина*, 1, Prishtinë 1991. Shih dhe: Joan Pelushi, *Një vështrim i shkurtër historik mbi përthimet fetare në Kishën Orthodhokse në Shqipëri*, në *Tempulli*, nr. 2, Korçë 2000.

²⁵ Jorgji Santa nga Elbasani i shkruan Josif Nosit në San Demetrio Korone për alfabetin e gjuhës shqipe me shkronja latine, çifute, arabe. Ruhët në AQSH, F. 32, V. 1910, fl. 63-64.

²⁶ Necip P. Alpan, *Arnavut alfabesi nasıl doğdu? - 100-yjetori i abecesë shqipe*, Ankara 1979, p. 15.

²⁷ Girolamo de Rada, *Abecedario della lingua albanese*, Corigliano Calabro 1896. Nga De Rada për të njëjtën çështje shih dhe *Caratteri della lingua albanese: suoi monumenti nell'età preistorica*, tipografia G. Galio, Catanzaro 1899.

Ndre Mjeda. Ndërsa *Hoxha Tahsini propozonte një palë shkronja sui generis, të bëra prej vijash gjeometrike*²⁸.

Në shekujt e sunduar prej romantizmit gjuhësor dhe letrar europian dukuria e *multialfabetizmit* të shqipes ra menjëherë në sy të studiuesve të Perëndimit. Carl Faulmann (1880) veçonte *shkronjat e Elbasanit*, të cilat i lidhte me emrin e Dhaskal Todrit²⁹; *shkronjat e BÛthakukya-s (Vithkuqit)*; *shkronjat e Veso Bei-t dhe një alfabet të greqishtes për shqipen*³⁰. Për grafemat e alfabetit të Elbasanit, George vonHahn-i mendonte se janë një *shartim i shkronjave të finikishtes së lashtë me ato të greqishtes*, ndërsa për atë të Veqilharxhit shtonte se shkronjat e tij *nuk janë aspak primitive e të vrazhda, por të punuara me shije dhe të stilizuara me elegancë*³¹. Gjuhëtari tjetër gjerman, Leopold Geitler, i vlerësonte shenjat e alfabetit të *Anonimit të Elbasanit si stilizime të shkronjave latine në korsiv*³².

Të magjepsur prej botës shqiptare në zbulim e sipër prej kolonializmit kulturor europian në rrjedhat e romantizmit, shumë dijetarë albanofilë të Perëndimit u përpoqën t'i gjejnë lashtësisë së shqipes të njëjten

²⁸ Lumo Skëndo, *Shoqëri e Stambollit*, në *Diturija*, 1926, nr. 2, f. 68-75.

²⁹ I pari që ia njohu autorësinë e shkronjave të Elbasanit Theodor Bogomilit ishte G. von Hahn, i cili pohonte se ky alfabet duhet të jetë shpikur prej një të dituri të quajtur Teodor, që jetonte nga fundi i shekullit XVIII. Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jenna 1854, s. 294. Necip P. Alban, në studimin e tij *Arnavut alfabeti nasil doëdu?*, Ankara 1979, p. 15, konsideron autor të këtij alfabeti *Papa Tasin*, me sa duket duke pasur në mendje *Papa Totasin*, që përmendet nga Dh. S. Shuteriqi.

³⁰ Carl Faulmann, *Das Buch der Schrift enthaltend die Schriften und Alphabete aller Zeiten und aller Völker des Erdkreises (Libri i alfabeveve të të gjitha kohërave dhe të gjithë popujve të botës)*, Druck u. Verl. der Kaiserlich-Königlichen Hof-und- Staatsdruckerei, Wien 1880 (Hildesheim 1986), p. 181-182: *Die erste von den hier angeführten Schriften ist in der Stadt Elbasan heimisch, auch soll sie der südlichen Nachbarstadt Berat verstanden und benützt werden. Die zweie soll von einem Albanesen namens BÛthakukye erfunden worden sein; die dritte lernte ein angesehener Häuptling Veso Bei von seinem Hofmeister, der gleich-falls ein Albanese war.*

³¹ Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jenna 1854, s. 292-293.

³² Leopold Geitler, *Die Albanesischen und Slavischen Schriften*, Wien 1883, f. 4.

lashtësi edhe në historinë e shkrimit. *Ekziston një alfabet shqiptar kishtar prej tridhjetë shkronjash*, shkruante Conrad Malte-Brune, *të cilat ngjajnë shumë me shkronjat fenikase, hebreje, armene, palmyr-rase; disa prej tyre ngjasojnë me shkrimet hieroglifike hieratike, kurse disa të tjera me shkronjat bullgare dhe mesogotike*³³. Malte-Brune vërente se alfabeti i shqipes, duke mos qenë shkrim *hastiform*, duhet të jetë krijuar prej meshtarësh: *ose prej atyre të shekullit II, në fillimet e krishterimit; ose prej atyre të shekullit IX*. Ky alfabet, mendonte ai, *ndërthur në vetvete shenja alfabetesh jashtëzakonisht më të vjetër, të përdorur në Iliri, në Maqedoni dhe në Epir*³⁴.

Sipas dëshnmive arkivistike, gjatë shekullit XIX shqiptarët iu drejtuan pesë herë perandorisë otomane me kërkesa me shkrim për lejimin e shkrimit shqip: më 1858, më 1864, më 1867, më 1872 e më 1875³⁵. Sipas Gaetano Petrotës, një studim për shkrimin e shqipes me alfabetin e turqishtes ekzistonte qysh në vitin 1861 dhe thuajse në të njëjtën kohë (1869) në Livorno ishte botuar dhe një studim tjetër,

³³ Conrad Malte-Brune, *Précis de la géographie universelle: ou description de toutes les parties du monde sur un plan nouveau, d'après les grandes divisions naturelles du globe; précédée de l'histoire de la géographie chez les peuples anciens et modernes, et d'une théorie générale de la géographie mathématique, physique et politique*, volume VI, Paris 1826, p. 215: *Dans les livres albanais, imprimés par la Propaganda, on se sert de l'alphabet italien moderne, en y ajoutant quatre lettres particulières; les Albanais eux-mêmes emploient l'alphabet grec moderne, également avec des lettres particulières; mais il existe encore un alphabet ecclésiastique albanaie de trente lettres, offrant de grandes ressemblances avec les caractères phéniciens, hébreux, arméniens, palmyréniens; quelques uns avec l'écriture hiéroglyphique hiératique; peu avec les caractères bulgares et meso-gothiques.*

³⁴ Conrad Malte-Brune, vep. cit.: *Il lui manque ce que noire curiosité y chercherait de préférence, le caractère pélasge, étrusque ou runique; ce n'est pas une écriture hastiforme; c'est le roseau des manuscrits grecs qui en est le trait dominant; aussi, c'est, nous le croyons, dans sa forme actuelle, l'ouvrage des prêtres chrétiens, soit au II- siècle, lors de l'introduction du christianisme, soit au IX, lorsque l'Eglise chrétienne d'Albanie se rattacha définitivement au siège de Rome; mais cet alphabet renferme des éléments d'alphabets infiniment plus anciens, usités en Illyrie, en Macédoine et on Epire.*

³⁵ Necip P. Alpan, *Arnavut alfabesi nasil dođdu?* - 100-vjetori i abecesë shqipe, Ankara 1979, p. 16.

për një *alfabet të përgjithshëm shqiptaro-epirot*³⁶. Ndërsa më 1872 në Konstandinopojë u botua broshura *Alfabeti i shqipes*, me dy mundësi: me shkronja latine (30 f.) dhe me shkronja greke (32 f.).

Në të njëjtën kohë njësimi i shkrimit shqip do të bëhej çështje kongresesh, kuvendesh, konferencash, katedrash, himnesh e mallkimesh. Mendimtarët shqiptarë e shihnin latinizimin e alfabetit edhe si shenjë të përurimit të identitetit kombëtar³⁷. Dhe kjo jo pa arsye: vetë *etnonimi* i shqiptarëve, ose më saktë etnonimi i përuruar në shekullin XVIII, është në fakt *lingonimi* i tyre: *shqiptar* do të thotë *shqipfolës*, asnjë lidhje nuk ekziston midis shqiponjës dhe etnonimit të shqiptarëve. Pikërisht ngaqë pavarësimi gjuhësor dhe alfabetik i shqiptarëve kishte një rëndësi përtej konceptit teknik të shkrimit, shtypi i vendeve fqinje mbitheksoi dy fjalë-çelësa: *shqiptarët e latinicë*³⁸.

Disa prej atyre ngjarjeve që iu kushtuan njësimit alfabetik të shqipes, si *akademia gjuhësore e ipeshkvinjve katolikë* (Shkodër, maj 1902)³⁹; *kongresi i dytë i Manastirit* (2–3 prill 1910), i cili ka

³⁶ *Alfabeto albanese con lettere turche*, Costantinopoli 1861 dhe *Alfabeto generale albano-epirotico*.

³⁷ Ndër të tjera për këtë shih: Antonio Busseti, *Esposizione dell'alfabeto adottato nella Conferenza dei Vescovi Albanesi in Scutari*, Shkodër 1902. Mihal Grameno, *Mallkim i shkronjavet shqipe*, Korçë, pa vit botimi. Gjithashtu: Aristotel Spiro, *Alfabeti shqip - miti dhe e vërteta*, në *Shekulli*, nr. 2495, 12 dhjetor 2008, f. 18; idem, *Çmitizimi i diskutimit për alfabetin*, në *Shekulli*, nr. 2516, 9 janar 2009, f. 17.

³⁸ Shih Stjepan Atoljak, *Prilog historijata borbe albanaca za svoj alfabet (Ndihmesë për historinë e luftës së shqiptarëve për alfabetin e tyre)*, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë 1969; И. Г. Сенкевич, *Освободительное движение албанскою народа в 1905-1912 (Lëvizja për liri e shqiptarëve në vitet 1905-1912)*, Москва 1959; Илья Голованов, *Младо Турци и Албанците (Turqit e rinj dhe shqiptarët)*; në *Българска збирка, књига XVII, Софија 1910; Prava buna zbog latinice (Kryengritje e vërtetë për shkronjat latine)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, mars 1910; *Proterani učitelji (Dëbimi i mësuesve)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, shkurt 1910; *Hodže i softe protiv latinice (Myftinjët e nxënësit kundër shkronjave latine)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, shkurt 1910.

³⁹ Të dhëna të rëndësishme për përpjekjet austro-hungareze për të zgjidhur problemin e alfabetit të shqipes gjenden në dokumentet e kopjuara në arkivat austriake të ruajtura në filmin I-II/22, viti 1899-1900, *Mbi alfabetin e gjuhës*

meritën historike–kulturore që vendosi *përdorimin përgjithshëm të shkrimit latin*, si dhe *kongresi gjuhësor i pakryer i Janinës* (3 korrik 1910)⁴⁰, njihen pak⁴¹. Pothuajse të gjithë veprimtarët rilindës i kushtuan vëmendje pajisjes së shqipes me një alfabet të denjë. Shumë prej tyre jo vetëm propozuan sisteme grafematikë të vetët, por dhe bënë kërkime e studime mbi tradita shkrimore të mëhershme. Një pjesë e këtyre studimeve janë njohur e botuar shumë vonë. Rasti i Frangjisk Santorit është ndër më shenjuesit. Artikulli i tij *Metodo storico sugli alfabeti dei quali si è fatto uso a scrivere la lingua albanese*, në të cilin synohet zgjidhja e problemit të një sistemi shkrimor shqip, u botua vetëm në vitin 1981⁴². Prej Santorit përmendet edhe një alfabet i shpikur *dai Mirditi e Schkipetari*, të cilin dijetari italo–arbëresh Francesco Altimari e njehson me alfabetin e Veqilharxhit⁴³.

Në koleksionin e fondeve personale të Lef Nosit gjendet një fashikull me shenjime rreth alfabeve më të vjetër të shqipes, që ai i quan: *alfabeti grek, egjiptian, fenikas dhe pellazg*. Në pesë fletët e para Nosi ka shenjuar me radhë simbolet e këtyre alfabeve, duke u pranëvënë shkronjat gjegjëse në shqip dhe vlerën fonologjike të tyre⁴⁴. Rrethanat e kanë sjellë që çdo shenjë grafike e shqipes të

shqipe e mbi botimin e librave shkollorë (71 fl.) dhe filmin I-II/20, viti 1899, *Mbi botimin e një abetareje dhe alfabetin e gjuhës shqipe* (71 fl.), që ruhen në arkivin shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

⁴⁰ Skënder Riza, *Albanska abeceda u naučnoj literaturi*, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë 1969, f. 186.

⁴¹ *Na kanë shpallur luftë në fushën e shkronjave*, qe shpehur Dervish Hima në kongresin e dytë të Manastirit, duke iu referuar pengimeve që po i sillte alfabetit të shqipes lëvizja xhonturke *İtihat ve Terakki*. *Ne që jemi mbledhur këtu, bashkë me gjithë atdhetarët shqiptarë, do t'i mbrojmë me çdo mjet shkronjat tona kombëtare*. Shih: Justin Rrota, *Per historin e alfabetit shqyp*, në *Hylli i Dritës*, Shkodër 1935, nr. 2, f. 89.

⁴² F. Altimari, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua Albanese e i suoi alfabeti*, Quaderni di Zjarri, 1982.

⁴³ *Fu detto che ultimamente, dai Mirditi e Schipetari erasi inventato un alfabeto tutto proprio, e divenuto quasi comune in quei luoghi, ma finora nulla essendoci prevenuto, niente del pari possiamo dirne*. F. A. Santori, *Articolo etnografico, manoscritto A*, f. 15, në botimin e cituar të F. Altimarit.

⁴⁴ AQSH, Fondi nr. 32, Dosja 31, Viti 1910, fl. 1-13.

ketë një histori. Sot pohohet se *historia e shkronjës “ë” ka mbetur ende e pashkruar*. Francesco Altimari, në studimin me titull *Shkronja flamur “ë”*, e sheh këtë grafemë jo vetëm si identifikuese të alfabetit të shqipes, por dhe si një histori të gjatë të vendosjes dhe stabilizimit të lidhjeve shqiptaro–arbëreshe në sistemet e shkrimit⁴⁵; për çka duhet t’i jemi mirënjohës At Gjergj Guxetës, i cili e projektoi këtë shkronjë jo vetëm për shkrimet e veta, po dhe për të lehtësuar leximin e alfabeve të shkrimtarëve të Veriut⁴⁶.

II.

Alfabetet numerikisht me një histori të pasqorë të shqipes ishin shkak kryesor i fragmentarizimit të hapësirës shkrimore të shqipes. Në studimin *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1938–1939), Eqrem Çabej argumenton se *qarqet parakombëtare* më në fund u *derdhën të gjithë në lumën e përbashkët të literaturës nacionale në shekullin XIX*. Ishte romantizmi i Rilindjes Kombëtare faktori kulturor e letrar që homogjenizoi zhvillimin e letërsisë shqipe. Por a kanë qenë gjithnjë qarqet letrare *ishuj pa dritare komunikimi*, duke përfshirë multialfabetizmin si faktor kufizues? Ne do të përpiqemi të provojmë se alfabetit si kufi pushuan së ekzistuari së paku një shekull më herët, pavarësisht se ndërkomunikimi mes tyre u përgjithësua gjatë Rilindja.

1. Qarqet që e kanë kapërcyer më herët alfabetin e njëri–tjetrit janë ai i *shkrimtarëve katolikë të Veriut* dhe i *shkrimtarëve italo–shqiptarë*. Dy dorëshkrimet që gjeti Zef Krispi i parë (prosenior) në bibliotekën e seminarit arbëresh të Palermos: një fjalor italisht–shqip e shqip–italisht prej Nilo Catalanos dhe një fjalor tjetër prej

⁴⁵ Francesco Altimari, *Il grafema-bandiera <ë> - I lunghi legami shqiptaro-arbëreshë attraverso la breve storia di una semplice lettera*, *Studia Albanica*, 2008/1, f. 11-21.

⁴⁶ Shih B. Demiraj, *La lettera <ë> come testimone della tradizione scritta albanese-arbëreshe e alcuni problemi riguardanti la sua odierna ortografia*, në *Studia Albanica*, nr. 2, 2008, p. 89-97.

Niccolò Chetta–s, qenë shkruar me alfabetin e të Frang Bardhit. Shkronjat që ai përdori në fjalorin e vitit 1635 *Propaganda Fide i kishte njohur si alfabet zyrtar të shqipes*⁴⁷. Me këtë datë nis procesi i gjatë i latinizimit grafematik të alfabetit të shqipes.

Zef Skirò prosenior, në katër letrat e tij drejtuar Selisë së Shenjtë, përdori *vetëm gjuhën shqipe, shkruar me alfabetin latin të qarkut verior*, pa gjuhë paralele, duke i dhënë për herë të parë shqipes *statusin e një gjuhe zyrtare*⁴⁸. Shkrimtarët veriorë dhe ata arbëreshë i ndërkëmbyen alfabetet e tyre dhe objektivisht ndihmuan për stabilizimin grafematik të një sistemi shkrimor të vetëm me bazë latine. Kahja e interesimit kishte si pikënisje arbëreshët. Për *Mesharin* e Gjon Buzukut misionari arbëresh Filoteo Zasi kishte dijeni shumë vite para letërkëmbimit të Gjon Nikollë Kazazit me Guxetën⁴⁹.

Njohja e letërsisë shqipe të qarkut verior prej arbëreshëve përforcohet edhe prej faktit që Francesco Santori, në veprën e vet *I krishteri i shenjtëruar*, transkriptoi e botoi disa fragmente të veprës *Cuneus prophetarum*⁵⁰.

Bogdani veprën e tij e shkroi *arbënisht*, duke e konsideruar atë si gjuhë të vetëmjaftueshme. Vetëm kur autoritetet fetare i kërkuuan përkthimin italisht, u shtrëngua ta pranojë *gjuhën e garancisë: m'urdhënoi shenjtë Kuvend qi ende italianisht ta kthenjë*, shkruan Bogdani⁵¹. Pikërisht me këtë vepër (1685) nis *tradita e au–*

⁴⁷ Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831, p. 5.

⁴⁸ Bardhyl Demiraj, *Zef Skirò dhe shkrimet shqip*, në *ANASH*, nr. 2/2006, f. 7-14.

⁴⁹ Matteo Mandalà, art. cit.: *Filoteo Zassi, i cili lindi më 1654 në fshatin arbëresh të Mezzoiuso-s në Sicili, vdiq në Romë më 1726, pra, shumë vjet më përpara se Kazazi t'i shkruante letrën at Guxetës. Sikur të konfirmohej njoftimi i Ketës, gjithë historia e zbulimit të "Mesharit" do të duhej rishikuar.*

⁵⁰ F. A. Santori, *Cryshtëu i shënytrurory*, Napoli 1856, p. 212-228.

⁵¹ Transkripti si në *Do copë nga libra e Bogdanit*, në *Diturija*, nr. 7, viti 1927, f. 270: *Mbassi kje për hijr të Tinëzot, qui omnia suaviter disponit, mbaruem vepra e n'krye: të gjithë arbënisht, m'urdhënoj S. Kuvend, qi ende italianisht ta kthenjë, ashtu qi të mundëshinë, jo veçë t'Arbëneshtëtë me xanë italianisht, po ende këta arbënisht, tue u shërbyem possi t'ish një Kalepi: m'u desh pra me*

topërkthimeve të shqipes, që përbëjnë një hap tjetër pavarësimi të saj.

2. Ekzistenca prej vitit 1824 e një dorëshkrimi të *Ungjillit sipas Mateut* tek arbëreshët, që është konsideruar *kopjën i stilizuar* i tekstit të përkthyer prej Vangjel Meksit, merr rëndësi për kohën e fillimit të ndërkomunikimit të tyre me qarkun e shkrimitarëve ortodoksë jugorë. Ngjashmëritë midis *Anonimit Epirot*, sipas emërimit të Zef Skiròit për dorëshkrimin e *Piana degli Albanesi*, me përkthimet shqip të teksteve ungjillore me grafema greqisht⁵², janë të karakterit sistemor. G. Skiròi pohon se *ka pasur në zotërim një dorëshkrim të Ungjillit të Mateut, hartuar toskërisht aty nga viti 1700, si dhe një Doktrinë kristiane të vitit 1755, gjithashtu toskërisht*⁵³. Si ra në duar të kopjuesve arbëreshë përkthimi i vitit 1824; si u gjendën tekstet e hershme të letërsisë ungjillore–katekistike midis arbëreshëve, është një prej çështjeve më interesante për vërtetimin e lidhjeve midis qarkut italo–shqiptar dhe qarkut ortodoks të Jugut në periudhën pararomantike⁵⁴.

Brenda këtij interesimi nuk mund të mbeten pa vëmendje edhe fakte të tilla, si përfshirja e 26 këngëve popullore lirike të Shqipërisë jugore: e 9 këngëve historike gjithashtu jugore – ndër to dhe *Mbeçë more shokë mbeçë*; e 13 këngëve dhe e një *kanisku pro–*

djersë të madhe me qitunë mbë dritë shumë fjalë plaka e të harrueme për të marrë mbrappa urdhënin me mohue.

⁵² Giuseppe Schirò: *Della lingua albanese e della sua letteratura anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, ribotuar nga M. Mandalà, *Giuseppe Schirò, Opere*, vol. VIII, 1996, p. 108.

⁵³ E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BSSHSH*, nr. 2, Tiranë 1959. Këtu citohet sipas ribotimit në *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. Rilindja, Prishtinë 1977, f. 332.

⁵⁴ Gëzim Gurga, *Il Vangelo di San Matteo: Variante inedita del manoscritto di Piana*, edizione critica, tezë doktorate, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006. Idem, *Aspetti linguistici del manoscritto dell'Anonimo Epirota*, në *Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, 16-19 Maggio 2002* (a cura di Matteo Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2003, pp. 281-289; gjithashtu *Dorëshkrimi i pabotuar i Anonimit Epirot*, në *Studi in onore di Antonino Guzzetta* (a cura di Francesca di Miceli e Matteo Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2002, pp. 203 -217.

verbash gege; të gjitha këto prej koleksionit të Johann Georg von Hahn-it; për të vijuar më tej me një përzgjedhje këngësh lirike të arvanitëve të Greqisë, gjithsej 26, me burim nga koleksioni i këngëve të populllore të mbledhura nga Carl E. Reinhold, në *Shtojcën e gramatologjisë së krahasuar të Dhimitër Kamardës*, më 1866.

Ndërkomunikimi midis arbëreshëve e arvanitëve, pastaj mes arbëreshëve dhe qarkut ortodoks jugor tosk, lehtësoi promovimin e gjuhës shqipe në mjedisin ndërkombëtar ose më së paku *aloglot*. Në koleksionin e tij prej 72 variantesh të shëmbëlltyrës së farëmbjellësit të *Ungjillit sipas Matteut*, përkthime në gjuhë të ndryshme të popujve të Europës e të botës, botuar vetëm në 250 kopje në vitin 1857, Louis Lucien Bonaparte, *vëllai kokëkrisur i Napoleonit*, përfshiu dhe një variant në *lingua epirotica*, të cilin e renditi të parin ndër variantet e gjuhëve greko-latine⁵⁵. Vështruar në pikëpamjen dialektore, dorëshkrimi në *lingua epirotica* duket se është i njëjti me atë që Skiròi e pati quajtur *Anonimi Epirot*⁵⁶.

3. Sa u takon lidhjeve midis shkrimtarëve të qarkut katolik verior dhe atyre të qarkut ortodoks jugor, veçojmë faktin se përkthimi i *Dhjatës së Re* shqip prej K. Kristoforidhit u autorizua si tekst kanonik i vlefshëm për shërbesë jo prej kryepeshkopit ortodoks Visarion, i cili e shpalli të ndaluar mësimin e Shkrimit të Shenjtë prej këtij teksti shqip, por prej një kleriku katolik. Ishte pikërisht arkipeshkvi i Shkodrës Pasquale Gerasimi i pari që lejoi leximin e *Biblës* shqip të Kristoforidhit si libër besimi e besimi. Në një letër të dorës së tij thuhet: *Mbështetur në vullnetin apostolik që më lejohet, i jap të drejtë të riut Zef Melgushi nga Shkodra të mbajë dhe të*

⁵⁵ Louis Lucien Bonaparte, *Parabola de seminare ex Evangelio Matthæi, in LXXII Europæas linguas, ac dialectos versa, et romanibus characteribus expressa*, Londini 1857, p. 69.

⁵⁶ Giuseppe Schirò, *Della lingua albanese e delle sua letteratura*, botuar në *Annuario del Reale Istituto Orientale di Napoli*, 1917-1918.

*lexojë “Biblën e shenjtë” përkthyer në shqip prej Kristoforidhit*⁵⁷. Nga ana e tij, në po atë kohë, në fjalorin e tij dygjuhësh shqip–greqisht, K. Kristoforidhi përzgjedhi e përfshiu jo më pak se 450 fjalë–leksema drejtpërsëdrejti prej veprës së P. Bogdanit *Cuneus prophetarum*⁵⁸.

4. Në historinë e lidhjeve kulturore midis arbëreshëve dhe arvanitëve *përpyekja e parë për komunikim përmbi Adriatik u takon arvanitëve*. Panajot Kupitori është autor i përshtatjes më të hershme të dy këngëve nga poema *Këngët e Milosaos* të Jeronim De Radës në të folmen *arvanitika* të ishullit të Hidrës. Me këtë rast, siç ishte në sjelljen e rilindësve, ai e purifikoi gjuhën e De Radës, duke zëvendësuar italianizmat me fjalë të gjuhës së popullit⁵⁹.

Sa i përket ardhjes së letërsisë arbëreshe tek lexuesi shqiptar, kjo ndodhi vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur Kristoforidhi vendosi të përshtasë në shqipen e kohës disa prej kangjeljeve të veprës *Rapsodi të një poemi arbëresh* të De Radës. Këtë përshtatje, që mbeti e pabotuar, e gjejmë në fondin e Kristoforidhit në Arkivin Qendror Shtetëror, me shenjimin njoftues të mëposhtëm: *Ndreqje në dialekt toskërisht të Shqipnis të kangëvet I gjer XIII të librit të De Radës “Rapsodie d’un poema albanese”, Firenze 1866. Këto dorëshkrime ndodhen në dorë të z. Lef Nos*⁶⁰. Pietro Kiara, që kishte dhe njohje personale me Kristoforidhin⁶¹, i entuziazmuar prej

⁵⁷ Pasquale Gerasim, Archieviscovo di Scutari, 18.04.1909: *Il sottoscritto, in base alle apostolica facolta che tiene, accorda al giovane Giuseppe Melgusci di Scutari che possa tenere e leggere La Sacra Bibbia tradotta in albanese dal Kristoforidi*. AQSH, Fondi 132, Viti 1909, Dosja 32, fl. 1.

⁵⁸ Androkli Kostallari (red.), *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe*, në *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, bot. i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë 1989, f. 46-47.

⁵⁹ Njoftimin e parë për këtë Titos Jochallas e jep në studimin e tij *Hidra, gjuha e harruar* (Τίτος Γιοχάλας, *Υδρα, λησμονημένη γλώσσα*), në dy vëllime (τόμ. Α/-Β/), Αθήνα 2006.

⁶⁰ AQSH, *Fondi K. Kristoforidhi*, nr. 29, Dosja 13, fl. 4-5.

⁶¹ AQSH, *Fondi De Rada*, letër e P. Chiara-s nga Roma për Jeronim de Radën, datë 4 prill 1874.

Gramatikës së tij (1882), i shkruante Jeronim de Radës se ajo ishte *një vepër me të vërtetë kombëtare, kushtuar bazave të letërsisë sonë shqipe*, dhe se *ne tashmë nuk shkruajmë vetëm për shqiptarët e Italisë, përpyekjet tona duhet të jenë për t'u bërë të njohur në dheun mëmë*⁶². Veprimtarët e Rilindjes, vite para themelimit të *Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip*, konstatonin se *alfabeti i zbatuar nga Kristoforidhi në përkthimin e Biblës shqip mund të shërbejë si bazë e një alfabeti të njësuar të shqipes*⁶³. Aleksandër Xhuvani, duke iu referuar letërkëmbimit të Kristoforidhit me Nikolla Naçon, shkruan se *Fjalori i tij* (Kristoforidhit) *asht i gjithë gjuhës Shqipnisë. Nuk asht pra Fjalori i një dialekti të vetëm, por i gjithë dialektevet të shqipes, së pari i të dy dialektevet kryesorë, të gegënishtes e të toskënishtes, mbasandaj edhe i dialektevet të tjerë, të çamërishtes e të labërishtes*⁶⁴.

5. Ende nuk është bërë një kërkim i rrafshit tekstologjik–kritik për të provuar një tezë të hershme të E. Çabejt, sipas të cilit strofat e poezisë së Budit, *me ndërtimin e kadencën e tyre, të kujtojnë shpeshherë strofat e poemave të Naimit. S'është çudi, përmbyll Çabej, që poeti i Frashërit t'i ketë ditur poezitë e "Doktrinës" e të ketë gjetur frymëzim në vargjet e autorit të moçëm të Veriut*⁶⁵. Ndërsa kontaktet e drejtpërdrejta njohëse dhe rilexuese midis *shkrimtarëve bejtexhinj*, që kishin në përdorim alfabetë orientale, me qarqet e tjerë, janë më të vonëtat. Ndër të parët që bënë të

⁶² ... *Gia e completata la Grammatica Albanese, opera veramente nazionale, destinata a base della nostra letteratura albanese. Noi non scriviamo soltanto per gli albanesi d'Italia, i nostri sforzi devono essere riaccolti alla Madre Patria*. Letër e Pietro Chiara-s për Jeronim De Radën. AQSH, Fondi 29, Dosja 2, fl. 3-4. Për më shumë: Shaban Sinani, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

⁶³ Më gjerësisht tek Shaban Sinani, *Fondi Kristoforidhi në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

⁶⁴ Konstantin Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, botim i USHT dhe Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë 1961. Botimi shoqërohet me një *Parathënie* nga Aleksandër Xhuvani, f. 10.

⁶⁵ E. Çabej, *Ai vuiri një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare*, artikull i botuar në *Drita*, 2 tetor 1966. Citohet sipas Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. Rilindja, Prishtinë 1977, f. 328.

njohur ekzistencën e kësaj tradite qenë në fillim Naim Frashëri dhe pastaj Faik Konica, i cili kishte vlerësim të lartë ndaj *Zyke Kolonjarit*, siç e quante Hasan Zyko Kamberin, prej të cilit pëlqente më së shumti poezitë satirike, në trajtë epigrami, si *Para-ja*, që është nga ato poezi që rron sot e mot në gojën e popullit⁶⁶. Naim Frashëri e veçonte Hasan Zykon prej bejtexhinjve të tjerë dhe shprehej se *ka zënë kryenë në mest të vjershetorëve të Shqipërisë*⁶⁷. Por për herë të parë poezitë e bejtexhinjve dolën jashtë *burgut* të alfabeveve orientale kur një dijetar i huaj, Johann G. Hahn, vendosi të botojë disa vjersha të Nezimit të Frakullës, të cilin e quante *Anakreont shqiptar* (1854). Gati tri dekada më vonë Thimi Mitko provoi të rishkruante me alfabetin e greqishtes katër poezi të Hasan Zyko Kamberit dhe t'i përkthente e t'i botonte për lexuesin grek, nga të cilat rezultojnë të ruajtura vetëm tri. Me shkrimin e dorës të Mitkos, nën titullin *Poezi nga Hasan Zyko Kolonjoti*, gjenden vjershat e njohura *Për gratë e veja – Graat e vaa*, *Për fatin e vet – Bahti im* dhe *Për paratë – Paraja*⁶⁸. Kështu, më së fundi, kufijtë e qarqeve dhe të alfabeve, bien. Për të ardhur deri tek njësimi i sistemit letrar shqiptar rrugën e përgatiti tradita e dorëshkrimeve, me një qarkullim shumë më të kufizuar, por me vetëdijësimin për ekzistencën e disa formave të të shprehurit të shqipes dhe të nevojës së ndërlidhjes mes tyre.

Procesi i latinizimit grafematik të shqipes ndjek thujtë në simetri të plotë shthurjen e qarqeve letrarë–kultrorë; rënien e multialfabetizimit grafematik, homogjenizimin e letërsisë, kalimin e saj prej nënsistemeve letrarë në një proces të njësuar. Kufirin ndërmjet qarqeve më së pari e rrëzoi komunikimi përdoruesve të shqipes së shkruar përmbi kufirin e alfabeve, së paku *një shekull para se qarqet të derdreshin në lumin e letërsisë kombëtare*.

⁶⁶ Faik Konica, *Vepra* (përg. N. Jorgaqi e Xh. Lloshi), Tiranë 1993, f. 485.

⁶⁷ Naim Frashëri, *Vepra të zgjedhura* (përg. F. Agalliu), vëllimi I, Tiranë 1980, f. 409.

⁶⁸ Jorgo Buló, *Tri tekste poetike të Hasan Zyko Kamberit*, në *Shpirti i fjalës*, Tiranë 2014, f. 219-252.

Bibliografi:

AA, *Do copë nga libra e Bogdanit*, në *Diturija*, nr. 7, viti 1927.

AA, *Hodže i softe protiv latinice (Myftinjë e nxënësit kundër shkronjave latine)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, shkurt 1910.

AA, *Prava buna zbog latinice (Kryengritje e vërtetë për shkronjat latine)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, mars 1910.

AA, *Proterani učitelji (Dëbini i mësuesve)*, në *Vardar*, god. III, Skoplje, shkurt 1910.

AA, *Alfabeto albanese con lettere turche*, Costantinopoli 1861.

AA, *Alfabeto generale albano-epirotico*, Costantinopoli 1861.

ALPAN, Necip P., *Arnavut alfabeti nasıl doğdu? – 100-vjetori i abecës shqipe*, Ankara 1979.

ALTIMARI, Francesco, *Il grafema-bandiera <ë> – I lunghi legami shqiptaro-arbëreshë attraverso la breve storia di una semplice lettera*, *Studia Albanica*, nr. 1, 2008.

ALTIMARI, Francesco, *Un saggio inedito di F. A. Santori sulla lingua Albanese e i suoi alfabeti*, në *Quaderni di "Zjarri"*, 1982.

AQSH, F. 32, V. 1910.

AQSH, *Fondi De Rada*, letër e P. Chiara-s për Jeronim de Radën, datë 4 prill 1874.

AQSH, *Fondi K. Kristoforidhi*, nr. 29, Dosja 13.

AQSH, *Fondi nr. 32, Dosja 31, Viti 1910*.

ARKIVI i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, mikrofili I–II/22, viti 1899–1900, *Mbi alfabetin e gjuhës shqipe e mbi botimin e librave shkollorë* (71 fl.).

ARKIVI i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, mikrofilmi I–II/20, viti 1899, *Mbi botimin e një abetareje dhe alfabetin e gjuhës shqipe* (71 fl.).

ATOLJAK, Stjepan, *Prilog historijata borbe albanaca za svoj alfabet (Ndihmesë për historinë e luftës së shqiptarëve për alfabetin e tyre)*, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë 1969.

BARIC, Henri, *Старина арбанаске писмености (Lashtësia e shkrimit shqip)*, në *Време*, 1. I, Београд 1941.

BOGDANO, Pietro, *Të prinitë përpara letteraritë*, në, *Cuneus prophetarum de Christo Mundi et eius evangelica veritate*, Pattavi MDCLXXXV.

BONAPARTE, Louis–Lucien, *Parabola de seminatore ex Evangelio Matthæi, in LXXII Europæas linguas, ac dialectos versa, et romanibus characteribus expressa*, Londini 1857.

BULO, Jorgo, *Tri tekste poetike të Hasan Zyko Kamberit*, në *Shpirti i fjalës*, Tiranë 2014.

BUSSETI, Antonio, *Esposizione dell'alfabeto adottato nella conferenza dei vescovi albanesi in Scutari*, Shkodër 1902.

ÇABEJ, Eqrem, *Ai vuri një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare*, në *Drita*, 2 tetor 1966.

ÇABEJ, Eqrem, *Studime gjuhësore*, vëll. VI, bot. *Rilindja*, Prishtinë 1977.

ÇABEJ, Eqrem, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *BSHSH*, nr. 2, Tiranë 1959.

CRISPI, Giuseppe, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo 1831.

DE RADA, Girolamo, *Abecedario della lingua albanese*, Corigliano Calabro 1896.

DE RADA, Girolamo, *Caratteri della lingua albanese: suoi monumenti nell'età preistorica*, tipografia G. Galì, Catanzaro 1899.

DEMIRAJ, Bardhyl, *Zef Skiroi dhe shkrimet shqip*, në *ANASH*, nr. 2/2006.

DEMIRAJ, Bardhyl, *La lettera <ë> come testimone della tradizione scritta albanese—arbëreshe e alcuni problemi riguardanti la sua odierna ortografia*, në *Studia Albanica*, nr. 2, 2008.

FAULMANN, Carl, *Das Buch der Schrift enthaltend die Schriften und Alphabete aller Zeiten und aller Völker des Erdkreises (Libri i alfabetëve të të gjitha kohërave dhe të gjithë popujve të botës)*, Druck u. Verl. der Kaiserlich—Königlichen Hof—und—Staatsdruckerei, Wien 1880 (Hildesheim 1986).

FRASHËRI, Naim, *Vepra të zgjedhura* (përg. F. Agalliu), vëllimi I, Tiranë 1980.

GEITLER, Leopold, *Die Albanesischen und Slavischen Schriften*, Wien 1883.

GERASIM, Pasquale, AQSH, Fondi 132 (Archivescovato di Scutari), Viti 1909, Dosja 32.

GOLOVANOV, Ilia (Илья Голованов), *Младо Турции и Албанците (Turqit e rinj dhe shqiptarët)*; në *Българска збирка, кнѣига XVII, София* 1910.

GRAMENO, Mihal, *Mallkim i shkronjavet shqipe*, Korçë, pa vit botimi.

GURGA, Gëzim, *Dorëshkrimi i pabotuar i “Anonimit Epirot”*, në *Studi in onore di Antonino Guzzetta* (a cura di Francesca di Miceli e Matteo Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2002.

GURGA, Gëzim, *Aspetti linguistici del manoscritto dell’Anonimo Epirota*, në *Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi Albanesi, 16–19 Maggio 2002* (a cura di Matteo Mandalà), Università degli Studi di Palermo, Palermo 2003.

GURGA, Gëzim, *Il Vangelo di San Matteo: Variante inedita del manoscritto di Piana*, edizione critica, tezë doktorate, Università degli Studi della Calabria, Cosenza 2006.

HAHN, Johann Georg von, *Albanesische Studien*, Jenna 1854.

JOCHALLAS, Titos, *Hidra, gjuha e harruar* (Τίτος Γιочάλας, Ύδρα, λησμονημένη γλώσσα), në dy vëllime (τόμ. Α/-Β/), Αθήνα 2006.

KONICA, Faik, *Çështja e alfabetit (letër e hapur drejtuar albanologëve më të njohur)*, në *Albania*, nr. 6, viti 1898.

KONICA, Faik, *Vepra* (përg. N. Jorgaqi e Xh. Lloshi), Tiranë 1993.

KOSTALLARI, Androkli (red.), *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe*, në *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, bot. i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë 1989.

KRISTOFORIDHI, Konstantin, *Fjalor shqip-greqisht*, botim i USHT dhe Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë 1961.

MALTE-BRUNE, Conrad, *Oeuvre*, volume VI, Paris 1826.

OSMANI, Tomor, *Udha e shkronjave shqipe: historia e alfabetit*, në *Vepra themelore në albanologji*, bot. i QSA, Tiranë 2009.

PELUSHI, Joan, *Një vështrim i shkurtër historik mbi përkthimet fetare në Kishën Orthodhokse në Shqipëri*, në *Tempulli*, nr. 2, Korçë 2000.

RIZA, Skënder, *Albanska abeceda u naučnoj literaturi*, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1, Prishtinë 1969.

RROTA, Justin, *Per historin e alfabetit shqyp*, në *Hylli i Dritës*, Shkodër 1935, nr. 2.

SANTORI, F. A., *Cryshtëu i shÿintÿrÿory*, Napoli 1856.

SANTORI, F. A., *Articolo etnografico, manoscritto A*, në botimin e F. Altimarit.

SARRO, Italo, *La scuola in Albania nel '700*, në *Hylli i Dritës*, XXXI (2011), nr. 3.

SCHIRO, Giuseppe, *Della lingua albanese e della sua letteratura anche in rapporto alle colonie albanesi d'Italia*, në *Giuseppe Schirò, Opere*, a cura di Matteo Mandalà, vol. VIII, 1996.

SCHIRO, Giuseppe, *Della lingua albanese e delle sua letteratura*, botuar në *Annuario del Reale Istituto Orientale di Napoli*, 1917–1918.

SIENKIEVIČ, I. G. (И. Г. Сенкевич), *Освободительное движение албанскою народа в 1905–1912* (*Lëvizja për liri e shqiptarëve në vitet 1905–1912*), Москва 1959.

SINANI, Shaban, *Fondi i Kristoforidhit në arkivat shqiptarë*, në *Studime për Konstandin Kristoforidhin*, Universiteti i Elbasanit, Elbasan 2002.

SKËNDO, Lumo, *Shoqëri e Stambollit*, në *Diturija*, 1926, nr. 2.

SPIRO, Aristotel, *Alfabeti shqip – miti dhe e vërteta*, në *Shekulli*, nr. 2495, 12 dhjetor 2008.

SPIRO, Aristotel, *Çmëtzimi i diskutimit për alfabetin*, në *Shekulli*, nr. 2516, 9 janar 2009.

VANJA, Stanišić, *Из историје примене словенске писмености за албански језик* (*Nga historia e alfabetizimit të gjuhës shqipe*), në *Баштина*, 1, Prishtinë 1991.

BEQIR META

*Instituti i Historisë – Akademia e Studimeve Albanologjike –
Tiranë*

RRUGËTIMI DREJT KONGRESIT TË MANASTIRIT

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare u hodhën themelet e gjuhës letrare shqipe, të letërsisë dhe të kulturës shqipe në tërësi. Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe, përpunimi i një alfabeti të njëjtë, u bënë në kushte ilegale për shkak të dhunës osmane. Kjo e bënte rilindjen e kombit shqiptar të ndryshme nga rilindja e kombeve ballkanike e evropiane, iluministët e të cilëve punuan në kushte legale.

Një hap apo prelud për Kongresin e Manastirit, ndonëse disi larg në kohë, ka qenë Alfabeti i Stambollit i miratuar në vitin 1879, pas debateve të shumta të atdhetarëve shqiptarë, ku u hodhën poshtë opsionet e shkrimit të shqipes me alfabet arab e grek dhe triumfoi vija e Vaso Pashës⁶⁹ e Sami Frashërit⁷⁰ për një alfabet të mbështetur në atë latin. Ky ishte një vendim me rëndësi madhore, pasi përmes alfabetit sanksiononte edhe ndërgjegjen politike identitare shqiptare, se ata ishin një komb evropian, gjë që Samiu dhe Vaso Pasha e theksonin me forcë. Por ky alfabet, meqë nuk i plotësonte të gjitha fonemat e shqipes (25 kundrejt 36), u plotësua me disa shkronja greke, si rezultat i ndikimit të Jani Vretos në komisionin e përbërë prej tij, Pashko Vasës dhe Sami Frashërit.

⁶⁹ Jani Vreto, *Vepra të zgjedhura* (mbledhur e përgatitur nga Alfred Uçi), Tiranë: 1973, f. 285.

⁷⁰ Sami Frashëri, “Gjuha shqipe”, në: *Alfabetare e gjuhës shqipe*, Kostandinopojë: 1879.

Alfabeti i Stambollit u bë shumë i përhapur në botimet që qarkulonin në Shqipërinë e Jugut, të Mesme dhe jashtë Shqipërisë, dhe filloi të konsiderohej si alfabet kombëtar.⁷¹

Ky alfabet ndeshi në luftën e madhe që iu bë nga qeveria osmane e kisha greke, duke ngulitur thellë në ndërgjegjen shqiptare se ata duhej të luftonin për progresin e tyre kombëtar në shumë fronte.

Në vitet '80 të shek. XIX mësimi i shqipes filloi të bëhej fshehurazi në disa vise të Shqipërisë ose në disa shkolla private.⁷² Këto përpjekje kulmuan me hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë më 1887⁷³, e cila u pasua nga çelja e shkollave të tjera shqipe në Prizren, Pogradec, Rekë, Ohër, si dhe nga hapja e kurseve të fshehta të shqipes në qytete të ndryshme.

Në fillim të shek. XX një hap tjetër madhor ishte futja e gjuhës shqipe në vend të italishtes, në shkollat katolike austriake në Shqipërinë e Veriut. Shqipja u fut si gjuhë mësimi. Kjo u shoqërua me botimin në Vjenë të librave në gjuhën shqipe.⁷⁴

Ky hap u pasua edhe nga futja e shqipes në një masë shumë më të kufizuar në shkollat italiane që ishin shkolla shtetërore.⁷⁵

Hartimi i një alfabeti të ri nga shoqëria “Bashkimi” e françeskanëve në Shkodër më 1899, i mbështetur në shkronjat latine dhe i plotësuar me dy shkronjëza, hartimi i një alfabeti tjetër nga shoqëria “Agimi” e jezuitëve në vitin 1901, i bazuar në alfabetin latin të plotësuar me disa shkronja latine me shkronja diakritike, e shtoi larminë e alfabeteve në Shqipëri dhe i bëri të domosdoshme përpjekjet për unifikimin e tyre. Gjithashtu, deri më 1908, kishte disa botime që bëheshin me alfabetin latin, por me ndryshime midis tyre, si gazetat e revistat “Shqipëria” e Bukureshtit (1897–1898),

⁷¹ J. Vreto, *Vepra të zgjedhura...*, f. 270.

⁷² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: 2002, f. 250.

⁷³ Hysni Myzyri, *Shkolla e parë kombëtare shqipe*, Tiranë: 1973.

⁷⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: 2002, f. 301.

⁷⁵ *Po aty*, f. 302.

“Albania” e F. Konicës (1897–1909), “Kombi”, Boston (1906–1909), “Besa” (1904), “Shqipëria” (1906), “Pellazgu” (1907).

Pararendës të Kongresit të Manastirit ishin dhe tre kongrese gjuhësore nga arbëreshët nën drejtimin e De Radës më 1895 në Korillano Kalabro, më 1897 në Lunger dhe më 1903 në Napoli.⁷⁶ Autorët arbëreshë në përgjithësi, para dhe pas vitit 1908, kanë përdorur alfabetin latin.

Shndërrimi i çështjes së alfabetit unik në një objekt diskutimi në shtypin shqiptar në fund të shek. XIX – fillim shek. XX (në revistën “Albania” e Faik Konicës, Bruksel–Londër, “Shqipëria”, Bukuresht, “Ylli i Shqipërisë”, Bukuresht, “Kalendari Kombiar”, Sofje, “Shqipëria”, Egjipt, “Kombi”, Boston, “Shpresa e Shqypnisë”, Raguzë⁷⁷ etj. Ishte një hap i madh përpara drejt unifikimit.

U bënë propozime për thirrjen e një kuvendi kombëtar për zgjidhjen e kësaj çështje, por presionet e forta të jashtme politike dhe grindjet e ambiciet e brendshme e penguan një nismë të tillë.

Shpallja e kushtetutës në Perandorinë Osmane ishte një ngjarje madhore, e cila do të kishte një impakt të madh në të gjithë Perandorinë dhe në avancimin e përpjekjeve për afirmimin kombëtar të popullit shqiptar. Liritë e shpallura nga kushtetuta përbënin një premisë themelore, pasi u mundësuan atdhetarëve shqiptarë të zhvillonin në mënyrë legale lëvizjen kulturore kombëtare për të hapur shkolla shqipe, për të përhapur me të gjitha mjetet mësimin e gjuhës shqipe dhe lëvrimin e mëtejshëm të saj. Ky ka qenë njëri nga faktorët kryesor që nxiti zhvillimin e mëtejshëm të atij procesi historik madhor të filluar qysh në fillimet e shek. XIX.

Më tej, formimi i komiteteve “Bashkim e Përparim” në të gjithë Shqipërinë, në të cilët aderuan shumë përfaqësues të popullsisë shqiptare si dhe oficerë xhonturq, ishte një faktor tjetër organizativ, politiko–social që do të çonte përpara lëvizjen kulturore e arsimore

⁷⁶ Jup Kastrati, *Jeronim De Rada* (Jeta dhe vepra), Tiranë: 1979, f. 186–194.

⁷⁷ Shaban Demiraj, Kristaq Priti, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë: 2008, f. 47.

të popullit shqiptar. Për shkak të përfaqësimit të gjerë të shqiptarëve në veprimtaritë e këtyre komiteteve në të mirë të lëvizjes kulturore–kombëtare, këto organizata do të shënonin një hap përpara në fuqizimin dhe institucionalizimin e kësaj lëvizjeje.

Komitetet osmane “Bashkim e Përparim” në Vlorë, Berat etj. punuan për përhapjen e gjuhës shqipe, për botimin e librave në këtë gjuhë, për hapjen e shkollave shqipe ose futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore. Ky aktivitet shënonte një nga risitë e zhvillimit të lëvizjes kulturore shqiptare në gjerësi, në trajtë legale, i cili do të çonte në mënyrë logjike drejt përpjekjeve për unifikimin e alfabetit shqip. Prandaj kjo mund të konsiderohet si një nga zhvillimet prelud për Kongresin e Manastirit.

Krahu i moderuar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare parashikonte një periudhë 10–20 vjeçare që në bashkëpunim me xhonturqit shqiptarët të përmbushnin kërkesat e tyre arsimore e kulturore. Zëdhënës i këtij krahu të moderuar u bë Mit’hat Frashëri, i cili drejtonte gazetën “Liria” (1908–1910) në Selanik.

Liritë e shpallura nga Kushtetuta shumë shpejt u sfiduan hapur nga doktrina e “osmanizmit”, e cila ishte shpallur fillimisht në kushtetutën e vitit 1876 dhe u bë pjesë kryesore e programit të Komitetit Qendror “Bashkim e Përparim”, në shtator të vitit 1908. Por entuziazmi dhe ndikimi pozitiv i tyre tek shqiptarët nuk u shuan.

Zhvillim tjetër madhor që i parapriu Kongresit të Manastirit ishte krijimi i klubeve kombëtare “Bashkimi” i Manastirit, i cili ishte ndër klubet më të mëdha e më të rëndësishme që luajti një rol të veçantë në formimin e 40 klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare.

Zhvillimi më mbresëlënës ishte hapja masive e shkollave shqipe në verë–vjeshtën e vitit 1908 dhe në vijim. Numri i tyre u rrit më shpejtësi pothuajse në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë, madje edhe në një sërë fshatrash.

Gradualisht, me rritjen e presioneve xhonturke kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe presionit që pengonte veprimtarinë legale të klubeve, u themeluan pranë tyre Komitetet e Fshehta, të cilat përkrahnin shkollat shqipe, propagandonin idenë e pavarësisë, duke i lidhur këta komponentë të Lëvizjes Kombëtare me shumë me njëri-tjetrin. Ky shënonte një tjetër hap përpara në vendosmërinë e kombit shqiptar për afirmim kulturor.

Botimi i shumë gazetave shqiptare brenda vendit, fenomen që ndodhte për herë të parë në historinë e Shqipërisë, ishte një zhvillim i ri, i cili e bënte të domosdoshëm unifikimin e alfabetit shqip.

Artikulli gjithnjë e më tepër në këtë kohë i idesë për formimin e një shteti autonom shqiptar ishte një prirje dhe frymëzim që ndriçonte perspektivën se ku do të shkonte Shqipëria. Prandaj alfabeti dhe unifikimi kombëtar tashmë do të shiheshin si dy objektiva madhore për krijimin e një Shqipërie autonome.

Intensifikimi i masave xhonturke kundër shkollave shqipe, mbyllja e tyre, presioni i madh kundër lëvizjes kulturore kombëtare shqiptare, përpjekjet e tyre për t'u imponuar shqiptarëve alfabetin arab ishin një etapë e re. Nacionalistët shqiptarë në këto rrethana e panë gjithnjë e më të domosdoshëm avancimin e lëvizjes kulturore kombëtare dhe unifikimin e saj. Unifikimi i alfabetit kombëtar po bëhej kështu një imperativë kombëtare.

Në këtë kohë pati edhe një faktor ndërkombëtar i cili i dha mbështetje lëvizjes kulturore shqiptare duke e shtyrë atë përpara. Kjo ishte ndërhyrja e qeverisë austro-hungareze tek Porta e Lartë që të fuste mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore të viseve shqiptare.

Gjithashtu nacionalistët shqiptarë intensifikuan përpjekjet që gjuha shqipe të futej në sistemin shkollor, në shkollat shtetërore turke dhe në ato të huaja, greke etj. Këto përpjekje rezultuan të suksesshme dhe mësimi i gjuhës shqipe u fut në shumë shkolla të tilla. Në tetor 1908, Ministria e Arsimit nxori urdhëresën që gjuha shqipe të futej

si lëndë mësimi në shkollat shtetërore turke, në shkollat fillore (mejtepet) dhe gjysmë të mesme (ruzhdie). Me gjithë pengesat që nxori administrata osmane, ky ishte një hap i madh përpara. Më tej qeveria xhonturke urdhëroi që mësimi i shqipes të bëhej edhe në shkollat e mesme (idadie) të disa qyteteve.

Të gjitha këto zhvillime e bënë të domosdoshme, por njëkohësisht krijuan edhe premisat për caktimin e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe, i cili tashmë shihej jo vetëm si një problem gjuhësor e kulturor, por edhe si një faktor unifikues politik e shpirtëror.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare, edhe pas shpalljes së Kushtetutës, ruajti karakterin e saj të pavarur politik dhe objektivin themelor të saj, realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Ky tipar i saj do të bënte që Kongresi i Manastirit të artikulonte qartë edhe kërkesa politike, administrative autonomiste.

Afirmimi i Klubit të Manastirit si një klub qendror ishte një hap i rëndësishëm drejt unifikimit. Ky rol ka ndikuar pozitivisht në thirrjen e Kongresit të Manastirit dhe ishte një parakusht i thirrjes së tij. Gjithashtu, fuqizimi i këtij Klubi dhe rënia e peshës së Klubit të Stambollit para Kongresit dhe sanksionimi i kësaj pozite nga Kongresi, dëshmonin se Lëvizja Kombëtare Shqiptare po e shmange influencën xhonturke, e cila ishte më e theksuar tek Klubi i Stambollit.

AVZI MUSTAFA

Studiues, Shkup

PROPOGANDA SERBE KUNDËR ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE

Menjëherë pas Hyrijetit, në shumë qendra e qytete jashtë dhe brenda Shqipërisë, si në: Stamboll, Korçë, Elbasan, Manastir, Shkup, Bukuresht, Sofje, Selanik etj. u ngritën klube dhe shoqata, duke nxjerrë gazeta dhe revista në gjuhën shqipe. Krahës këtyre, hov relativisht të madh mori edhe përhapja e arsimit në gjuhën shqipe.

Një ndër problemet imperative të kohës ishte zgjidhja e mirë dhe e plotë e shkrimit të gjuhës shqipe, si çështje që ende nuk kishte gjetur zgjidhje përfundimtare. Edhe pse alfabeti i Stambollit 1879 ishte aprovuar nga shumica e intelektualëve shqiptarë, ende përdoreshin alfabetë të tjera.

Që t'i jepej fund kaosit të alfabeteve që përdoreshin si nga shqiptarët ashtu edhe nga albanologët e huaj Klubi i Manastirit "Bashkimi" e mori mbi vete të organizojë një Kongres kombëtar, do të thosha një parlament gjithëshqiptar. Në Kongresin e Manastirit që u mbajt prej 14–22 nëntor 1908 nuk u morën vetëm qëndrimet për shkronjat shqipe, por u bisedua për një program operativ për t'i realizuar kërkesat shekullore të shqiptarëve. Dhe kështu gjatë ditëve të Kongresit u hartuan kërkesat në 18 pika dhe u autorizua Shahin Kolonja që t'i dërgojë për miratim te deputetët shqiptarë në Stamboll.

Armia e shqiptarëve qoftë të brendshmit apo të jashtmit me të dëgjuar se po përgatitet të mbahet një Kongres, menjëherë morën iniciativa për ta ndaluar atë. Sipas disa burimeve nga shtypi i kohës,

kuptojmë për lajmërimin e qeverisë turke që të mos japë leje për përdorimin e germave latine dhe për hapjen e shkollave shqipe.

Çështja e alfabetit shqip dhe e shkollës shqipe ishte një ndër faktorët kryesorë për një luftë gjithëpopullore. Sipas një enciklopedie serbo-kroate-slovene, libri II në faqen 650 thuhet: "se lufta e Shqiptarëve ishte pikërisht rezultat i asaj që kur Turqia dëshironte që shqiptarëve t'ju imponojë alfabetin turk, dhe për të penguar këtë ai ngriti shumë kazerna xhandarmerie në vendet me popullatë shqiptare, hapte shkolla turke dhe në fund bëri edhe çarmatimin e tyre".

Patriotët shqiptarë punuan në këtë drejtim me një mjeshtri shumë të madhe. Nëpërmjet Kongresit u trajtuan dy anë të të njëjtit qëllim që kishte karakter politiko-shoqëror, ngase nëpërmjet shkronjave shqipe mori hov të madh përhapja e arsimit si dhe lëvizja kombëtare në përgjithësi.

Jehona e mbajtjes së Kongresit mori përmasa të gjera, ashtu siç njofton prof. Kristaq Prifti, jo vetën në tokat shqiptare, por edhe jashtë. Për këtë Kongres shkruan gazetat frënge, italiane, zvicerane etj.: "se shqiptarët do të mblidheshin në Kongres për qëllime politike ose kishin ndërmend të diskutonin çështjen e pavarësisë, se Kongresi mund të shndërrohej në një bashkim politik".

Qarqet reaksionare të vendit si dhe shtetet shovene ballkanike prinin që tani germat të jenë "mollë sherri" për përçarje edhe më të madhe. Shqiptarët nga ky Kongres dolën edhe më të bashkuar duke i treguar botës se edhe ata janë një popull, se kanë një gjuhë, se edhe germat duhet të jenë të përbashkëta.

Xhonturqit dhe aleatët e tyre nëpërmjet disa deputetëve tradhtarë dhe disa feudalëve dhe fanatikëve fetarë përsëri e shtruan problemin e çështjes së alfabetit në Parlamentin e Turqisë. Këta dolën me tezën se popullsia myslimane "gjoja ka qenë dhe janë për alfabetin turko-arab, i cili njëherazi është dhe alfabet i Kur'anit, kurse alfa-beti latin e prish fenë myslimane dhe se me të nuk shkohej në Qabe". Kështu xhonturqit nuk lanë gurë pa lëvizur për të sjellë huti

e përçarje të shqiptarët nëpërmjet propagandës antikongresiane dhe antishqiptare.

Milefi i akumuluar i merimangave turke në Shkup, nëpërmjet të një shoqërie që mbante emrin "shoqata për të shkruar gjuhën shqipe me germa osmane", organizuan një mbledhje, të cilën e quajtën "Kongres" për të cilin shumë pak dihet, për arsye se nuk bëri jetë në masat e gjëra, sepse ky ishte vetëm një mendim ose kërkesë e një deputeti nga Shkupi Seid Efendisë, duke trumbetuar se muslimanëve me Kur'an u është ndaluar të shkruajnë nga e majta në të djathtë.

Shqiptarët e Shkupit, pasi i dëgjuan këto marifetllëqe, u prononcuan me një artikull "Nga një zemër shqiptare". Në të thuhej: "Dje u mbajt këtu një kongres prej ca nga të parët e vendit, të cilët vendosën ta përdorin alfabetin me shkronja arapçe për shkollat e Shqipërisë... Atë alfabet që vendosën të përdorin këta zotërinj, le ta mbajnë për vetën e tyre, asnjëri s'e njeh, as do ta njohë, s'e di, as do ta dijë. Shqipëria e tërë ngrihet në këmbë për me thanë: Turp i madh për këta njerëz! (Po themi njerëz për mos me thënë ndryshe!)"

Propagandat e ndryshme, si nga xhonturqit ashtu edhe nga fanatikët e klerit fetar, nuk kishin të ndalur. Ata filluan të agjitojnë me të madhe pa zgjedhur mjete, duke organizuar peticione, mbledhje e mitingje për t'i dërguar kryeministrit të Perandorisë Osmane që shqipja të shkruhej me germa turko-arabe. Ministri i arsimit turk, më 6 shkurt 1325 sipas Hixhrës lajmëron se qeveria turke ndaj alfabetit të arnautëve mbetet neutrale. Po kjo nuk ndodhi kështu sepse Ministri i Arsimit kishte deklaruar se "gjuha shqipe" në të gjitha shkollat do të mësohej vetëm me shkronja arabe". Në një raport të nxjerrë nga fondi J. Jovanović lexojmë edhe këtë se: "gjithë bota ka pranuar shkronjat arabe edhe Vilajeti i Kosovës do të ta pranojë këtë":

dhe se është sjellë një rezolutë se "germat latine janë në kundërshtim me Sheriatin dhe se banorët e kësaj ane kërkojnë që të mbyllen të gjitha shkollat në gjuhën shqipe dhe të ndalohen librat të shkruara me alfabetin latin".

Sipas konsullit Jovanoviq dhe në bazë të dokumentacionit që posedojmë, qartë shihet se si pushteti osman bën luftë të ashpër që të mos lejojë hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, e sidomos moslejin e përdorimit të shkronjave latine. Sipas një dokumenti të lëshuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë edhe Serbia e në mënyrë indirekte e kundërshtonte përdorimin e shkronjave latine ku i kërkohej qeverisë turke që të mos japë leje për përdorimin e germave latine dhe për hapjen e shkollave shqipe, sepse shqiptarët me fe islame Serbia i konsideronte si turq. Sipas shënimeve të Jovanoviqit kuptojmë se si përgjigjet qeveria turke ku thuhet: "Problemi i hapjes të shkollave shqipe është çështje që duhet të diskutohet në parlament, e sa u përket germave ajo është çështje e shtypshkronjave".

Nga një dokument tjetër të këtij diplomati gjithashtu kuptojmë se si deputeti shqiptar në Parlamentin Osman, Hasan Prishtina ithtar i shkronjave latine ka dërguar nga Shkupi telegramin ku thuhet se "Vilajeti Kosovës ka nevojë për 10 mësues të gjuhës shqipe. Të gjithë ata që dëshirojnë të kryejnë këtë shërbim le t'i drejtohen klubit "Bashkimi", kurse në Stamboll klubit "Sabah".

Një dokument tjetër që mban datën 3 shkurt (II), 1910 nr. 234 marrim njoftime për nxënësit e Idajes së Shkupit ku një pjesë e madhe e nxënësve kanë përfillë latinishten. Deputeti në Parlamentin turk, Said Efendiu ka shkruar në Idajë që të këshillojë dhe të bëjë presion për heqjen dorë nga shkronjat latine. Nga numri i nxënësve : "12 nxënës kurrsesi nuk kanë pranuar dhe i kanë larguar nga shkolla". Po ashtu kuptojmë se gjoja Said Efendiu ka shtypur (mendohet se ka sjellë A. M) një Abetare me germa arabe dhe e ka shpërndarë ndër shqiptarët". Po në të njëjtin dokument shkruan se "qeveria turke pengon përdorimin e shkronjave latine, por shqip-

tarët nuk rrinë duarkryq”. Sipas të njëjtit dokument, shohim se “katër (4) nxënës po përgatiten për të mësuar në shkollën e Elbasanit, kurse 4–5 nxënës të tjerë i financon klubi shqiptar i Stambollit, ku këtyre iu është siguruar kostume dhe para rruge. Ndihma sigurohet nga Lidhja e Stambollit, sepse klubi i Shkupit nuk ka para”.

Nga një dokument që mban datën 4 shkurt 1910, nr. 235 dërguar Dr. Millovan Millovanoviqit , Ministër i Punëve të Jashtme i Serbisë qartë shihet se si konsulli nga Shkupi e njofton për mospagesën e mësuesve në shkollat e jezuitëve në Gjakovë e Janjevë nga ana e Austrisë (nxënës shqiptar te besimit katolik A. M) dhe se “ka nxënës dëshirojnë të mësojnë në gjuhën serbe dhe të dërgohen sa më parë mësues serb që të jenë rreth tyre”.

Në dokumentin që mbanë datën e 10 shkurtit 1910 nr. 87 mësojmë edhe për reagimin e valiut të Shkupit I cili i ka dërguar telegram në Ministrinë e arsimit në Stamboll duke u kanosur “ se të gjithë ato shkolla që mësojnë me shkronja latine do të mbyllen”. Pastaj në dokument përshkruhen edhe masat që I ndërmerë pushteti vendit ndaj idhtarëve të shkronjave latine. Nga ky dokument kuptojmë masat represive të pushtetarëve turq. Ata e pushuan nga puna mësuesin e gjuhës shqipe , Bedri Efendiu (Pejani), pastaj komandantin e xhandarmerisë Sheli, sepse djali i tij është përkrahës i shkronjave latine dhe është larguar nga shkolla e Idadies, po ashtu është larguar edhe një nëpunës dogane. Dhe të gjithë ata që u kanë gjetur libra me shkrim latin janë gjobit me rrogë. Po ashtu edhe një mjek i komunës është larguar nga puna , sepse emrat dhe diagnoza e të sëmurëve ka qenë të shkruar me shkronja latine . Klubit të këtushëm (e ka fjalën për klubin e Shkupit) i është hequr tabela e mbishkrimit pse ka qenë e shkruar me shkronja latine.

Në një dokument të fondit të Jovanoviqit janë përshkruar edhe masat ndaj atyre të cilët kanë shkruar telegrame për përkrahjen e shkronjave latine, ku ndaj tyre parashihet edhe internim në Anadoli.

Dokumenti që mban datën 13 shkurtit 1910 nr. 331 jep të dhëna për aktivitetin e Klubit të Shkupit dhe ndër të tjera potencohet se ky klub po përdor gremat latine. Valiu bashkë me deputetin, Said Efendia kanë mbajtur mitingje në Sjenicë, Ferizaj, Gjakovë, , Prishtinë, Shkup,, Pejë, Gostivar, Dibër, Tetovë, Preshevë e gjetiu me qëllim bindje dhe heqje dorë nga shkrimi latin. Ata njoftojnë Sulltanatin “edhe pse banorët janë përcaktuar për gremat latine autoriteti i tyre dhe bindja me fakte ka suksese” . Mirëpo, Said Efendiu dhe turkofilët nuk mund të pajtohen me këtë të vërtetë dhe ato dërgojnë depeshe në Sulltanat duke thënë “ se mileti i këtyre vendeve janë manipuluar dhe mashtruar nga armiqtë e jashtëm”.

Said Efendiu do të shkruaj një telegram ku do të njoftojë se gjoja: “Shqiptarët e të gjithë vilajeteve kanë vendos të mësojnë me shkronja arabe dhe se mitingjet janë organizuar sipas porosisë”.

Për të bindur qeverinë Osmane se gjoja angazhimi i tyre po jepte fryte ato edhe gjerat që s’ kishin lidhje me shkronjat as me shkollën i trillonin duke raportuar mbi gjendjen e mos përfilljes së shkronjave latine. Kinse në Gjilan shkruanin se gjoja janë djegur orenditë shkollore dhe se janë rrahur dy mësues pse kanë përdorur shkronjat latine. Nga të gjitha vendbanimet shqiptare gazetat turke informonin se gjoja dëshpërimi është shumë i madh te banorët shqiptarë me fe myslimane. Nga fondi Jovanoviqit kuptojmë se edhe një mësues i një shkolle private në Gjilan ithtar i shkronjave latine ia kanë ndaluar punën dhe do të përgjigjet.

Ndër kohë simpatizuesit e shkronjave turko-arabe nga klubi i Ak-Sarajit "Mahfel" dërguan njëfarë Arif Hiqmeti kinse gazetar nga fshati Llojan i Kumanovës ta studiojë gjendjen dhe të kontaktojë me parinë muslimane për të krijuar një besim se shkronjat turko-arabe janë shkronjat e Zotit dhe ai di vetëm ato t'i lexojë, kurse shkronjat gjahure Zoti nuk i pranon dhe i dërgon të gjithë në xehenem. Për këtë turkofil nga fondi i Jovanoviqit është edhe një dokument ku shihet qartë puna e tij dhe shumë të tjerëve që puno-

nin në dëm të shqiptarëve: “ se në Shkup shoqëria për të shkruar gjuhën shqipe me shkronja osmane po punon për të krijuar një alfabet turko–arab dhe obligon shtypshkronjën e Vilajetit në emër të Këshillit të shoqërisë të shpikin 3–4 shkronja plus për të shkruar gjuhën shqipe.”

Derisa po zhvillohej një luftë rreth këtij problemi, patriotët shqiptarë filluan pa leje që të hapin shkolla në gjuhën shqipe jo vetëm nëpër qytete, por edhe në mjaft fshatra. Dhe, kështu, u çelen shkolla në viset e Korçës, Elbasanit, Prizrenit, Beratit, Manastirit, Janinës, Prishtinës, Shkupit, Ohrit, Dibrës, Pejës etj.

Çështja e alfabetit dhe shkollës shqipe sipas vendimeve dhe veprimëve që ndërmerre qeveria dhe shërbëtorët e tyre po bëhej serioze. Ato vepronin jo vetëm me propagandë, por edhe me metoda shtypëse për ndalimin e alfabetit shqip. Kësaj propagande antishqiptare iu bashkëngjiti edhe kisha ortodokse edhe pse nuk i interesonte drejtpërsëdrejti alfabeti turko–arab, por dëshironte që nëpërmjet të kësaj kishe t’i përçante shqiptarët. Kësaj propagande iu bashkëngjiti edhe austriakët dhe italianët. Por, populli shqiptar pa dallim feje e kishte kuptuar fare mirë qëllimin se ç’kërkonin turqit e të tjerët. Por, populli, nuk qëndronte duarkryq.

Nga ky fond kemi gjetur edhe një dokument ku shihet se Komiteti i shoqërisë shqiptare të Sofjes i cili është drejtuar qeverisë së Beogradit për ndihmë për të hapur shkolla në gjuhën shqipe, mirëpo përgjigja ka qenë negative.

Sipas një dokumenti që gjendet në Arkivin e Maqedonisë (dokumenti mban nr. 74 të 18 shkurtit 1910) thuhet se: “Turqit e rinj janë angazhuar që të organizojnë protestë kundër shkronjave latine të arnautëve. Nga shumë qytete kjo proteste nuk ishte e mirëpritur, kurse sukses ka pasur vetëm në Ohër – atje kanë mbledhur 3000 frymë”.

ПОЛИТИКА

Француска влада.

Бријан је успео да састави нови кабинет.

Нова француска влада састављена је и данас не се преставити парламенту. Бријан је председник и министар унутрашњих дела и министар привредних послова, Бору правде, Пашон спољних послова, Кошери финансија, Думерг просвете, Миљеран грађевина, поште и телеграфа, Жан Дипи трговине, Ријо привреде, Трујо министар колонија, Викијан министар јавних радова. Као министар војни ушао је у кабинет генерал Брен, а за министра морине узет је адмирал Лапенерр. Нова влада ће спремити изборе и свршити буџет на основима прелогa старог кабинета.

Битољска писма.

— Бугари проналазе нова средства у борби против Срба. — Број бугарских чета расте. — (Нарочити извештаји. Политички.)

Бугарска пропаганда не бира средства, само да би дојакла Србима овога краја. Не устеже се да употребни ни најгаднија средства, само да Српству пакост нанесе. Потплаћују учитеље, поштинике, војводе, четнике, кметове, па чак и жене да пређу на бугарску страну. Нави су немиле тропили, али кад су видели да им то не доноси велике утехе, они су окренули лист и латили се средстава, која само њима личе. Поткупили су четари харамџе и качаке (одметнике од власти) да силом сељацима натерују да признаду егзархију и да се изазову Бугарима.

Али и поред оне изродне, снала Б га не моли* Бугари су и овде напали на врло јак отпор. Јер сељаци плаћају глобе, губе главе, али се ипак српски не одричу. Бугарска пропаганда не зна шта ће од јарости што ј ј бр овј арамијски план није успало. Најтеже им је што ништа не могу да учине у Горњој Реци, на коју су се бесо-

душта морала се чистити из Горње Реке и отићи у Софију да својим гласама јавно, да ни свај барут не пали.

Из овога се лепо види да је Бугарска заиста „словенска“ земља, те је сада запела и тропи немилнице да пошто пото сузбије словенски, а да уведе арнаутски језик у дебарском крају. Ја ни да ли су они! Не знају још како ће им се то љуто осветити!

*

Поверљивост овдашњег бугарског клуба, неки бивши четник Тасе отишао је пре неки дан у једно оближње село Бери Мечка и у име клуба затражио од сељака 30 турских лира и три паганова револвера. Сељаци то јавне властима, али се оне гладнице из клуба нађу упућени, те нареду Таси да се одметне и да се сељацима добро освети. Сад су овд кукавци у великом страху, јер се б-је да са Тасом не д-ђу и остале бугарске чете, које по овој околности крстаре.

*

Пре два дана стигла је овамо једна група Бугара из Софије на челу са неким старим учитељем Ганчевим, који тобож иде да прослави свој четрдесетогодишњи јубилеј учитељске службе у Прилепу. Не знамо шта овога чичу у ствари привлачи Прилепу, али знамо да је у неговом друштву било и таквих људи, који ће ов га лета многе празнике славити по прилепским и мориховским планинама. Елем, нича је ктдо да се покаже као добар патриота, а то онда знати, да треба што више лудати Србе. Случајем неким један млад Србин, трговац из Бит-ла, нашао се са Гончевим у железничком купеу и понеду реч о приликама у Македонији. Гончев уопште свога сапутника шта је и кид је добио одговор да је Србин, стаде најгаднијим речима вређати Србе. У сукобу који услед тога настаде, сличите свипратиони старчеви на Србију, који их се отресе тек кад им он припрети револвером. Аспарухови потомци се поклонили и одмах повикаше у мајмине црне

Propaganda serbe nuk ka të ndalur edhe pse shkronjat shqipe kishin marrë udhën me këto shkronja të arta u shtypen librat për shkollat shqipe, mirëpo në gazetën “Politika” Beogradit nr. 1970/ korrik, 1909 me titull “Bitolska pisma” do të shkruaj se “Një i përdal nga Reka e Epërme, vëllau i priftit Todor (fjala është për Josif Bagerit) thotë se i ka mbushur trastet me abatare shqipe të bozuara në Sofje më 1908 dhe i dërgon në vendlindje për të hapur shkollë në gjuhën shqipe. Sepse mitropolia bullgare nuk mund të hapin shkollë në gjuhën bullgare.. Ja se si do të shkruaj gazetari serb. “Me të arritur në vendlindje bashkëqytetarët janë organizuar për ta larguar dhe se kërkojnë mbrojtje nga shteti” pastaj shkruajnë se Mitropolia bullgare është e paguar me napolana nga shqiptarët se mitropoliti bullgar duhet sa më parë të largohet sepse nuk angazhohet për të hapur shkollë në gjuhët sllave , por në atë shqipe”.

I tërë populli u orientua në mbrojtje pa dallime fetare e krahinore. Të parët që i dhanë forcë vendimeve të Kongresit ishin nxënësit e Idadijes së Korçës, më pastaj ish-nxënësit e shkollës së Janinës, Manastirit, kurse nxënësit e Elbasanit e braktisën tërë shkollën dhe bashkë me popullin ku protestuan mbi 7000 veta. Drejtori i Idadijes së Shkupit pse e ndërroi qëndrimin, e pushuan nga puna. Në Berat e ndoqën shembullin e elbasanasve dhe dolën për t'i mbrojtur vendimet e Kongresit mbi 15.000 veta.

Këto veprime patriotike të nxënësve si dhe të shumë patriotëve qartë i treguan pushtetit osman dëshirën e zjarrtë të popullit shqiptar për gjuhën dhe shkollën shqipe. Pas kësaj dëshire nuk qëndronin vetëm nxënësit, patriotët, intelektualët, por tërë populli shqiptar pa dallim feje. Me veprimet e tyre qartë treguan se mbrojtja alfabetit dhe gjuhës shqipe me të vërtetë shënon një faqe të lavdishme të historisë sonë dhe është një mësim i qëndrues në momente vendimtare.

XHEVAT LLOSHI

Studiues, Tiranë

RAPORTIMET PËR KONGRESIN E MANASTIRIT

Njoftimet për Kongresin e Manastirit kanë qenë disa, por rëndësi më të madhe kanë ato prej pjesëmarrësve drejtpërdrejt në punimet e tij dhe ndër ta vendin kryesor e zë Raporti i Gjergj Qiriazit. Ke-mi dy kopje dorëshkrim të tij me titullin anglisht *Report of the Albanian Congress held in Monastir 1/14 November 1909*. Janë shkruar me dorën e Parashqevi Qiriazit, ndërsa kanë në fund nënshkrimin e Gjergjit, por me dy data të ndryshme: i pari *Monastir, 16/I/1909, Geo. D. Kyrias*; i dyti *Monastir 20 Jan. 1909. George D. Kyrias*. I pari është nxjerrë nga Arkivi i Shoqërisë Biblike të Londrës, i dyti nga Arkivi Shtetëror dhe Perandorak i Vjenës, prandaj ka edhe vulën e këtij arkivi si në faqen e parë, edhe në faqen e fundit. Pyetja e parë është përse i njëjti raport është dërguar në Stamboll për Londrën dhe në Vjenë?

Që nga viti 1894, pas vdekjes së të vëllait, Gjerasimit, vendin e tij me disa luhatje e zuri Gjergji si depozitar i Shoqërisë Biblike në Manastir. Pas daljes në pension të A. Tomsonit, në krye të agjencisë së Stambollit erdhi Thomas Robinson Hodgson-i (?-1924) dhe, si të thuash, Gjergji ishte nëpunës i tij, merrte prej tij pagën pa të cilën nuk mund ta mbante familjen ngaqë ishte realisht i varfër. Ndërkaq, Gjergji ishte një veprimtar i përfshirë thellë në lëvizjen kombëtare dhe këto dy anë pajtoheshin plotësisht në pikëpamjet dhe në punën e tij. Mirëpo do ta pranojmë, që Shoqëria Biblike nuk mund ta paguante për veprimtarinë atdhetare dhe nuk mund të mbante përgjegjësi për këtë. Një rast kur doli në dukje kjo dyanshmëri, që do të shihej si praktikisht edhe me ndonjë pasojë, ishte kur ai u interesua për dorëshkrimin e Fjalorit të K. Kristofo-

ridhit më 1902. E kam shtjelluar hollësisht këtë ngjarje, prandaj po kufizohem të them shkurt, se për atë mori vesh edhe Hoxhsoni dhe i tërhoqi vërejtjen Gjergjit. Pas kësaj ai do të kujdesej që ta informonte rregullisht për të mos lënë shteg për keqkuptime.

Ndërkaq, njoftimet e Gjergjit luanin rol parësor për të mbajtur të gjallë interesimin e të huajve për ecurinë e lëvizjes kombëtare shqiptare, për ngjarjet që lidheshin me synimet e tyre në atë pjesë të Ballkanit, domethënë për të pasur pjesë ndikuese edhe në orientimet e kulturës së vendit, për të ndihmuar shkollën shqipe, për të botuar libra. Fjalët e tij shkonin në institucione shtetërore me peshë, duke dhënë paraqitjen e drejtë, mbi të cilën do të mbështetej marrja e vendimeve nga ana e tyre. Fjalët e tij dilnin në shtypin e huaj dhe këtë e tregon citimi i tyre në periodikun e Shoqërisë Biblike që në vitin 1903. Ai është kujdesur që të sigurojë mbështetjen financiare për shtypshkronjën e Manastirit nga disa palë të huaja dhe e ka arritur këtë. Sipas analizave të tij, Shoqëria Biblike do të përcaktonte se çfarë ribotimesh të përkthimeve biblike do të bëheshin dhe çfarë përkthimesh të reja e vlente të ndërmerreshin, sa do të ishte tirazhi dhe në cilin dialekt. Në këtë rreth bënte pjesë edhe çështja e alfabetit si hallka e parë. Ai i ka rekomanduar Hoxhsonit që të mos ndërmerreshin shtypje të reja derisa të vendosej një alfabet i përbashkët për gjithë vendin. Këtë e ka bërë përpara se të mblidhej Kongresi, domethënë e parashihte si të afërt.

Raporti i Qiriazit nuk është botuar në përmbledhjen e rëndësishme “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit” të vitit 1972, ku janë materialet e konferencës me rastin e 50-vjetorit. Arsyeja është te mbrapshtitë politike të kohës, ndërkohë që përkthimi i tij me besnikëri nuk është botuar deri më sot në shtypin shkencor. Megjithatë, dëshiroj të tërheq vëmendjen te një anë shumë më e qenësishme. Studiuesit deri më sot janë marrë me çështjet filologjike në Raport, me anën kronologjike të punimeve, me diskutimet për secilën shkronjë dhe me qëndrimet e pjesëmarrësve, e sidomos me vendimin përfundimtar. Pa e vënë në dyshim vlerën e këtyre

vështrimeve, nuk mund të mos vërej, se nuk është kapur thelbi i asaj parashtrëse.

Gjergj Qiriazhi nuk kishte për qëllim të linte një procesverbal për interesat e historianëve dhe të filologëve. Synimi i tij madhor ishte aktual i drejtpërdrejtë: të tregonte përpara përfaqësuesve të huaj një arritje të çmueshme të lëvizjes shqiptare, t'u dëshmonte frymën e bashkimit të mishëruar në një kuvend gjithëkombëtar për të tërhequr mbështetjen e tyre të pandërprerë. Synimi i tij ishte t'i dëshmonte Shoqërisë Biblike perspektivat e reja që hapeshin, në mënyrë që ajo ta vazhdonte financimin e librave shqip dhe përhapjen e tyre. Synimi i tij ishte të tregonte emrat e rilindësve me autoritet dhe shoqëritë e tyre, që kishin marrë në duar fatet e lëvizjes. Synimi i tij ishte të tregonte të ardhmen e lëvrimit të shqipes dhe të mënjanohej ndonjë dyshim për shkak të zgjidhjes si kompromis me dy alfabetë të pranuara, prandaj për këtë ka ndarë veçan një syth të Raportit. Dhe më së fundi, synimi i tij ishte edhe personal: me këtë mënyrë ai dëshmonte vlerën e punës së vet, që e meritonte të vazhdohej me përkrahjen e tyre, por edhe të shprehte lavdërimet e shqiptarëve kundrejt Shoqërisë Biblike, lavdërime me të cilat e ka përfunduar. Me fjalë më pak të larta, parashtrësja e tij ishte një material informues dhe propagandistik për lëvizjen kombëtare shqiptare dhe për veten e vet. Ndërkaq, ai nuk kishte dyshim, se mbi Raportin e tij do të përgatiteshin materiale të tjera, ashtu siç ndodhi në të vërtetë, që do të gjenin rrugë edhe në shtypin e kohës. Dhe të gjitha këto janë bërë me një modesti të adhurueshme, sepse siç jam përpjekur ta argumentoj në një libër të plotë, ai ishte organizatori kryesor i atij Kongresi.

Th. R. Hodgson-i me të marrë Raportin, përgatiti prej tij më 22 janar 1909 një relacion të vetin me titullin “Alfabeti i gjuhës shqipe” dhe të nesërmen ia nisi Londrës. Është e pamundur të lexohet ai këtu, por e kam botuar 15 vjet më parë. Do ta quaja një konspekt të raportit të Gjergjit, në të cilin Hoxhsoni ka shtuar për Komitetin e Shoqërisë në Londër këndvështrimin e tij, i cili na-

tyrshëm do të përçonte edhe interesin për ta paraqitur sa më mirë punën e vet. Po shënoj vetëm që ai e quante se Gjergji përfaqësonte në mënyrë të denjë Shoqërinë Biblike. Pa dyshim, Gjergji ishte një përfaqësues i denjë, por i Klubit Bashkimi të Manastirit. Hoxhsonit i ka bërë përshtypje atmosfera e përgjithshme e mbledhjes, të cilën ai e ka perceptuar drejt nga teksti i Gjergjit, dhe po citoj vetëm dy rreshta prej tij: “Me të vërtetë gjatë gjithë vargut të mbledhjeve shpirtrat e zjarrtë të shqiptarëve dukej sikur ishin ndezur në kulm, duke gjetur më në fund një rast për të shprehur lirisht zjarrin atdhetar në lirinë e mbledhjes e të fjalës, që sapo i kanë fituar”. Me kënaqësi të veçantë ai përmend sythin kushtuar Shoqërisë Biblike dhe fjalët e fundit të raportit: “Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja u dallua se meritonte një përmendje të veçantë. Raporti zyrtar mbaron me këto fjalë: “Kështu u bë ky Kongres dhe mbaroi pasi hodhi themele të forta për një Shqipëri të ardhme.” Raporti i Hoxhsonit u diskutua në një mbledhje të veçantë të Nënkomitetit të botimeve në Londër dhe kjo është regjistruar në procesverbalet e tij, domethënë kemi një konspekt më të ngjeshur të raportit të Hoxhsonit. Nuk ka vërtetim më bindës, se synimet e përmendura më lart të Gjergj Qiriazit ishin arritur me sukses. Sapo të kishte mundësi, Hoxhsoni do të paraqiste planet e propozimet e veta për versionet e reja shqip, që priteshin me aq padurim e që kërkoheshin aq shumë nga gjithë shqiptarët.

Por përpara Hoxhsonit ministri i jashtëm britanik, Sir Edward Grey, është njoftuar nga Stambolli prej ambasadorit Gerard Lowther mbi bazën e një raportini prej të ngarkuarit konsull britanik në Manastir, W. S. Edmonds vetëm dy ditë pas mbylljes së Kongresit. Nuk e di se nga i ka mbledhur të dhënat, sepse ka disa pasaktësi, që vërtetojnë se nuk i kishte prej Gjergjit, për shembull, përmend nga vendimi vetëm alfabetin e Stambollit, por e ka kapur drejt thelbin: “Delegatët me të drejtë e shohin atë si një hap të ngjashëm me bashkimin kombëtar dhe si çështjen e parë që i ka bashkuar shqiptarët që prej ditëve të Ali Janinës”. Do ta quaja shkurt një nënraport. (Botuar në *Rreth alfabetit të shqipes*, 2008).

Kopja e dytë e Raportit të Gjergjit ishte për Vjenën. Konsulli austriak August Kral (1869–1953), i cili tashmë është shpallur Qytetar nderi i Shkodrës, sepse ndërhyri më 1903 kur u ndalua shqipja në Shkollën e vajzave në Korçë, që nismëtar i punës për Komisinë Letrare të Shkodrës, përcolli kërkesën për subvencionimin e “Kombit” të S. Pecit e deri ndërmjetësoi pranë Vjenës për shqiptarët e Sofjes e kështu më tej, në nëntor 1908 ai nuk ishte më në Manastir, por në Shkodër. Megjithatë, ai e ndiqte nga afër se çfarë ndodhte atje në Manastir dhe e njihte në themel gjendjen e përçarjes në Shkodër lidhur me alfabetet. Ka një parastresë konfidenciale të hollësishme prej tij për gjithë këtë problematikë, të dërguar Vjenës më 9 nëntor 1908, domethënë vetëm pesë ditë para hapjes së Kongresit. Ka kapur thelbin e çështjes së alfabetit të shqipes, gjendjen në përdorimin e alfabeve të ndryshme dhe ka nxjerrë në dukje përpjekjet e veta për ta kapërcyer përçarjen e pakënaqshme. Relacioni i tij është i gjatë dhe jashtëzakonisht serioz, prandaj do ta botoj së shpejti. Po citoj këtu vetëm një fragment nga ky, që do ta quaja paraport:

Shqiptarët atdhetarë të vilajetit të Manastirit, që ndërkaq ishin bashkuar në një klub të njohur zyrtarisht, e morën në duar problemin dhe caktuan *datën 14 të këtij muaji për thirrjen e një kuvendi në Manastir të njerëzve të besuar prej qarqeve shqiptare më të rëndësishme në vend dhe jashtë tij, për të vendosur një alfabet të vlefshëm për mbarë Shqipërinë.*

Shpejtësia dhe energjia me të cilat javët e para të lirisë së re u shfrytëzuan për të filluar nga puna lidhur me çështjen e alfabetit dëshmojnë sesa shumë është thelluar vetëdija e domosdoshmërisë për zgjidhjen e saj dhe sesa rëndësi të madhe kishin mësuar t’ia jepnin asaj për mbarë zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes për bashkimin dhe për gjuhën.

Ideja e kongresit pati jehonë të madhe dhe, sido që do të përfundojë, përsa i përket vetëm Shkodrës dërgimi i delegatëve nga të

gjitha palët e këtushme në kuvendin e pajtimit duhet kuptuar si një sukses i madh.

Si përfaqësues të “Bashkimit” janë nisur për Manastir atë Gjergj Fishta dhe Luigj Gurakuqi; për “Agimin” Dom Ndre Mjeda dhe Mati Logoreci. Por sesa shumë kishin nisur të interesoheshin deri shtresat e gjera të popullit për këtë problem, del nga fakti që Komiteti katolik komunal i këtushëm ka vendosur të autorizojë Luigj Gurakuqin dhe Mati Logorecin njëkohësisht edhe si të deleguar të popullsisë katolike të këtij qarku dhe t’u sigurojë nga ana e bashkësisë shpenzimet e udhëtimit.

Kongresi i alfabetit duket se i plotëson kushtet më të rëndësishme për suksesin e tij.

Duket qartë se A. Krali i ndiqte ngjarjet shumë mirë i informuar për problematikën e ndërlikuar të kësaj fushe dhe prandaj priste me vëmendje rezultatet e ditëve të kuvendit. Po këtu më intereson të cek, se po për atë ngjarje, për të cilën e kishte qortuar Hoxhsoni, përkundrazi, Krali e kishte ndihmuar Gjergjin për ta shpëtuar nga arrestimi më 1902, duke i paguar ryshfet dragomanit zyrtar të Manastirit dhe e mbështeti më pas për botimin e “Krestomacisë”. Në këtë mes do të shtoja, se konsullata austriake në Manastir në atë periudhë përfaqësonte edhe interesat britanikë, prandaj nuk kishte ndonjë pakënaqësi kur më 1905 Gjergjin e caktuan dragoman nderi të saj. Kështu shpjegohet se si Gjergji pa asnjë mëdyshje e dërgoi të njëjtin material në dy drejtime.

Ndërkohë në Manastir ishte përfaqësues austriak Postlin Posfai. Sigurisht, që ai e kishte marrë Programin e Kongresit dhe jam i bindur, se disa të dhëna i ka marrë nga Gjergji, por edhe nga burime të tjera. Të nesërmen pas mbylljes, domethënë më 23 nëntor, Posfai i ka dërguar Vjenës raportin e vet, që e quan një përmbledhje të shkurtër të punimeve. Natyrisht, Posfai do të përzgjidhte të dhënat, që ai i quante më afër interesimeve austro-hungareze. Kështu, ai u lë mjaft vend telegrameve të lexuara: “u lexua një te—

legram përshëndetës nga Bib Doda prej Shkodre, që përmbante njëkohësisht edhe lutjen që si alfabet kombëtar të zgjidhej alfabeti i “Bashkimit”, i cili ishte më praktik në tregti dhe në marrëdhëniet me vendet e jashtme”. Ka shtuar edhe se nga Athina ishte shfaqur dëshira për alfabetin grek; prej palës italiane të shkodranëve me telegramin e Francesco Senigos u shpreh dëshira për alfabetin latin dhe nga disa qytete të Italisë së Jugut u paraqit lutja që të mos hiqej dorë nga alfabeti i Frashërit. Këto përmbajtje nuk i ka dhënë as Gjergj Qiriazit, as gazeta “Lirija”.

Për ditën e dytë Posfai vë në dukje se “u mbajtën shumë fjalime patriotike, në të cilat u theksua kryesisht bashkimi ndërmjet gegëve dhe toskëve, si interesi më jetësor i kombit shqiptar.” Burimet shqiptare gjithnjë flasin se vendimi caktoi alfabetin e shqipes, ndërsa Posfai me të drejtë flet se u miratua për dy alfabete, e përmend të parin atë latin, i cili në Vendimin e Kongresit renditet i dyti, ndërsa tjetrin e cilëson “të ashtuquajturin alfabetin e Stambollit” dhe e pohon qartë, se do të ishte “gjatë një periudhe kalimtare” e se mund të quhej një zgjidhje, e cila kënaqte pjesën më të madhe të shqiptarëve. Për më tepër, Posfai pas asnjë vonesë vendimin ia kishte përcjellë telegrafisht Vjenës sapo ishte shpallur më datë 21, kurse tashti pas dy ditësh ka dërguar edhe një kopje origjinale të Vendimit, bashkë me përkthimin. Ka paraqitur emrat e delegatëve në Shtojcën 1, e cila përputhet me listën e Gj. Qiriazit vetëm me një mungesë. Ky raportim është botuar më 1972 (f. 253–255), por duke e quajtur se nënshkrimi nuk lexohej, si dhe i ishte hequr Shtojca me emrat e delegatëve. Nga ana ime e kam përcaktuar se ishte dërguar prej Posfait.

Po ashtu kam përcaktuar si të Posfait relacionin e datës 30 nëntor (botuar po aty, f. 356–356, përsëri me nënshkrimi të palexueshëm), në të cilin me interes është njoftimi, se u përgatit një program prej 18 pikash, të cilin do ta parashtronte në parlamentin e Stambollit Shahin Kolonja, sepse ai ishte zgjedhur deputet atje pikërisht në ditët e Kongresit. Për Posfain ato kërkesa ishin të një natyre

kombëtare shumë radikale dhe me synim të qartë për autonominë e vendit. Sipas tij, secili prej delegatëve mori një kopje të Vendimit me nënshkrimet e të gjithëve, ndërsa ai vetë ka dërguar në Vjenë një nga ato dokumente origjinale.

Besoj se është e qartë se si Gjergji e dërgoi Raportin në dy drejtime, por njëkohësisht kuptojmë ecurinë e mëtejshme.

I vetmi raportim i botuar në atë periudhë është ai në gazetën “Liri—ja” të datës 8/21 nëntor 1908 si pjesë e artikullit *Kongres’ i Manastirit*. Hapet me ftesën dërguar që në fillim të shtatorit gjithë klubeve dhe shoqërive shqiptare. Vijon një trajtim i shumësisë së alfabeve, trajtim që sigurisht është nga dora e Mit—hat Frashërit, sepse e quan alfabetin e Stambollit më të përhapurin dhe shton se është ai “me të cilën po shtypim këtë fletë”. Më pas vjen Programi i Kongresit. Nga krahasimi që kam bërë me pjesën kryesore, ku jepet zhvillimi i Kongresit ditë pas dite, më del se nuk është zbatuar ky Program. Nuk është e mundur brenda një kumtese të bëhet analiza shteruese e gjithë çështjeve që dalin prej një krahasimi të tillë, por diçka do ta vë në dukje. Ishin parashikuar dy ligjërata: “Nevojat që kemi për të qytetëruar Shqipërinë me anën e diturisë” dhe “Nevoja për të përhapur njeshhtëritë ndë Shqipëri”. Që të dyja këto fjalë aty nuk del që të jenë lexuar, por është e sigurt, se ato ishin përgatitur nga Gjergj Qiriazi. Është e sigurt, sepse e para nga ato fjalë është lexuar dhe të dyja ato fjalë janë botuar më pas si artikuj nga Gjergji. Prej këndej dalin këto përfundime.

Programin në dorë të parë e kishte hartuar Gjergj Qiriazi dhe prandaj kishte vënë që në fillim si të dytën ligjëratën e vet. Ligjërata e parë ishte caktuar dhe u mbajt nga Abdyl Ypi ditën e shtatë. Ligjërata e tretë përsëri e Gjergjit ishte planifikuar për ditën e shtatë dhe nuk u lexua, ndërsa u lexua ligjërata e Nikoll Kaçorrit, që ishte planifikuar. Por ka edhe një variant të Programit, që i është dërguar Vjenës, në të cilin dalin me emër ligjëruesit. Rrjedhimisht, ka pasur një variant të dytë të programit, por nuk është i pranishëm në gazetën “Lirija”. Atëherë Mit—hat Frashëri nuk e ka pasur këtë va—

riant të dytë dhe ka botuar variantin e parë, siç e kishte paraqitur Gjergji.

Gjithashtu është me shumë interes krahasimi ndërmjet zhvillimit të punimeve siç e ka paraqitur Gjergji në Raportin e tij dhe si është paraqitur në reportazhin e gazetës “Lirija”, po edhe ky krahasim nuk ka vend të jepet këtu. Gjithsesi, do ta formuloj përfundimin, te i cili kam mbërritur. Në Kongres ishte edhe e motra e Gjergjit, Parashqevia, e cila erdhi në vend të Sevastisë, që ishte në ato muaj shumë e zënë me shkollën, por Parashqevia nuk ishte delegate. Gjithë kohën ajo ka ndenjur pranë Gjergjit dhe ka mbajtur shënime, madje edhe për punimet e Komisionit. Prej këtyre shënimeve Gjergji ka përpiluar një reportazh për gazetën, të cilin ia ka dhënë Mithat Frashërit, ndërsa ky e ka përpunuar me shpejtësi për ta botuar në gazetë. Kështu shpjegohet se si është arritur të botohet në gazetë menjëherë me mbylljen e Kongresit, prandaj botuesi në gazetë nuk e ka vënë re se ka mospërputhje të mëdha ndërmjet Programit dhe zhvillimit real të punimeve.

Më vonë Gjergji e ka ripunuar materialin shqip dhe mbi bazën e tij ka bërë bashkë me Parashqevinë përkthimin anglisht, ndërsa ajo e ka shkruar anglisht me dorën e saj dhe do të jetë mimeografuar.

Autorët e ndryshëm i kanë ndriçuar mirë aspektet e Kongresit të Manastirit, sidomos vendin dhe rolin e tij në historinë e lëvizjes kombëtare dhe në ecurinë e kulturës e në veçanti të gjuhës shqipe, qëndrimet e ndryshme ndaj sistemeve të alfabeve e deri te shkronjat e veçanta derisa u arrit të zgjidhja që i qëndroi kohës, mirëpo vërehet që kanë lënë jashtë vëmendjes anën konkrete dhe praktike të interesave të pjesëmarrësve, ose me fjalë të tjera, leverdinë materiale vetjake të zgjidhjes që do të miratohej, interesat e palëve që përfaqësonin, si edhe përmbushjen e ambicieve vetjake, që janë të natyrshme kur dikush është i vetëdijshëm se merr pjesë në një akt, i cili do të shënohet në histori. Kjo është një temë, që kërkon shumë vend për ta trajtuar, por po përmend këtu vetëm dy emra. Mithat Frashëri kishte ardhur për ta shndërruar alfabetin e

Stambollit në alfabet mbarëkombëtar dhe kokëfortësia e tij për ta arritur këtë është arsyeja e zgjidhjes me kompromis. Jo rastësisht ai ka shkruar menjëherë më pas një artikull, që për mua tingëllon kuptimplotë në vetvete: *Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?* Do ta quaja një pasraport interpretues sipas qëndrimit të autorit, sepse ai këmbëngul sërish që: “Kongresi me shumë arësye mori përpara syvet abecen’ e Stambollit dhe kupëtoi gjithë rëndësinë që ka marrë në Shqipëri, meqënëse është më e përhapura dhe më e përdorura”.

Nga ana e kundërt, Faik Konica me të gjitha rropatjet kishte bërë çmos që ta zhvleftësonte alfabetin e Stambollit. Ai me arrogancë nuk mori pjesë në Kongres dhe nxori një varg argumentesh të rreme, madje duke kaluar në fyerje pasi ishte shpallur vendimi, sepse e quante veten se ishte ai arbitri, që do të caktonte kur e si mund të bëhej përpjekja për një alfabet dhe madje do të caktonte edhe delegatët, të cilët po ashtu do të sanksiononin alfabetin e përdorur prej tij. Nga artikulli i tij te “Albania” me titullin *Kongresi i shqipëtarëve Xhon-turq në Maqedhonië* nuk do të citoj asnjë nga sharjet, por do ta quaj antiraporti për Kongresin e Manastirit.

Kanë mbetur si dorëshkrime pa u botuar edhe disa paraqitje të tjera të përmbledhura. Një prej tyre në Arkivin e Shtetit mban datën *Manastir, 7-20/XI 08*, domethënë është i ditës së parafundit. Me interes aty është, se përmenden me emra folësit, të cilët nuk jepen te gazeta “Lirija”. Megjithatë, ka ndonjë pasaktësi, sepse përmend me të njëjtin titull fjalën e N. Kaçorrit me fjalën e Gj. Qiriazit. Me interes të veçantë është trajtimi i temës, a duhet luftuar tashti me pendë e kartë, siç e kishte ftesa për Kongresin, apo do të mbetej nevoja edhe për të luftuar me armë në dorë e për të derdhur gjakun për tërësinë e vendit.

Një dorëshkrim tjetër i shkurtër po ashtu në Arkivin Qendror në Tiranë i vitit 1908, me sa duket është shkruar nga një përkrahës i Ndre Mjedës, sepse alfabetin e tij e quan që ndiqte paraqitjen shkencore ndërkombëtare të kohës. Vë në dukje, se Gjergj Fishta u dëshpërua, që mbledhjet e Komisionit nuk po arrinin në një

marrëveshje dhe shkoi deri atje, sa të shprehej, që ajo punë të lihej për një kohë tjetër. Ndre Mjeda përkundrazi, meqë, po citoj: “nuk i dukei nder për Komisionin m’u thanë se kishin ba gjith’ ato shpenzime, e marrë gjith’ atë mund për me i dhanë vedit në Manastir një patentë pazotsije, e se ai kujtote qi, po të kishim vullëndet të mirë, puna mund të kryhei ma shpejt”, paska përpunuar gjithë natën dy alfabetet që iu paraqitën Komisionit dhe të nesërmen: “Si shkroi atë alfabet edhe shpjegimet e dishrueme, gadi gjithë Komisioni e pranoi, tuj percjellë votat e vet me duertrokitje.” Mbledhjet e Komisionit dihet se kanë qenë të fshehta dhe nuk kam ndonjë mënyrë se si t’i verifikoj këto pohime, të cilat kështu zgjidhjen e kompromisit të Kongresit e quajnë se e paska dhënë Ndre Mjeda. Ashtu qoftë, sepse në Kongres i vetni që kishte përgatitje të mirëfilltë në gjuhësi ishte Ndre Mjeda.

Së fundi do të them dy fjalë edhe për një letër që Violeta Kenedi ka shkruar më 3 dhjetor 1908, dhjetë ditë pas mbylljes së Kongresit. Të dhënat i ka marrë nga Sevastia dhe përshkruan vizitën e një grupi të delegatëve të Kongresit në Korçë. E ka quajtur “një konferencë të mrekullueshme”. Me vlerë të veçantë është se letërshkruesja shprehet: “u vendos që të mbahej përkohësisht ai që njihet si Alfabeti i Stambollit, i cili ka qenë i përhapur në Shqipërinë e Jugut, por të miratohej si alfabet kombëtar ai latin, ai prej Veriut.” Kjo pikë ka rëndësi, sepse siç shihet, edhe një vëzhguese e huaj e ka rrokur drejt, që Kongresi mori një vendim kompromisi për një periudhë kalimtare, ndërsa si **alfabet kombëtar** do të mbetej alfabeti i ri dhe ai mbeti. Ky ka qenë kuptimi i vërtetë i vendimit të tij dhe këtë prisnin shqiptarët.

Ndërkaq, edhe delegatët e tjerë sigurisht që nxiteshin nga frymëzimi kombëtar, por edhe për ata nuk ishin të huaja shtysat praktike e vetjake. Ishin autorë, që kishin krijuar emrin e tyre duke përdorur një alfabet dhe tashti do të duhej ta ndryshonin. Ishin botues gazetash e revistash, të cilat gjithashtu do të kalonin në një alfabet tjetër, për disa duke nisur qysh nga titulli i tyre. Ishin hartues dhe botues

tekstesh shkollore, të cilat do të shkruheshin ndryshe dhe do të kërkonin edhe prej mësuesve ndryshimet përkatëse në punën me nxënësit nëpër shkolla. Ishin pronarë shtypshkronjash, që do t'u kërkohej të shpenzonin për plotësimin e linotipave me matrica të reja. Prapa të gjitha këtyre ishte një ndryshim shprehish, një dorëheqje nga e vetja për hir të një qëllimi madhor kombëtar, po vinte prapa edhe një faturë financiare. Për të gjitha këto ishte i vetëdijshëm Gjergj Qiriazi, kur e hartoi raportin dhe do të thosha, që jo vetëm kemi realisht një raport të plotë nga ana e tij, por edhe ai ishte i vetmi që mund ta shkruante atë me vërtetësinë më të mundshme, me asnjësinë më të mundshme, natyrisht pa përjashtuar interesin vetjak nga disa anë.

NEBI DER VISHI

Universiteti i Tetovës

PERSONALITETI I AHMET NJAZIUT TË RESNJËS (1865 – 1913)

Revolucioni i korrikut të vitit 1908 në Perandorinë Osmane, i njohur me emrin revolucion i xhonturk, zë një vend të rëndësishëm në historiografi, veçanërisht në historiografinë ballkanike, e në radhë të parë, në atë turke.

Shpërthimin e Revolucionit të Korrikut e favorizuan dy ngjarje ndërkombëtare:

a. Deklarata e ministrit të Punëve të Jashtme të Austrohungarisë, Erentall, e janarit të vitit 1908 për fillimin e ndërtimit të hekurudhës së Mitrovicës, që do të hapte rrugën depërtimit austriak drejt vilajeteve shqiptare të Kosovës e të Manastirit dhe drejt Vilajetit të Selanikut, dhe

b. Marrëveshja ruso–angleze e Revalit (Rusi) e 8 qershorit 1908, për zbatimin e reformave të reja në Maqedoni, që do të çonin në forcimin e kontrollit të këtyre fuqive në Turqinë evropiane. Këto ngjarje e acaruan gjendjen politike në Shqipëri dhe në Maqedoni, ku prej kohësh zhvillohej lufta e armatosur e çetave kundër sundimit osman dhe i shtynë turqit e rinj (xhonturqit) të organizonin kryengritjen për ta shpëtuar Perandorinë Osmane nga ndërhyrja e Fuqive të Mëdha. Premtimet që u bënë në vitin 1908, Shqiptarëve dhe popujve të tjerë për t’u dhënë bashkë me Kushtetutën, “Lirinë, barazinë, vëllazërimin dhe drejtësinë”, u siguruan xhonturqve përkrahjen e këtyre popujve, e në mënyrë të veçantë, të shqiptarëve.

Siç është tanimë e njohur, Revolucion i filloi më 3 korrik 1908, kur ngriti krye reparti ushtarak i Resnjës, i komanduar nga oficeri

shqiptar Ahmet Njaziu. Kjo kryengritje u pasua nga ajo e majorit turk Enver Beut që shpërtheu më 6 korrik në Demir Hisar të Maqedonisë. Kryengritja u shtri në qytetet kryesore të Shqipërisë e të Maqedonisë, që u bënë vatra të Revolucionit. Qeveria e Stambollit, dërgoi kundër kryengritësve gjeneralin turk Shemsi Pasha, i cili me vendim të komitetit xhonturk, u vra sapo mbërriti në Manastir, më 7 korrik 1908.

Përputhja e kërkesave, që xhonturqit shpallën në ditët e para të kryengritjes së korrikut me ato të lëvizjes shqiptare, e çoi në bashkëpunimin midis komiteteve “Për Lirinë e Shqipërisë” dhe atyre xhonturke. Me kryengritjen u bashkuan gjithashtu çetat e armatosura shqiptare, të cilat iu përgjigjen thirrjes për bashkëpunim, që Ahmet Njaziu, qysh më 5 korrik, u kishte dërguar atyre. Si komitetet, ashtu edhe çetat shqiptare, gjatë takimeve me xhonturqit (më 20 korrik në Çërravë të Pogradecit), u paraqitën atyre kërkesën e autonomisë së Shqipërisë, që përfaqësuesit e Xhonturqve prem-tuan se do ta plotësonin.

Në fillim të korrikut 1908 filloi në Maqedoni revolucioni i turqve të rinj i cili, në sajë të mbështetjes që gjeti në popujt e shtypur, e veçanërisht në popullin shqiptar, përparoi shumë shpejt. Po në ditët e para të korrikut 1908, rreth 20 mijë fshatarë shqiptarë të armatosur nga rrethet e Prizrenit, të Gjakovës të Prishtinës, etj., u grumbulluan në Ferizaj për mos lejuar ndërhyrjen e huaj dhe për të ruajtur tërësinë tokësore të vendit. Më 20 e 22 korrik 1908 nga mbledhja e Ferizajt, e kryesuar nga Bajram Curri e Isa Boletini, iu dërguan dy telegrame sulltanit, me anë të të cilit, në emër të popullsisë së Kosovës, kërkohesh nga sulltan Abdyl Hamiti që të rivedoste menjëherë Kushtetutën e vitit 1876 dhe të mblidhej Parlamenti. Kuvendi i kumtoi sulltanit se, në rast se kërkesat e tij nuk pranoheshin, populli me armë në dorë do të zbriste drejt Stambollit. Më 23 korrik, pa ardhur ende përgjigjja nga Stambolli, populli shpalli Kushtetutën në Manastir, Selanik, Preshevë, Koprily dhe në qendrat e tjera.

Bashkimi i ushtrisë, po në ato ditë, me xhonturqit dhe sidomos i Armatës së Dytë të Maqedonisë, shumica e ushtarëve dhe e oficerëve të së cilës ishin shqiptarë, ka qenë faktori tjetër vendimtar (pas Kuvendit të Ferizajt) që përcaktoi fitoren e revolucionit të korrikut të vitit 1908. Më 23 korrik repartet kryengritëse, të përshëndetura nga popullsia hynë në Selanik, Manastir dhe në qytete të tjera, ku “në emër të ushtrisë dhe të popullit shpallën rивен- dosjen e Kushtetutës.

Absolutizmi i sulltan Abdyl Hamitit, që vazhdoi 33 vjet (1876–1908), popujve të perandorisë, sidomos shqiptarëve e turqve liri-dashës ua kishin prurë në majë të hundës. Çdo komunitet etnik kërkonte liri dhe demokraci.

Rumelia me Shqipërinë e Maqedoninë në krye ishte bërë Qabeja e Hyrjetit (Lirisë). Shqiptarët e turqit, të zhgënjyer nga kushtetuta parlamentare e vitit 1876, kishin marrë malet. Një nga kryepersonazhet dhe kryetrimat e revolucionit xhonturk të verës së vitit 1908 ishte edhe Ahmet Njazi Beu (Resnjeli Nijazio ose Niazi Resnja), i cili kishte lindur në një vend, ku shqiptarët e turqit jetonin si të afërm me krushqi.

Pra, një nga protagonistët e Revolucionit xhonturk të vitit 1908, ishte edhe Ahmet Nijaziu Beu nga Resnja, për figurën e të cilit kanë shkruar shumë studiues shqiptarë e të huaj, si: Shukri Rrahimi, Kristaq Prifti, Reshat Nexhipi, Ali Vishko, Gazmend Shpuza, Zeqirija Cana, Masar Kodra, Muzafer Bislimi, Ramiz Abdyli, Eugen Shehu, Nexhip P. Alban – Nesip Koçi, etj.

Ahmet Njazi Resnja lindi në Resnjë më 1865 (Nexhip P. Alban shënon vitin e lindjes më 1873). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin ushtarak në Manastir. I ati i Ahmetit, Njazi Beu ishte Beu i Resnjës, kërkon kurdoherë që i biri të mëson në shkollë. Pra, familja ishte në gjendje të mirë ekonomike, pas Njazi Beu zotëronte prona të mëdha gjer në Strugë. Kjo ia mundësoi Ahmetit të niset në studime në Stamboll, ku në vitet 1886 – 1889

ndjek akademinë e lartë ushtarake, të cilën me sukses e kreu në vitin 1896 duke marrë gradën ushtarake të togerit.

Në vitin 1897 mori pjesë në luftën turko– greke, ku arriti suksese të jashtëzakonshme, duke zënë rob shumë grekë të cilët i dërgon në Stamboll.

Pasi u gradua, emërohet oficer tabori (batalioni) në Ohër, ku shërben deri në vitin 1908, duke luftuar kundër rebelëve serbo– bullgar që i shqetësonin shqiptarët dhe turqit në Rumeli.

Ahmet Njazi Beu ishte kundërshtar i madh i absolutizmit të sulltanit, i cili po e shpinte Perandorinë Osmane drejtë katastrofës, sepse regjimi që mbretëronte në vend nuk përputhej me rrethanat e kohës. Për këto arsye Ahmet Njazi Beu filloi të mbështetet në përkrahjen e të gjithë atyre forcave progresive të cilat ishin po ashtu kundër absolutizmit të sulltanit, në radhë të parë në forcat shqiptare që ishin njaftë të shprehura në atë kohë, posaçërisht në rajonet e Ohrit, e të Manastirit. Kështu, në mes të tjerave, Ahmet Njazi Beu përkrahu vendimet e Komitetit shqiptar të Manastirit për formimin e çetave të armatosura të cilat do të luftonin kundër pushtetit anti– popullor të sulltanit. Meqenëse armiku ishte i përbashkët, kuptohet që edhe lidhjet e çetave dhe Ahmet Njaziu ishin të natyrshme, megjithëse idealet e tyre përfundimtare ishin të kundërta, sepse të parët (çetat shqiptare) përpiqeshin për çlirimin kombëtar e social të shqiptarëve, që do të thotë shkëputje nga Perandoria Osmane kurse qëllimi i Ahmet Njazi Beut ishte që të përforcohej kjo Perandori, por me popuj të cilët do të ishin të barabartë, gjë e cila rezultoi që në anën e tij të marrin pjesë njaftë shqiptar nga tërë Vilajeti i Manastirit. Ai kishte përkrahjen edhe të një pjese të mirë të popullsisë Sllavo – bullgare, etj., prandaj edhe arriti suksese në vitin 1908.

Ndikimi i fjalës së Ahmet Njazi Beut – Resnjës, ishte tepër i madh në krejt banorët e Vilajetit të Manastirit. Për më tej, ky ndikim u shtri edhe në repartet e ushtrisë turke të këtij Vilajeti, të cilët kryesisht përbëheshin prej shqiptarëve.

Major Ahmet Njazi Beu më 3 korrik 1908, me 200 ushtarë vullnetarë doli në mal dhe më 19 korrik u bashkua e udhëheqësin e çetave shqiptare, Çerçiz Topullin, i cili kishte dy vjet që jetonte në male për të mbrojtur atdheun.

Turqit e rinj siguruan suksese në repartet ushtarake, sidomos midis oficerëve dhe ushtarëve shqiptarë. Në njërin prej këtyre reparteve, me qendër në Resnjë, që komandohej nga oficeri shqiptar Ahmet Njazi, filloi edhe kryengritja në 3 korrik 1908, ngjarje kjo që shënon fillimin e revolucionit. Premtimet e Ahmet Njaziut dhe të turqve të rinj për të siguruar gjithë popujve të perandorisë pa dallim feje, lirinë, barazinë, vëllazërinë dhe drejtësinë, premtimet që iu bënë fshatarëve shqiptarë për heqjen e taksave dhe mënjanimin e arbitrariteteve të nëpunësve “u siguruan atyre përkrahjen e fshatarësisë shqiptare të rretheve të Resnjës, Ohrit, Strugës, Starovës, Dibrës, Elbasanit, Korçës, etj.

Paralelisht me zhvillimet në Kuvendin e Ferizajt edhe Ahmet Njazi Beu po shënonte suksese të reja. Armata e III e stacionuar në qytetin e Manastirit po shpërbëhej nga dezertimet dhe trazirat që kishin shpërthyer. Kulmi i trazirave në ushtri arriti në momentin kur u vra mareshali Shemshi Pasha (komandant i Divizionit të Mitrovicës) i cili po përgatitej në qytetin e Manastirit për të organizuar ekspektën ndëshkimore ndaj Ahmet Njazi Beut dhe njësisë të tjera të rebeluara. Pas këtij atentati, Armata e III nuk i bindeshin më urdhrave që vinin nga qendra për të luftuar kundër rebelëve. E njëjta situatë mbizotëronte edhe në njësit e tjera ushtarake në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane.

Në ndërkohë, më 20 korrik 1908, Kuvendi i Ferizajt nxori Ittifak-namen (rregulloren e betimit), e cila përmbante 8 pika që në thelb kërkohej rivendosja e kushtetutës së vitit 1876. Të njëjtat kërkesa iu dërguan sultan Abdyl Hamidit II me telegramin e nënshkruar nga 1200 personaliteteve të Vilajetit të Kosovës. Dy ditë më vonë, i njëjti telegram iu dërgua sërish sultanit, duke iu kërcënuar se nëse

nuk do merrnin përgjigje për 24 orë, 50 mijë kryengritës do t'ia mësynin Stambollit.

Kërcënimet e forcave vullnetare shqiptare të Kuvendit të Ferizajt, veprimet luftarake të dezertorëve që iu bashkëngjitën njësitit të Ahmet Njazi Beut dhe vlini i pakënaqësive popullore në mbarë Perandorinë Osmane, bënë që më 23 korrik 1908 sulltan Abdyl Hamidi II dhe dekretin (iradenë) për rivendosjen e Kushtetutës së vitit 1876.

Shpallja e Kushtetutës (Hyrijetit) u prit me një entuziazëm të madh nga shqiptarët që jetonin në trojet e tyre shekullore. Myslimanë e të krishterë në mënyrë vëllazërore kërcenin dhe dëfreheshin deri në orët e vona të natës, duke festuar kështu ngadhënjimin e revolucionit dhe fitimin e më shumë të drejtave.

Në manifestimin e organizuar me këtë rast në Manastir, morën pjesë përfaqësues të kombësive të ndryshme, nëpunës, oficerë e ushtarë. Konsulli austro – hungarez e përshkruan atmosferën e pritjes së oficerëve të ardhur nga provincat e ndryshme, e cila ishte “impozante”. Hyrjen e Njazi Beut, konsulli e përshkruan si “një procesion triumfal”. Përkrah Ahmet Nijazi beut, heroit dhe protagonistit kryesor të kësaj ngjarjeje historike, në krye të kolonës së parakaluesve qëndronin Çerçiz Topulli e Adem Beu dhe shumë luftëtarë të tjerë shqiptar.

Pra, kontributi i Ahmet Njazi Beut qëndron në faktin, që si rrjedhim i shpalljes së Hyrjetit, erdhi edhe tek formimi i Klubit “Bashkimi”, i cili mori nismën për thirrjen e Kongresit të Manastirit ku do të bëhet unifikimi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Pas ngadhënjimit të Revolucionit xhonturk (23 korrik 1908), vitet e fundit të Ahmet Njaziut ishin si vijojnë:

Nën – majori Ahmet Njazi Resnja kur u pushtua parlamenti Osman prej reaksionarëve që kishin lidhje me kalbësiat osmane më 4 prill 1909, mori pjesë edhe në ushtrinë e aksionit kombëtar që u nis

nga Maqedonia dhe shtypi fanatikë fetar në Stamboll. (Nexhip P. Alban, Shqiptarët në Perandorinë Osmane).

Ahmet Njazi beu nuk pranoi poste zyrtare nga Qeveria oportuniste e Partisë Ittihat – Terakki dhe doli në pension, duke u vendosur në Resnjë, ku kishte lindur.

Mirëpo, me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike 8 tetor 1912, Ahmet Njazi beu, mbledhi vullnetarët e vet dhe mori pjesë në mbrojtjen e Rumelisë. Mjerisht Lufta e parë Ballkanike përfundoi me disfatë për ushtrinë Osmane. Oficerët e ushtrisë osmane u detyruan të ktheheshin në Turqi nëpërmjet Shqipërisë, që kishte shpallur Pavarësinë më 28 Nëntor 1912. Në këto ditë Ahmet Njaziun e kishte zënë një tifo e mallkuar. Pasi u kurua nga mjeku, së bashku me dy vëllezërit e tij, Nazimin e Osmanin, nga Manastiri u nisën për në Durrës, ku shpresonte t’ia hipte një vapor osman ose evropian.

Pasi arriti në Durrës, për disa ditë qëndroi te shoku dhe bashkëpunëtori Beqir Fiqri Grebeneja. Për të hipur në një anije italiane u desh të shkonte në Vlorë. I shoqëruar nga mjaftë miq e shokë ushtarak, mori rrugën e Vlorës. Kur ishte gati për të hipur në vaporin italian, më 17 prill 1913, u vra nga një dorë e pabesë, me dy plumba pas shpine. Këto plumba nuk besohet të kenë qenë të dorës së shqiptarit. S’ka dyshim se birin e Resnjës do ta ketë goditur ndonjë rival personal, që kishte frikë se mos bëhej lider i Turqisë së Re.

SABILE KEÇMEZI – BASHA

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

QIRIAZËT – FAMILJE PATRIOTIKE DHE ATDHETARE

Janë raste të rralla në historinë e popullit shqiptar, veçmas në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, kur anëtarët e një familjeje kanë hyrë si veprimtarë aktiv të lëvizjes kombëtare shqiptare, të cilat tërë potencialin moral e material, shpirtëror e intelektual ia kushtuan çështjes kombëtare sikurse në planin çlirimtar, po ashtu edhe në atë kulturor–arsimor, si familja Qiriazit e Manastirit, e cila i fali kombit pesë intelektualë: Gjerasimin, Gjergjin, Kriston, Sevas–tinë dhe Parashqevinë⁷⁸. Këta ishin bijtë dhe bijat e Dhimitër dhe Maria Qiriazit nga Manastiri.

Familja Qiriazit e ka prejardhjen nga fshati Peras, rrethi i Kolonjës, të cilët aty ishin shpërngulur nga Durrësi, në fillim të shek. XIX. Nuk është e njohur se kur u shpërngul kjo familje në fshatin Tërnovë, që shtrihet 8 km. në veriperëndim të Manastirit, e prej këtu kishin zbritur në qytet, i cili në atë kohë ishte qendër e Vilajetit të Manastirit. Babai Dhimitër Qiriazit, anëtar i kolonisë shqiptare të qytetit, me profesion zdrukthëtar dhe nëna Maria kishin dhjetë fëmijë, shtatë djem dhe tri vajza: Tashkon, Konstandini, Gjerasimi, Gjergji, Naumi, Kristo, Pandeli, Fanka, Sevastia dhe Parashqevia⁷⁹. Kjo familje, sado që jetonin në një qytet me popullsi të përzier nga pikëpamja e kombësisë, arriti që t'i ruante

⁷⁸ Nebi Dervishi, *Kontributi i familjes Qiriazit në ngritjen e vetëdijes kombëtare*, <http://www.nacionalalbania.al/2011/10/kontributi-i-familjes-qiriazit-ne-ngritjen-e-veteditjes-kombetare>, 17 nëntor 2018

⁷⁹ Sabile Keçmezi-Basha, *Qiriazet –familje patriotike dhe atdhetare*, Shkëndija, mars 1995

traditat shqiptare dhe t'i edukonte të gjithë fëmijët në frymën e dashurisë për atdheun dhe për gjuhën amtare⁸⁰.

Shtëpia e Qiriazëve, e ndodhur në qendër të një vilajeti të madh, si dhe në rrugën që lidhte Shqipërinë me Stambollin dhe vendet e tjera, u bë vatër e rëndësishme kombëtare që priste e përcillte patriot të shquar shqiptarë të Rilindjes, si: K. Kristoforidhin, K. Hoxhin, P. Sotirin, P. N. Luarasin, Orhan Pojanin, N. Naçin e shumë të tjerë⁸¹. Këtu pritshin e përcillnin të gjithë patriotët që shkonin e vinin nga kolonit, për të sjellë në Shqipëri arsimin e diturinë, për të ngjallur në popull ndjenjën kombëtare.

Në shtëpinë e Qiriazëve vinin e grumbulloheshin e shpërndaheshin librat shqip. Në këtë shtëpi e, në këtë familje, u rritën e u edukuan bijtë dhe bijat e nderuara të kombit shqiptarë. Vetë Dhimitër Qiriazin, ishte një atdhetar i madh. Ai, me këmbëngulje, luftonte që në shkollat greke dhe në kishë të futej gjuha shqipe. Për këtë "shkelje" të normave që bënte, Dhimitri (babai i Gjerasimit) u shpall armik i Mitropolisë. Puna arriti deri aty sa ai u nxor nga kisha dhe u mallkua prej saj.

Më 1861, u lind Gjerasimi. Pasi kreu shkollën greke të mesme në Manastirë, ai vazhdoi kolegjin amerikan në Samakovë të Bullgarisë, të cilën e kreu me sukses⁸². Në vitin 1880 Gjerasimi bëri dy udhëtime për në Shqipëri. Që në udhëtimin e parë, si rilindës i shquar, ai pa me sytë e vet gjendjen e mjeruar të Shqipërisë që lëngonte nën thundrën e okupuesit. Kudo shtypje dhe padituri⁸³. Asnjë gjurmë arsimit. Njerëzit, thoshte Gjerasimi "Padituria i bëri të quajnë të mirën të lig, dhe të ligën të mirë".

Si rrjedhim i krejt kësaj, ai vjen në përfundim se shkakut i kësaj gjendjeje ishte mungesa e arsimit në gjuhën shqipe dhe i shkollave

⁸⁰ Wikipedia, *Qiriazet*, 16.11.2018

⁸¹ Sabile Keçmezi-Basha, *Kontributi atdhetar i familjes Qiriazin*, Shkëndija

⁸² Wikipedia, enciklopedi e lirë-*Gjerasim Qiriazin*, 2 tetor 2018

⁸³ *Bujku*, Enciklopedi e vogël, 26.11.1991, Prishtinë.

shqipe kombëtare, ku fëmijët shqiptarë pa dallim feje duhej të mësonin shqip. Për Gjerasimin, shkollat shqipe ishin një nga njetet më themelore për të shpëtuar shqiptarët nga tirania turke dhe armiqte e tjerë. Ndërkohë, Qendra e Shoqërisë Biblike Britanike në Stamboll, e cila gjerë atëherë kishte pasur në shërbim të saj Kons-tandin Kristoforidhin, e ftoi Gjerasimin të bëhej përfaqësues i saj për degën e Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

Krahas detyrës zyrtare, predikimit shqip të Ungjillit, ai me vëllezërit e motrat zhvillonin propagandën kombëtare dhe mbillnin në zemrat e shqiptarëve dashurinë për gjuhën amtare dhe për atdheun e robëruar. Së bashku me librat fetare të përkthyer në gjuhën shqipe nga Kristoforidhi, shpërndanin edhe vepra patriotike ose didaktike të rilindëseve tanë. Vëllezërit e motrat Qiriazi, vetë përkthenin vepra, por edhe shkruanin tekste shkollore, pjesë origjinale e poezi me përmbajtje patriotike që shërbenin për edukimin patriotik të brezit të ri.

Familja Qiriazi, mbanin korrespondencë të vazhdueshme me Nikolla Naçon, De Raden, Thimi Mitkon, vëllezërit Frashëri⁸⁴ etj. Një kujdes të veçantë Gjerasini i kushtoi edukimit dhe arsimimit të së motrës Sevastisë dhe Parashqevisë. Ky kujdes lidhej edhe me ëndrrën e tij, për t'iu kushtuar edhe ato një ditë punës arsimore për ngritjen dhe shkollimin e femrës shqiptare. Ato i kishte mësuar të shkruanin dhe të lexonin mirë në gjuhën shqipe dhe, iu fliste për vlerën e madhe që kishte për një popull zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare.

Në historinë e mendimit politik shqiptarë motrat Qiriazi, pa dyshim zënë një nga vendet e nderit për luftën dhe angazhimin e tyre si në arsim edhe më tepër në diplomaci duke e veçuar qëndrimin e tyre në faktin se tërë jetën ia kushtuan çështjes së atdheut, duke e bërë të njohur përpara opinionit të huaj qëllimin dhe luftën e drejtë që

⁸⁴ Qelodhina Falli, *Flete nga historiku i shkollës sonë, biblioteka nr 2 e gazetës, Mësuesi-* (materiale e dokumente), Tiranë, 1963.

bënte populli shqiptarë për liri, pavarësi e të drejta shoqërore , për arsimin dhe gjuhën e tij kombëtare.

Gjatë hulumtimeve për jetën dhe veprimtarin e motrave Qiriazit, gjithmonë më ka provokuar pjesëmarrja e tyre aktive në jetën arsimore e politike, e sidomos pjesëmarrja e Parashqevi Qiriazit si delegatë në Kongresin e Manastirit më 1908 në të cilën paraprakisht ishte bërë ftesa për Sevasti Qiriazin (çka nënkuptohet se për nga aktiviteti dhe angazhimi i tyre atdhetar ishin një dhe të pandara). Në kongres Parashqevia ishte gruaja e vetme e cila merrte pjesë dhe unanimisht atë e kishin propozua sekretare të komisionit. Më 1909 botoi në Manastir “Abetare për shkollat e para” duke zënë vend në historinë shqiptare si e para grua autore tekstesh në Shqipëri. Ajo e rishtypi tri herë librin e saj e cila kishte 33 faqe dhe ishte e pasur me disa fotografi. Gjuha e tekstit është e pastër dhe i ofrohet gjuhës së sotme letrare.

Është provokuese pjesëmarrja e Parashqevi Qiriazit në Konferencën e paqes në Paris më 1919. Po ashtu më ka bërë përshtypje qëndrimi dhe diplomacia e saj që ka tregua gjatë mbajtjes së konferencës, ku me mençuri luante rolin e katalizatorit dhe bënte çmos për ta ruajtur ekuilibrin midis grupeve të ndryshme dhe u tregua shumë e zonja në këtë drejtim.

Motrat Qiriazit, binomi i pandarë i atdhetarisë dhe i përkushtimit për arsimin shqip të popullit të tyre, u rriten dhe u edukuan në frymën e rilindësve tanë. Motra më e madhe Sevastia ishte e lindur më 24 shkurt të vitit 1871 në Manastir. Më 1888, Sevastia e mbaroi shkollën plotore në Manastir. Po atë vit u dërgua në një shkollë të lartë në Stamboll. Në këtë mënyrë, përgatitet për çeljen e një shkolle shqipe për vasha po hynin në fazën e fundit. “*Kur u nisa për në Stamboll*”– shkruante Sevastia, “*në mendjen time e kisha përcaktuar se çfarë do të bëja pasi të mbaroja studimet. Kur arrita në Kolegjin e Stambollit kërkoja që të të hyja në vitin e dytë, por mu përgjigjën se isha tepër e re dhe shkolla që kisha mbaruar nuk më jepte këtë të drejtë...Unë propozova që t’iu nënshtrohesha provi-*

*meve përkatëse duke iu thënë se vëllai po më priste për të çelur një shkollë për vajza në Shqipëri. Ata, pas një konsultimi të shkurtër pranuan kërkesën time*⁸⁵ përfundon Sevastia.

Më 1888, nisi mësimet në Kolegjin Amerikan të Stambollit dhe e përfundon në qershor 1891. Pas diplomimit, me ndihmën e vëllait Gjerasim Qiriazit, në tetor të vitit 1891 hapën shkollën e parë femërore në Shqipëri. Sevastia gjithashtu mori pjesë në Kongresin e Elbasanit më 1909; ishte anëtare e komisionit për shqyrtimin e teksteve shkollore të ngritura nga shoqëria “Përparimi”. Në vitin 1914, koha e luftës së Parë Botërore, binomi Motrat Qiriazit ven-
dosen në SHBA, ku më 1917, ato botojnë numrin e parë të revistës “Ylli i mëngjesit” në Boston. Po në të njëjtën kohë motrat Qiriazit formojnë “Partin Politike Shqiptare”⁸⁶. Me të cilën arritën që në arenën ndërkombëtare të mbronin të drejtat e Shqipërisë.

Ndërsa Parashqevia ishte e lindur me 2 qershor të vitit 1880. Ajo ishte e diplomuar në dy universitete: në atë të Stambollit dhe, në atë të Oberlin, në SHBA. Ishte njohëse e mirë e shtatë gjuhëve të huaja. Kryetare e shoqërisë së grave “Ylli i mëngjesit”, po ashtu edhe përfaqësuese e “Partisë Politike Shqiptare” në Konferencën e Paqes në Paris. Në kohën kur mori pjesë në Konferencë kishte vetëm 38 vjet, dhe ishte e vetmja diplomate grua, midis shumë diplomatëve të tjerë burra për të mbrojtur të drejtat e kombit shqiptar dhe mund të thuhet se shkëlqeu me aktivitetin dhe sjelljen e saj diplomatike në mes burrave të shumtë⁸⁷. Bile, në një rast nga Parisi i shkruante përfaqësuesi i gazetës “Korespondenti”, Sevasti Qiriazit, duke i dhënë këtë vlerësim për Parashqevien “Le të

⁸⁵ Sabile Keçmezi-Basha, *Karakterit kombëtar i shkollës së parë shqipe të vashave* (100 Vjetori i shkollës shqipe të vashave në Prizren), Prishtinë, 1993, 48

⁸⁶ Sabile Keçmezi-Basha, *Binomi motrat Qiriazit- misioni atdhetar dhe arsimor i tyre*, Tribunë shkencore në Manastir “Kongresi i Manastirit”: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti Albanologjik – Prishtinë, Instituti i Studimeve Shqiptare - Protestante në Tiranë, 21 nëntor 2017

⁸⁷ Wikipedia, enciklopedi e lirë-*Parashqevi Qiriazit*, 1 Tetor 2018

mburremi, jo vetëm ne burrat, por edhe gjithë zonjat shqiptare se zonjusha Parashqevi Qiriaz, Zhan D'Arka e Shqipërisë na nderoi të gjithëve. As një komb i madh ose i vogël nuk ka sot në Paris një delegat zonjë, po Shqipëria ka këtë zonjushë, e cila me diturin dhe mençurinë e saj dita më ditë po fiton simpatinë e të huajve për fitim të Shqipërisë”.

Angazhimi i tyre merr vlera të veçanta sepse, ato punonin në një kohë kur errësira dhe prapambetja shekullore kishin lënë gjurmë të thella dhe hendeku midis veprimtarisë së burrave dhe grave ishte aq i thellë sa e bënte të pamundur pjesëmarrjen e tyre në jetën politiko-shoqërore. Dhe, veç kësaj, ato u ngritën mbi paragjykimet e kohës, mbi konceptet nënvleftësuese, opinionin e sëmur dhe mendimin e mykur që përçmonte dhe nënvleftësonte rolin e gruas dhe iu imponuan këtij mendimi me qartësinë e kërkesave politike të lëvizjes kombëtare.

Po në vjeshtën e vitit 1888, edhe Gjerasini kishte vajtur në Korçë ku filloi të punonte për të përgatitur çeljen e shkollës shqipe për vajza. Në qytet gjeti përkrahjen dhe inkurajimin e popullit. Duke përdorur fjalën shqipe dhe idetë kombëtare, ai filloi të tërhiqte rreth vetes një numër të madh banorësh të Korçës. Por, qysh në fillim ata u ndeshën me dinakërinë e shovinistëve grekë dhe në luftë me ta punonin për të ndriçuar sa më shumë mendjen e bashkatdhetarëve të tyre⁸⁸. Më 1891, në Stamboll diplomoi Sevastia, e ky sukses nuk ishte gëzim vetëm për familjen e Qiriazëve, por këtë rast me padurim e prisnin edhe shumë mërgimtar tanë që ishin jashtë atdheut. Në ceremoninë e rastit, për marrjen e diplomës ndodheshin shumë rilindës të shquar si: Abdyli, Naimi e Sami Frashëri etj. Duke e uruar për diplomën që e mori, Naimi i drejtohej Sevastisë me këto fjalë: *“Motër, ti nuk mund të bësh punë më të mirë dhe më të vlefshme për Shqipërinë e varfër se sa atë që me kohë ke vendosur të kryesh emancipimin e grave të vendit tonë. Detyrë jote fillon tani, dhe nëqoftëse do të jesh besnike dhe këmbëngulse, do të arrish*

⁸⁸ Dhimitër Dishnica, *Motrat Qiriaz, Tiranë, 1997, f.5.*

*të bësh shumë për vendin tënd. Arsini është arma që zhdukë errësirën*⁸⁹” përfundon Naimi.

Me rastin e qëndrimit në Stamboll, Gjerasimi i paraqiti Portës së Lartë kërkesën për të çelur në Korçë një shkollë vajzash dhe leja u dha në formën e një dekreti perandorak–irade. Kështu, pas hapjes së “mësonjëtores” për djem më 1887, më 23 Tetor 1891 themelohej shkolla e pare shqipe për vajza nga Gjerasim Qiriaz, po ashtu në Korçë. Kjo shkollë ishte fitorja më e madhe e patriotizmit shqiptar⁹⁰. Dhe siç ishte programi i rilindësve, u pranuan nxënës pa dalim besimi. Kështu, shkolla, pos rolit për afrim e për të zhdukur ndasitë krahinore, luajti edhe rol me shumë rendësi për të zhdukur përçarjen fetare që ishte bërë plagë e madhe në trupin e kombit.

Shkolla e vajzave ka qenë kryesisht një shkollë fillore 4–5 klasa dhe arriti të kishte shkollën e ultë dhe të mesme. Programi i kësaj shkolle ishte mjaftë i gjerë për kohën dhe përputhej me kërkesat iluministe të patriotëve të rilindjes. Po ajo, që i jepte fuqi, rendësi e frymë mësimi ishte ideja e atdhetarizmit shqiptarë që e përshkonte atë fund e krye. Shkolla ish bërë dhe u bë gjithnjë më shumë qendër kulture dhe atdhetarizmi shqiptarë. Prandaj, u rrit e punoi mes pengesash të mëdha, nëpër një luftë forte të ashpër. Ajo gjeti përpara vetës, që në fillim, po ata armiq që ishin hedhur kundër “mësonjëtores” së djemve⁹¹. Ata nuk lan asgjë pa përdorur për të asgjësuar këtë dëshmi të shqiptarizmit, për ti bërë varrin shkollës e atyre që punonin në të dhe për të. Nisën kërcënimet, mashtrimet, dhuna, ndjekjet më të egra. Pikërisht në verën e viti 1892, kur po bëheshin përgatitjet për vitin e ri shkollor, Mitropolisë me dhespotin në krye mendonin se ishte rast i përshtatshëm për zhdukjen fizike të personit kryesor që organizonte dhe mbante shkollën – te Gjerasim Qiriazit, dhe paguan një agjent për ta vrrarë atë. Kur aten –

⁸⁹ Sevasti Qiriaz, *Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912*, (Kujtime veteranësh), Tiranë, 1962, 173

⁹⁰ Hysni Myzryri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tirane, 1978.

⁹¹ *Foleja kombëtare*, 11 rane 1931

tatori u zbulua, dhespoti urdhëroi që ai të largohej nga aty⁹². Edhe një atentat tjetër i organizuar pas nja dy muajsh nuk arriti të realizonte qëllimin.

Ndonëse i sëmur, Gjasimi i shkruante motrës– Sevastisë: “Mos harro se je shqiptare. Ti ke pasur fatin të jesh e vetmja që more mësim të lartë, po gratë e tjera të vendit tendë, motrat e tua, janë të pamësuar... Të ndezësh në gjithë zemrat dashuri për atdheun dhe dëshirë për të mësuar gjuhën amtare...”⁹³ Kjo ishte porosia e fundit që i shkruante vëllai së motrës, ndërsa për shëndetin e vet, për sëmundjen që i merrte hov, nuk i shkruante fare. Më vonë rrëfen Sevastia, se: “Doktori i shtëpisë që e kuronte Gjerasimin dhe doktorët e tjerë me të cilët ai konsultohesh, ishin bashkuar me mitropolitin dhe ishin vënë në shërbim të tij, dhe arritën deri aty sa të tentojnë të përdorin helmën kundër jetës së Gjerasimit, vetëm e vetëm për të arritur qëllimet e tyre antishqiptare”.

Më 4 janar të viti 1894, vdiq Gjerasim Qiriaz, sapo i kishte mbushur 32 vjet. Ai vdiq në kohën kur ishte i kushtuar tërësisht shkollës shqipe, gjuhës e letërsisë dhe çështjes së pazgjidhur shqiptare.

Përhapja e shkollave dhe shkrimit shqip, si edhe sukseset, që arritën patriotët shqiptar në luftën për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, bënë edhe më të ngutshme nevojën e vendosjes së një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe. Rilindësit me të drejtë konsideronin mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe, jo vetëm një problem gjuhësor e kulturor por edhe një shenjë ndasie, që pengonte bashkimin e shqiptarëve. Ndërsa, zgjidhja e saj do të ndihmonte si në lëvrinim e mëtejshëm të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, ashtu edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit në luftën kundër robërisë osmane.⁹⁴

⁹² Sabile Keçmezi-Basha, *Karakteri kombëtar i shkollës së parë shqipe të vashave* (100 Vjetori i shkollës shqipe të vashave në Prizren), Prishtinë, 1993, 45

⁹³ Po aty, 47

⁹⁴ Shaban Demiraj & Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë 2004, f.68

Nismën për thirrjen e kongresit kombëtar për vendosjen e një alfabeti të vetëm e mori klubi shqiptar “Bashkimi” i formuar dhe i udhëhequr nga pinjollët e familjes Qiriazzi dhe të intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë pa dallim feje si Fehim bej Zavalani⁹⁵ që bashkëvepruan fuqishëm me motrat Qiriazzi dhe vëllain e tyre Gjergj Qiriazzi. Gjerasimi ishte në përjetësi por ëndrra e tij e madhe po realizohej që kombi përgatitej për ngjarjen më të madhe, e cila do të këpuste nga robëria për të ecur drejt lirisë e cila nuk do të vononte⁹⁶.

Dhe një datë historike: Kongresi i Alfabetit do të fillonte punimet me 14 nëntor, për të vazhduar deri më 22 nëntor, kur do të aprovohej një zgjidhje, le ta themi solomoniane, për të kënaqur polarizimet që vinin si refleks i interesave mesquine, apo dominim grupi të caktuar me një traditë, dorën në zemër të suksesshme, siç ishte ai i përfaqësuesve të Alfabetit të Stambollit, por edhe i alfabeve të shoqërive, po aq të njohura: “Bashkimi” dhe “Agimi” të Shkodrës, me përfaqësues të dinjitetshëm siç ishin: At Gjergj Fishta dhe Dom Ndre Mjeda.

Duke u bazuar në të dhënat arkivore si ato shqiptare dhe të huaja, në mesin e promotorëve të kongresit të Manastirit ishin edhe anëtarët e familjes Qiriazzi. Familja Qiriazzi i dhanë shtysë pjesëmarrësve të kongresit si dhe shtëpia e tyre në Manastir për fat të mirë, shumë afër me shtëpinë tashmë monument të Kongresit të Manastirit do të qe e hapur ditë e natë për takimet e çdo ditshme të komisionit të Kongresit

Suksesi i Kongresit të Manastirit në radhë të parë ishte sukses i një brezi të tërë patriotësh e atdhetarësh të kohës. Dhe, vepra që doli nga Kongresi i Manastirit i qëndroi kohës, u bë pjesë e pandashme e kulturës shpirtërore të kombit shqiptar.

⁹⁵ Fehim Zavalani, *Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912*, (Kujtime veteranësh), Tiranë, 1962, 231

⁹⁶ Safete Rugova, *Kongresi i Manastirit dhe motrat Qiriazzi*, Epoka e Re, 5 Nëntor 2018

Dua të shtoi se, me kontributin e shquar intelektual dhe atdhetar brenda dhe jashtë trojeve shqiptare për rilindjen, zhvillimin dhe mbarëvajtjen e arsimit tonë kombëtar. Për organizimin dhe pjesëmarrjen aktive në Kongresin e Manastirit, ngritjen e institucionit të parë arsimor femëror, shkollës së vashave ”Qiriazit”, krijimin e shoqatave atdhetare–kulturore shqiptare, botimin e Abetares së Parë, periodikëve arsimorë dhe librave historikë⁹⁷ ata: Gjasimi, Gjergji⁹⁸, Sevastia e Parashqevi Qiriazit⁹⁹, ishin aq shumë të lidhur në mes veti sa duhet thënë se vepra tyre është një dhe e pandarë dhe ndër shekuj do të qëndrojnë në panteonin e pavdekësisë.

Motrave Qiriazit, më 1960, Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka akorduar Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit titullin “Urdhri i Lirisë”, më 1962, me rastin e 50–vjetorit të Pavarësisë, medaljen “Për veprimtari patriotike”, kurse me 7 mars 1987, Presidiumi i Kuvendit Popullor, me rastin e 100– vjetorit të çeljes së Mësonjëtores së Parë Shqipe, i ka akorduar Gjerasimit, Sevastis dhe Parashqevi Qiriazit titullin e lartë “Mësues i Popullit”; Më 11.07.2017, Presidenti Nishani i akordon familjes Qiriazit, themeluese të VUSH, medaljen presidenciale “Nderi i Kombit’.

Dhe krejt në fund të nderuar të pranishëm, duhet shtuar se familja Qiriazit janë një shembull i lartë i ndërgjegjes kombëtare shqiptare, një përpjekje e vetëmohimit të tyre për arsimin e zhvillim si kusht i civilizimit të saj, luftëtar të emancipimit dhe lëvizjeve të para femërore shqiptare, patriotë dhe luftëtarë të çështjes për mbrojtje dhe bashkim kombëtar.

⁹⁷ Në dekretin nr. 10565 jepet motivacioni i Presidentit, si vijon Presidenti Nishani i akordon familjes Qiriazit, themeluese të VUSH, medaljen presidenciale “Nderi i Kombit’. Më dt. 11. 07. 2017

⁹⁸ Gjergj Qiriazit ishte delegat i Kongresit të Manastirit

⁹⁹ Parashqevi Qiriazit mori pjesë në Kongresin e Manastirit si delegate ngase ajo zëvendësoi motrën e saj Sevasti Qiriazin.

MARENGLEN VERLI

*Akademia e Studimeve Albanologjike të Republikës
së Shqipërisë*

INFORMACIONE NGA ARKIVAT E AUSTRO–HUNGARISË PËR KONGRESIN E MANASTIRIT, TË 14–22 NËNTORIT 1908*

Shqiptarët prej dekadash ishin bërë objekt por edhe subjekt në kancelaritë e Fuqive të Mëdha në kuadër të interesimit të tyre gjithnjë e më të madh për Ballkanin Osman. Interesim të veçantë për shqiptarët dhe trevat e banuara prej tyre, tregonin Austro–Hungaria, Britania e Madhe, Italia dhe Rusia. Periudha nga vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit deri në vitin 1908 kur triumfoi Revolucioni i Turqve të Rinj, e cila kishte qenë një periudhë degradimi për Perandorinë Osmane por rritjeje e pjekurie për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në politikën e të Mëdhenjve për rajonin e Ballkanit kishte qenë një fazë evolutive pa ndryshime të mëdha. Viti 1908 përcaktoi kthesën. Pas këtij momenti situata ndryshoi. Përmbysja politike në Perandorinë Osmane, humbjet territoriale, pavarësimi i Bullgarisë, aneksimi i Bosnje Hercegovinës nga Austro–Hungaria, gjallërimi i lëvizjeve nacionale dhe rritja e ndërhyrjeve të shteteve të Ballkanit për të nxitur lëvizje revolucionare separatiste e irredentiste, të bashkëkombësit e tyre, që ishin shtetas osmanë, e rizgjuan interesin e të Mëdhenjve për Ballkanin Osman. Informacione të shumëfishuara gjithfarësh, që vinin nga burime të gjithë niveleve, të detajuara, të seleksionuara, të konfirmuara e të klasifikuara nga një armatë diplomatësh të Fuqive të Mëdha të akredituar, me një shtrirje kapilare, jo vetëm në Stamboll dhe në qendrat e vilajeteve, por edhe në shumë qytete të trevave të ndryshme të Ballkanit Osman, shkonin drejt kryeqyteteve evrop-

* Kumtesë e përgatitur me rastin e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit.

piane. Ato çonin të dhëna për situatën politike, ushtarake, ekonomike, sociale, fetare, arsimore e kulturore, të popujve të Ballkanit dhe ishin burim informativ me të cilën Fuqitë filluan të rigatuanin politikën e tyre në rajon¹⁰⁰.

Kongresi i Manastirit, i mundësuar nga të drejtat dhe liritë e shpallura në Kushtetutën e Perandorisë Osmane (u shpall më 23.07.1908) në kushtet e regjimit të ri, ishte në vijim të veprimtarisë për organizimin legal të shumë klubeve kombëtare shqiptare gjatë muajve gusht–nëntor 1908, dhe të një bumi mediatik e arsimor në gjuhën shqipe (filloi botimi për herë të parë i gazetave në gjuhën shqipe, në viset shqiptare dhe në disa qytete të Perandorisë dhe u hapën një mori shkollash shqipe)¹⁰¹. Shqiptarët shkuan në Manastir, më 14–22 nëntor 1908, për të realizuar njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, por jo vetëm për këtë. Aty u diskutuan edhe çështje politike dhe çështje të tjera që duhet të çonin drejt njësimin dhe autonomisë së trevave shqiptare¹⁰². Ky tubim i shqiptarëve, pikërisht për rëndësinë e jashtëzakonshme në përcaktimin e të ardhmes së kombit shqiptar dhe zhvillimeve të afërta në Ballkanin Perëndimor, u bë objekt vëzhgimi i diplomatëve evropianë, çka pasqyrohet në këtë kumtesë. Para, gjatë dhe pas Kongresit, informacione deri në detaje, shoqëruar edhe me raporte të përgatitura

¹⁰⁰ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*) në Akademinë e Studimeve Albanologjike të Republikës së Shqipërisë, Fondi Arkivi i Vjenës (*HHStA, PA, A*), viti 1908; *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Mihal Duri, 1978, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha; *Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri* (ASDMAE), Roma, *The National Archives* (TNA), London etj.

¹⁰¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017, f. 89-100; *95-vjetori i Kongresit të Manastirit*, MASHM, Shkup, 2003; Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 2004; Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar në vitet 1908-1912*, Prishtinë, 1996; Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë, 1973.

¹⁰² *Po aty*.

nga pjesëmarrës në Kongres, u adresuan në Vjenë, Romë, Londër, Petërburg etj.

Ballkani po ziente, kombet e Perandorisë luftonin për aspiratat e tyre, por edhe të Mëdhenjtë shpalosnin projektet e tyre në rrethanat kur fundi i Perandorisë Osmane ishte një opsion i llogaritur, madje edhe i pëlqyer, në disa sfera të diplomacisë së lartë evropiane. Siç dëshmon informacioni për Kongresin e Manastirit, shqiptarët zinin një vend të rëndësishëm në planet e rikonfigurimit të Ballkanit¹⁰³.

Në informacionet dhe korrespondencën diplomatike të periudhës shtator–nëntor 1908, shumë i detajuar e interesant, rezulton veçanërisht dokumentacioni austro–hungarez. Ministri i Jashtëm, i Perandorisë Habsburge, merrte gati çdo ditë telegrame, letra e raporte nga vartësit e tij të akredituar në katër vilajetet shqiptare dhe nga ambasadori i tij në Stamboll. Raportime shpesh të dubluara me destinacion Vjenën, por edhe ambasadorin Palaviçini, niseshin rregullisht nga stafi diplomatik i kryekonsullatave në Shkup, Manastir, Shkodër, Janinë e Selanik, por edhe nga konsullatat në Durrës, Vlorë, Prizren, Mitrovicë, Korfuz, etj. Diplomatët me përvojë Lukash (Shkup), Kral e Fillunger (Shkodër), Posfai e Tahy (zv.), (Manastir), Pera (Selanik), Kraus (Vlorë), Prohaska (Prizren), Zambaur (Mitrovicë), Halla (Durrës), telegrafonin e postonin, gjithçka që mund t’u shërbente eprorëve¹⁰⁴.

¹⁰³ *AIH*, Arkivi i Vjenës, viti 1908, Vj.18.2.232, Vj.18.4.411, nr.140; Vj. 18.12.1245, nr.56; Vj.18.12.1246, nr.57; Vj.18.9.923, nr. 693; etj. Orientime të baronit Erental për konsullin austro-hungarez në Shkodër Kral (shtator 1908); Telegram i konsullit austro-hungarez në Janinë, 2 shtator 1908, për themelimin e klubit shqiptar në atë qytet dhe në Manastir; Telegram i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Zambauer, më 6 shtator për arritjen atje të një koloneli britanik; Telegram i konsullit Prohaska nga Prizreni, më 5 shtator 1908, mbi regjistrimin e popullsisë serbe në Prizren, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Selanik dt. 7 shtator 1908, lidhur me klubet shqiptare, shkollat, librat në gjuhën shqipe etj., Telegram i konsullit Kral nga Shkodra, dt. 7 shtator 1908, mbi përgatitjen e shqiptarëve për të mbledhur Kongresin e Manastirit, dhe dt. 9 nëntor 1908 për shkaqet e përçarjes së shqiptarëve, etj.

¹⁰⁴ *Po aty*.

Në morinë e informatave, që kishin të bënin me shtimin e kërkesave dhe gjallërimin e propagandës nacionaliste e fetare në komunitetet e ndryshme etnike e fetare në vilajetin e Kosovës, Manastirit e Janinës, gjithashtu që kishin të bënin me praninë në terren të emisarëve bullgarë, serbë, grekë, malazezë (këta aktivizonin Sokol Bacin), por edhe britanikë e francezë, italianë etj., ndër të cilët shfaqen ushtarakë (p.sh. një kolonel britanik Murray, një kolonel rus), gazetarë (serbi Nushiq), biznesmenë, apo aktivistë që regjistronin popullsinë sllave, mandej të informatave për pasigurinë dhe rendin e cenuar, për rritjen e banditizmit, për gjendjen ekonomike dhe biznesin, për zgjedhjet parlamentare dhe për kandidaturat në vise të ndryshme etj., mund të filtrohen të dhënat që kanë të bëjnë me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në përgjithësi, por edhe për individët, për klubet, për shkollat dhe arsimin në gjuhën shqipe, etj.¹⁰⁵

Duke vlerësuar faktorin shqiptar si shumë të rëndësishëm për politikën e vet në Ballkan, Austro-Hungaria, në vijën e ndjekur prej saj në disa dekada për të ndihmuar emancipimin e kombit shqiptar, përmes ministrit të Jashtëm Erental, në shtator 1908, udhëzonte konsullin e tij në Shkodër, Kral, “se do të ishte shumë e dëshirueshme sikur në çështjen e alfabetit të arrihej bashkimi i plotë politik”¹⁰⁶. Austro-Hungaria kishte investuar shumë për forcimin e lobit të vet në Shkodër, ku ndërkohë lulëzonin 3 alfabetet (i “Bashkimit”, “Agimit” dhe jezuitëve), dhe ishte e interesuar ta shihte kombin “mik” shqiptar të unifikuar në çdo pikëpamje. Në Vjenë kishin informacion të saktë dhe vlerësonin se klubet që po themeloheshin nga fundi i gushtit dhe fillimi i shtatorit, dhe që po interesohehin për një kuvend, që do të unifikonte alfabetin e shqipes, synonin njëherësh bashkërendimin e pikëpamjeve dhe veprimeve politike që synonin në finale autonominë e Shqipërisë. Konsulli Pera njoftonte nga Selaniku më 7 shtator se në një mbledhje madhështore me 400–500 pjesëmarrës “toskë e gegë” të organizuar

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *AIH*, Vj. 18-2-232, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë, Erental për konsullin Kral në Shkodër (shtator 1908).

në sallën e teatrit të Selanikut, ku Mit'hat Frashëri kishte nënvizuar qëllimin për të cilin ishin ngritur klubet, ishin pranuar statutet e klubeve dhe ishte vendosur që shkollat, revistat dhe librat në gjuhën shqipe të përdroreshin për të propaganduar idetë kombëtare¹⁰⁷. Një javë më vonë, më 15 shtator, konsulli Tahy, njoftonte nga Manastiri mbi ceremoninë e hapjes së klubit shqiptar "Bashkimi", nga presidenti Fehmi bej Zavalani në prani të autoriteteve të vendit (i pranishëm edhe valiu, Hivzi Pasha), të trupit konsullor, dhe të përfaqësuesve të komuniteteve greke, bullgare e vllehe. Ai kujdesej të informonte edhe për divergjencat që ishte dashur të kapërceheshin për shkak se dibranët që jetonin në Manastir me në krye Abdurahman Beun ishin ndër të fyer që nuk përfaqësoheshin në komitetin e klubit¹⁰⁸. I njëjti konsull njoftonte më 26 tetor nga Manastiri se, për të shmangur përçarjen, Mit'hat Frashëri kish ndikuar që në krye të klubit të dilte Rexhep Haxhia, kurse Fehmi bej Zavalani të ishte nënkryetar, çka lidhej dhe me anëtarësimin në klub të 160 gegëve dhe 70 toskëve. Në të njëjtin raport, Tahy njoftonte se tashmë klubet ishin themeluar në Elbasan, Korçë, Starovë, Stamboll, Shkodër, Janinë, Berat, Filat etj¹⁰⁹. Po atë ditë, më 26 tetor Vjena, përmes një qarkoreje, kërkonte informacion nga konsullatat për veprimtarinë që kryenin klubet shqiptare në fushën e gjuhës dhe të arsimit për zgjerimin e çështjes kombëtare¹¹⁰. Në dokumentet e kancelarive të kohës figurojnë edhe shumë emra atdhetarësh e aktivistësh të njohur, si: I. Qemali, vëllezërit Topulli (Bajo, Fehmi e Çerçiz), Dervish Hima, Mihal Grameno, Fehmi bej Zavalani, Bajram Fehmiu, Gjergj Qiriazi etj., të cilët janë mjaft

¹⁰⁷ *AIH*, Vj. 18-4-412, Raport i dt. 7 shtator 1908 nga konsullata e Selanikut për Ministrinë e Jashtme të Austro-Hungarisë.

¹⁰⁸ *AIH*, Vj. 18-4-413, Raport i konsullit Tahy, nga Manastiri, dt. 15 shtator 1908.

¹⁰⁹ *AIH*, Vj. 18-8-899, Raport i Tahy-t, dt. 26 tetor 1908.

¹¹⁰ *AIH*, Vj. 18-2-266, Qarkore e MP të Jashtme nisur nga Vjena më 26 tetor për konsullatat austro-hungareze në viset shqiptare; *AIH*, Vj. 18-4-411, Raport i Lukas-it nga Shkupi, dt. 1 shtator 1908 për ministrin Erental; *AIH*, Vj. 18-1-141, Telegram i Krausit nga Vlora, dt. 3 shtator 1908; *AIH*, Vj. 18-4-412, Raport nga konsullata e Austro-Hungarisë në Selanik, dt. 7 shtator 1908, etj.

aktivë për çështjen e alfabetit dhe të lëvizjes kombëtare përgjithësisht pas Revolucionit Xhonturk dhe shpalljes së kushtetutës¹¹¹.

Ndërkohë, që në datën 7 shtator 1908, konsulli Kral kishte njoftuar nga Shkodra eprorët në Vjenë se shqiptarët kishin përcaktuar Manastirin si vend, ku me pjesëmarrje të “delegatëve të të gjitha partive” do të caktohej alfabeti i ardhshëm i gjuhës shqipe. Kurse më 28 tetor, ministri Erental do të kish në duar dërgesën postare të konsullit të Manastirit që përmbante edhe programin e Kongresit që do të mbahej më 1–14 nëntor në atë qytet nën kujdesin e klubit “Bashkimi”¹¹².

Interesimi i Vjenës për sa do të ndodhte në Manastir nuk u pakësua as pas protestave që shpërthyen javën e fundit të tetorit në Kosovë kundër aneksimit të Bosnjës nga Austro–Hungaria, as nga zgjedhjet parlamentare në fillim të nëntorit. Në një raport të detajuar konsulli Kral njoftonte nga Shkodra më 9 nëntor, ndërthurjen e diferencave partiake politike me diferencat në alfabetet, madje arrinte të vlerësonte ndryshimet në 5 alfabetet (alfabeti i Frashërllinjve, ai grek, ai i jezuitëve, i “Bashkimit” dhe i “Agimit”), si shkaqet kryesore të përçarjes partiake. Sipas tij, lëvizja letrare bashkë me shtypin kontribuan në shtimin e tarafeve partiake e jo në eliminimin e kontradiktave¹¹³.

Një ditë pas përfundimit të Kongresit të Manastirit më 23 nëntor, konsulli Posfai i raportonte nga Manastiri eprorëve në Stamboll e Vjenë, mbi diskutimet e mbajtura në Kongres më 14–21 nëntor 1908. Në raport jepej lista e 32 delegatëve me të drejtë vote, si dhe

¹¹¹ *AIH*, Vj.18-4-411, Raport i Lukasit nga Shkupi, dt. 1 shtator 1908; *AIH*, Vj. 18-1-141, Telegram nga konsullata e Vlorës, dt. 3 shtator 1908; *AIH*, VJ.18-4-412, Raport nga Selaniku, dt. 7 shtator 1908 etj.

¹¹² *AIH*, Vj. 18-2-269, Posta e konsullit të Manastirit për Erentalin, dt. 18 tetor 1908.

¹¹³ *AIH*, Vj. 18-11-1115, Relacion i konsullit Kral, dt. 9 nëntor 1908.

e 18 të tjerëve pa të drejtë vote, gjithashtu edhe vendimet e komisionit prej 11 vetësh për krijimin e alfabetit¹¹⁴.

Një javë më vonë, më 30 nëntor, Posfai i raportonte sërish MP Jashtme për Kongresin e Manastirit. Këtë herë ai theksonte se përveç çështjeve të alfabetit, shqiptarët diskutuan edhe çështje të tjera që nuk ishin parashikuar në programin e Kongresit, sikurse ishte programi kombëtar i paraqitur në parlamentin e Stambollit nga Shahin Kolonja, deputeti i Korçës (në fakt ai ishte fryt i diskutimeve dhe Sh. Kolonja u ngarkua ta paraqesë në parlament në emër të shqiptarëve. Përmbajtja e tij, ishte rezymeja e diskutimeve në mbledhje të fshehta për çështje politike të ditës, sikurse ishin marrëdhëniet e shqiptarëve me turqit, lufta e popullit shqiptar për të drejta kombëtare, për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit, si edhe marrëdhëniet me shtetet evropiane)¹¹⁵. Programi prej 18 pikash ishte një dokument shumë i rëndësishëm i Kongresit të Manastirit, ku pasqyroheshin aspiratat e shqiptarëve për autonominë territoriale administrative të Shqipërisë.

Në raportin e konsullit shkruhej edhe për udhëtimin e kryetarit të klubit “Bashkini”, Rexhep Hoxhës në Ohër, Dibër, Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë dhe Shkup me qëllim që të formonte komitete të fshehta, që të zhvillojnë ndjenjat kombëtare. Sipas Posfait “shqiptarët kërkojnë po ato të drejta që i gëzojnë edhe kombet e tjera të Perandorisë Osmane¹¹⁶.

Janë interesante në raport edhe informacionet për lutjen e G.Cilkes dhe M. Gramenos, drejtuar Patrikanës, që në kisha përveç greqishtes të përdoret edhe shqipja. Në raport jepen gjithashtu, informata për nisjen në Korçë të 9 delegatëve të Kongresit të Manastirit: Nysret bej Vrionit, Luigj Gurakuqit, Shefqet Beut, Fehmi bej Zavalanit, Arqile Eftimiut, Dhimitër Moles, Sotir Peçit, Hil Masit e Mihal Gramenos) si dhe lajmi se Kristaq Naumi nga Bukureshti

¹¹⁴ *AIH*, Vj. 18-9-901, Raport i Posfait, dt. 23 nëntor 1908.

¹¹⁵ *AIH*, Vj. 18-7-750, Raport i Posfait nga Manastiri, dt. 30 nëntor 1908.

¹¹⁶ *Po aty*; *AIH*, Vj. 18-9-902, Raport i Posfait, dt. 30 nëntor 1908.

dhuroi 3000 napolona ari për ndërtimin e një shkolle teknike në Korçë¹¹⁷. Posfai shënon edhe synimin e shqiptarëve pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit për hapjen e një gjimnazi shqiptar në Korçë, ku do të emërohen 2 profesorë shqiptarë të ardhur nga Bukureshti.

Mund të shtrohet pyetja: Nga e merrte informacionin kaq të detajuar konsulli i Manastirit? Sigurisht, cilido nga konsujt, çfarëdo informacioni që siguronte dhe që e vlerësonte se u shërbente eprorëve, e adresonte në Stamboll në ambasadën e Austro-Hungarisë atje dhe në Vjenë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Por në rastin e informacionit shumë të detajuar që ofronte konsullata austro-hungareze e Manastirit, kanë qenë frymëzues të dhënash edhe delegatët. Njëri nga ata që raportonte çka ndodhte në Kongres ishte Gjergj Qiriazi, njëri ndër 11 anëtarët e komisionit që vendosi për çështjen e alfabetit.

Botime të viteve të fundit të Shoqërisë “Biblike”, me të cilët Qiriazi bashkëpunonin prej kohësh, konfirmojnë se Gjergji përgatiti më 16 janar 1909, raportin e detajuar për Kongresin e Manastirit, që përfundoi përmes kanaleve diplomatike në Londër¹¹⁸.

Qiriazi me raportet e tij pasi vlerëson Revolucionin Xhonturk, përmend gjendjen e shqiptarëve, mandej praninë e 6–7 alfabeve, dhe pengesën e tyre për zhvillimin e gjuhës dhe nismën e klubit të Manastirit për organizimin e Kongresit me pjesëmarrje nga e gjithë Shqipëria. Më tej ai saktëson se në Kongres, kryetar nderi ishte vali Hivzi Pasha, kurse zëvendëskryetar Rexhep Efendi dhe Fehmi Beu (Zavalani), se kongresi i filloi punimet më 14 nëntor, ditën e shtunë, në orën 16.00. Sipas tij numri i delegatëve ishte 58, dhe veprimi i parë ishte zgjedhja e Mithat Frashërit kryetar, kurse zëvendëskryetar Gjergj Qiriazi dhe Luigi Gurakuqi¹¹⁹.

¹¹⁷ *Po aty*.

¹¹⁸ Memli Krasniqi, Armend Mehmeti, *Dokumente të Shoqërisë Biblike dhe për të huajt (1816-1912)*, Prishtinë, 2016, Botim i Institutit Albanologjik – Prishtinë, f. 97-119.

¹¹⁹ *Po aty*.

Pastaj informimi shkron ditë pas dite me detaje. Në raport shkruhet për diskutimet, për vendimet deri në përcaktimin e shkronjave, listohen klubet, shkollat dhe shoqëritë e hapura që nga shpallja e kushtetutës, argumentohet edhe pse u zgjodhën dy alfabetë. Është një raport që edhe sot ndoshta nuk do të bëhej më me përpikëri, me kulturë e argumente.

Duke studiuar dokumentacionin e kancelarive të mëdha të kohës me interesa në rajon, veçanërisht dokumentacionin diplomatik austro-hungarez, mësojmë jo vetëm për situatën politike në trevat shqiptare në vitin 1908, por edhe për ato zhvillime në arsim e kulturë që do të ndikonin drejtpërdrejtë në hapat drejt krijimit të shtetit shqiptar. Njëherësh dokumentacioni në fjalë na konfirmon interesimin e veçantë të Fuqive të Mëdha për faktorin shqiptar, i cili në sajë të zhvillimit dhe arritjeve të lëvizjes kombëtare, ishte bërë i paneglizhueshëm dhe me peshë në rajon.

FEHARI RAMADANI & NAZMIJE SHAQIRI

Universiteti i Tetovës

ÇËSHTJA SHQIPTARE NË FOKUSIN E DIPLOMACISË VJENEZE (TETOR–NËNTOR 1908)

*“Shqipëria nuk mund të ekzistojë pa shqiptarë, shqiptarët
nuk mund të ekzistojnë pa gjuhën shqipe, e kjo e fundit
nuk mund të ekzistojë pa alfabetin e vet dhe pa shkolla”*

Sami Frashëri

Në vjeshtën e vitit 1908, regjimi xhonturk pësoi goditje serioze dhe dobësoi autoritetin e tij midis popujve të pjesës evropiane të Perandorisë. Më 5 tetor 1908, duke shfrytëzuar zhvillimin e revolucionin xhonturk, Austro–Hungaria e aneksoi Bosnjën dhe Hercegovinën¹²⁰ (të cilën e mbante të pushtuar që nga Kongresi i Berlinit, i vitit 1878), kurse në marrëveshje me qeverinë e Vjenës, Bullgaria shpalli pavarësinë e plotë nga sulltani. Kreta, e cila kishte pasur një varësi nominale ndaj Portës së Lartë, por që kishte gëzuar një autonomi nën mbikëqyrjen e Fuqive të Mëdha, në vjeshtën e atij viti, nisi përpjekjet për bashkim me Mbretërinë Greke. Shpallja e aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, shkaktoi pakënaqësi në qarqet sunduese të Stambollit, por edhe tek një pjesë e shtresës myslimane të popullsisë shqiptare. Komiteti “*Bashkim e Përparim*”, u bëri thirrje popujve të Perandorisë Osmane që t’i bojkotonin të gjitha mallrat austro–hungareze. Madje u përpoq të shfrytëzonte ndjenjat

¹²⁰ *Књига о Балкану II*. 1937. Београд: Издавање Балканског Института, с. 168–169; Ivetic, Egido. 2008. *Luftërat ballkanike*. Tiranë: Dituria, f. 35.

fetare të popullsisë shqiptare myslimane, duke kërkuar që në emër të panislamizmit t'i kundërviheshin veprimet të qeverisë vjeneze¹²¹.

Aneksimi i tashmë ish-provincës osmane shkaktoi pakënaqësi të madhe brenda qeverisë osmane dhe popullsisë turke. Sipas një raporti nga Stambolli, të datës 12 tetor, kishte dy ditë që zhvillohej një fushatë bojkotimi për mallrat austro-hungareze. Oficerët osmanë mbanin fjalime para masave për t'i bindur që të mos blinin produkte të Monarkisë së Dyfishtë, madje edhe i pengonin konsumatorët që të vizitonin dyqanet austro-hungareze. Bojkotimi filloi të merrte karakter zyrtar, pasi Ministria e Luftës e shtetit osman kishte hequr dorë nga porosia për blerjen e kuajve nga qeveria vjeneze¹²². Autoritetet osmane pakënaqësinë e tyre ndaj këtij veprimi të qeverisë vjeneze u përpoqën ta përhapnin edhe tek popullsia shqiptare e besimit mysliman.

Megjithatë, apeli turqve të rinj, nuk u prit njëlloj në të gjitha territoret shqiptare. Brenda një pjese të popullsisë myslimane shqiptare ai pati përkrahje e në disa të tjera nuk gjeti asnjë mbështetje. Gjithashtu, disa intelektualë dhe gazeta të kohës iu bashkuan apelit xhonturk, por disa të tjerë jo vetëm që nuk e kundërshtuan aneksimin por për më tepër edhe e mbështetën atë, duke u shprehur se ky veprim si dhe shpallja e pavarësisë së Bullgarisë do ta përshpejtonin edhe procesin e pavarësimit të Shqipërisë.

Disa intelektualë shqiptarë të kohës, aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës, shpalljen e pavarësisë së Bullgarisë dhe nismën e Kretës për bashkim me Greqinë e vlerësonin si hapin e parë drejt copëtimit të mëtejshëm të territoreve tjera osmane në Ballkan, çka sipas tyre rrezikonte edhe vetë territoret e banuara me popullsi shqiptare.

¹²¹ Skendi, Stavro. 2000. *Zgjimi Kombëtar Shqiptar, 1878-1912*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, f. 321.

¹²² *Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives*, Wien, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Fondi Dokumente të sjella nga Arkivi i Vjenës dhe të përkthyer në shqip, Vj. 18-9-974. Raport nr. 217, nga Stambolli për Gjeneral Feldmareshalleitnant, von Konrad, në Vjenë. Stamboll, më 12 tetor 1908. (Më tej: *AIH*, Vj...).

Udhëheqja e Klubit Shqiptar në Stamboll përkrahu xhonturqit dhe u drejtoi një thirrje bashkëkombësve të vet, duke kërkuar që ata të bashkoheshin kundër kërcënimit të invazionit të jashtëm. Në Shqipërinë e Jugut, klubet organizuan disa demonstrata kundër aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe bojkotonin mallrat austro-hungareze¹²³. Ky veprim i qeverisë së Vjenës, u konsiderua i dëmshëm dhe sipas tyre rrezikonte integritetin territorial të territoreve shqiptare. Për këtë arsye, në Vlorë u zhvillua një demonstratë para konsullatës austro-hungareze, dhe nënkonsulli Kraus, si organizator të saj e konsideronte Ismail Qemalin¹²⁴.

Nënkonsulli austro-hungarez në Vlorë, Kraus e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se popullsia e atij qyteti fillimisht i kishte pritur me qetësi lajmet mbi aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe shpalljen e pavarësisë së Bullgarisë. Por, ky qëndrim kishte ndryshuar pasi popullsia e atjeshme ishte njohur me qëndrimin e qeverive të Fuqive të Mëdha dhe sidomos të qeverisë britanike, të cilat e kundërshtuan këtë veprim të Vjenës. Gjithashtu, popullsia e atij rrethi konsullor e përkrahu pjesërisht bojkotimin e mallrave, megjithëse sipas diplomatit të përmendur, ajo lëvizje “*nuk funksionoi mirë*”. As përpjekjet e xhonturqve për të prekur ndjenjat fetare të popullsisë nuk patën efektin e dëshiruar prej tyre. Nënkonsulli austro-hungarez, e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se me përjashtim të disa myslimanëve të veçuar “*popullsia e këtyshme qëndron krejtësisht e ftohtë kundrejt ideve panotomane*”. Në fillim të nëntorit, Kraus, lëvizjen e bojkotit e konsideronte pothuajse të mbaruar, e cila sipas tij ishte e barabartë me një disfatë morale të xhonturqve. Disa atdhetarë, si Eqrem bej Vlora, Xhemil bej Vlora, Leonidha Naçi* etj., u shprehën kundër bojkotimit të mallrave aus-

¹²³ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 321.

¹²⁴ Ismail Qemali, *Përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*, Përgatitur nga Teuta Hoxha. 2002. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë, f. 143-144.

* Leonidha Naçi ishte zgjedhur sekretar i klubit të Vlorës, i cili ishte themeluar para pak ditësh.

tro–hungareze nga popullsia shqiptare ¹²⁵, duke konsideruar se një gjë e tillë dëmtonte në radhë të parë ekonominë shqiptare.

Megjithatë, një pjesë e shqiptarëve vlerësonin në hartën politike të Ballkanit, rrezikonin edhe territoret shqiptare. Sipas gazetës “*Shko–pi*”, e cila dilte në Egjipt, bashkimi i Kretës me Greqinë, do ta fuqizonte shtetin grek dhe aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, mund t’i jepte asaj një shkak të rrëmbente toka nga Shqipëria Jugore¹²⁶. Kundër aneksimit doli edhe gazeta “*Liri*” e cila dilte në Selanik. Në numrin e 10 të saj, gazeta e Lumo Skendos, e konsideronte Austro–Hungarinë si “*prishës i qetësisë*” dhe aprovonte bojkotimin e mallrave të saj. Në një letër që Kral i drejtonte Vjenës, më 30 tetor 1908, e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se gazeta e Mit’hat Frashërit, kishte botuar një artikull armiqësor ndaj qeverisë austro–hungareze, për shkak të aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Botuesi i gazetës aprovonte nismën për bojkot të mallrave austro–hungareze, pasi ai vlerësonte se autore e pavarësisë së Bullgarisë ishte qeveria vjeneze dhe si e këtillë ajo ishte “*prishëse e qetësisë së rilindjes xhon–turke dhe shtetit otoman*”. Prandaj, konsulli kërkonte nga eprorët e tij në Vjenë që t’i jepnin udhëzime se si të vepronin në këtë rast. Ai mendonte se Lumo Skendo (Mit’hat Frashëri), të cilin konsulli e quante njërin nga “*kampionët më të rëndësishëm të lëvizjes shqiptare*” ose kishte keqkuptuar qëllimet e Austro–Hungarisë ose ishte ndikuar nga turqit. Mirëpo, në të njëjtin raport, ai njoftonte shefat e tij se gjithashtu duhej pasur parasysh se atdhetarët shqiptarë për të “*siguruar ekzistencën dhe prosperitetin e çështjes së tyre përpara valës xhonturke nacionaliste të theksuar, janë të detyruar të tregojnë kujdesin më të madh dhe të mbajnë qëndrim korrekt ndaj qeverisë dhe lëvizjes kushtetuese turke*”¹²⁷. Sipas këtij vlerësimi që jepte konsulli, i cili ishte njohës i

¹²⁵ *AIH*, Vj. 18-1-125. Raport nr. 63, i nënkonsullit Kraus për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Vlorë, më 4 nëntor 1908.

¹²⁶ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 322.

¹²⁷ *AIH*, Vj. 18-3-354. Njoftim nr. 118, i konsullit Kral për ministrin e Jashtëm. Shkodër, më 30 tetor 1908.

mirë i rrethanave në Perandorinë Osman në përgjithësi dhe në Shqipëri në veçanti, mund të konkludohet se ky qëndrim i Mit'hat Frashërit mund të ishte më tepër i nxitur nga dëshira për të krijuar përshtypjen sikur mbante anën e qeverisë së Stambollit, në lidhje me çështjen e aneksimit, por se qëllimi i vërtet i tij ishte t'i krijonte vetes hapësirë për të punuar për çështjen kombëtare.

Në relacionin e tij, Kral propozonte që Gjergj Qiriazi dhe Fehim Zavalani, dy njerëz të besueshëm të qeverisë austro-hungareze në Manastir, të shfrytëzonin autoritetin e tyre për ta bindur Lumo Skendon se aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës nuk dëmtonte shqiptarët¹²⁸.

Studiuesi Stavro Skendi vlerësonte se bojkotimi i mallrave austro-hungareze pati përkrahje më të gjerë në territoret shqiptare veriore, të cilat ndodheshin më afër Bosnjës dhe Hercegovinës. Kjo bëhej për shkak të kundërshtimit që popullsia e atjeshme u bënte të huajve dhe jo në shenjë të besnikërisë së tyre për qeverinë osmane. Ajo në fakt i frikësohej ndonjë traktati të ri, që do të cungonte edhe më tej tokat shqiptare. Dobësia e regjimit xhonturk për të ndaluar aneksimin, sipas tij, e rriti “*dëshirën për veprimin independentë*”¹²⁹ në Kosovë. Në Shkodër, lajmi mbi aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës, në popullsinë myslimane të atij qyteti, nuk ngjalli reagonin e dëshiruar nga qeveria, kurse katolikët nuk reagueshin fare. Vjena nga ana e saj, përballë fushatës së turqve të rinj nuk qëndroi duarkryq. Siç duket ajo u kishte premtuar shqiptarëve një ndihmë në armatim, prej 10.000 pushkësh, në rast të sulmit të mundshëm malazez. Flitej se pas luftës së mundshme midis Austro-Hungarisë dhe Malit të Zi, Shqipërisë do t'i kthehej Ulqini¹³⁰.

Qeveria xhonturke zhvillonte ndër shqiptarët e Manastirit një propagandë të dendur kundër qeverisë austro-hungareze. Kjo politikë

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ Skendi, Skendi, *vep. e përm.*, f. 323.

¹³⁰ *Po aty*, f. 322; Abdyl, Ramiz. 2004. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 138.

përkrahej edhe nga disa anëtarë të klubit shqiptar të Selanikut, e veçanërisht nga Mit'hat Frashëri. Sipas një raporti që konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral i dërgonte ambasadorit të tij në Stamboll, Pallaviçini, ndër të tjera thuhej se M. Frashëri në bisedat që kishte zhvilluar me pjesëmarrësit tjerë të Kongresit të Alfabetit në Manastir, kishte shprehur bindjen se qëllimi i Vjenës nuk ishte bashkimi i shqiptarëve por, se ajo donte të “*intrigonte kundër konstitucionalizmit në Turqi*” dhe pastaj “*të peshkonte në ujëra të turbullta*”. Sipas konsullit të përgjithshëm, ky “*mendim i gabuar*” burimin nuk e kishte në qarqet shqiptare, por në ato xhonturke. Kjo propagandë xhonturke nuk ishte shprehje e bindjes së tyre por, rezultat i frikës se “*mos Lëvizja Kombëtare Shqiptare me anën e përkrahjes tonë do të zhvillohet më fuqishëm*”. Propagandë të njëjtë kundër politikës austro-hungarez në Shqipëri zhvillonte edhe qeveria serbe¹³¹.

Pas kthimit nga Kongresi i Alfabetit në Manastir, Gjergj Fishta kishte zhvilluar një takim me konsullin e përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral të cilin e kishte njoftuar rreth qëndrimit të klubit të Selanikut dhe të Mit'hat Frashërit ndaj politikës së Austro-Hungarisë në Shqipëri. Sipas Fishtës ata e shihnin me mosbesim qëndrimin e qeverisë vjeneze dhe qëllimet “*e sinqerta prosh-qiptare*”. Kryetari i Klubit të Selanikut mendonte se Monarkia e Dyfishtë nuk kishte për qëllim ta përkrahte seriozisht çështjen shqiptare, por se qëllimi i vërtetë i saj ishte të “*thurte intriga anti-konstitucionale*” në Perandorinë Osmane. Konsulli ishte i bindur se këto ide ndër shqiptarë ishin përhapur nga xhonturqit, të cilët ishin të bindur se nën “*përkrahjen tonë* (austro-hungareze- shënimin ynë) *çështja shqiptare do të zhvillohej fuqishëm*”, çka binte në kundërshtim me politikën cenralizuese xhonturke. Sipas konsullit krahas xhonturqve propagandë austro-hungareze te shqiptarët

¹³¹ AIH, Vj. 18-9-927. Raporti nr. 100, i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral, për ambasadorin austro-hungarez në Selanik, Johan Markez von Pallaviçini. Shkodër, më 15 dhjetor 1908.

zhvillonin edhe serbët dhe sipas tij disa personalitete binin pre e këtyre propagandave¹³².

Në një raport nga Stambolli, që i dërgohej Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, në fund të dhjetorit 1908, theksohej se aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, kishte krijuar përshtypjen edhe te disa krerë të kulturuar dhe me “*ndjenja kombëtare*”, se politika ballkanike e Austro-Hungarisë synonte pushtimin e territoreve shqiptare. Në raport, këshillohej Ministria e Punëve të Jashtme austro-hungareze, që shqiptarëve t’u jepej një “*sqarim i plotë mbi qëndrimin e politikës*” austro-hungareze ndaj Shqipërisë. Duhej t’u sqarohej shqiptarëve se heqja dorë nga sanxhaku i Tregut të Ri, i cili në pjesën më të madhe banohej nga shqiptarët, ishte një provë e mjaftueshme se qeveria e Vjenës nuk kishte ndërmend të bënte pushtime territoriale në Ballkan, ajo nuk kishte mbajtur as pjesën më të vogël të territoreve të Perandorisë Osmane të banuara nga shqiptarët dhe se ndihmonte Shqipërinë që “*të marrë një strukturë të bashkuar*”¹³³.

Kundërshtimi ndaj aneksimit nuk bëhej ngase shqiptarët synonin ruajtjen e sundimit osman në Gadishullin Ballkanik, por nga frika se ajo ngjarje së bashku me pavarësinë e Bullgarisë do të kishin pasoja në pjesën tjetër evropiane të Perandorisë Osmane, dhe rrjedhimisht, edhe për tokat shqiptare. Përkrahja që Austro-Hungaria i kishte dhënë shpalljes së pavarësisë së Bullgarisë, nga disa atdhetarë shqiptarë konsiderohej e dëmshme për interesat shqiptare pasi tërthorazi rrezikonte integritetin territorial të Perandorisë Osmane dhe në këtë kuadër edhe të Shqipërisë. Sipas tyre suksesi i Bullgarisë, do të nxiste dëshirat ekspansioniste të Serbisë, Malit të Zi dhe të Greqisë, të cilat do të drejtoheshin kundër tokave shqiptare¹³⁴. Ky qëndrim i

¹³² AIH, Vj. 18-3-359. Raport nr. 146, i konsullit të përgjithshëm, Kral për ministrin e Punëve të Jashtme. Shkodër, 15 dhjetor 1908.

¹³³ Po aty, Vj. 18-12. Raport nga Stambolli nr. 106 M, drejtuar MPJ. Stamboll, më 30 dhjetor 19098.

¹³⁴ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 322.

një pjese të popullsisë shqiptare myslimane ishte rezultat i rrethave të asaj kohe.

Megjithatë, në territoret shqiptare çështja e bojkotimit nuk pati jehonë të njëjtë. Në disa pjesë apeli i autoriteteve shtetërore nuk gjeti fare mbështetje. Më 10 tetor komiteti xhonturk në Shkodër njoftoi se Bullgaria kishte shpallur pavarësinë, por sipas konsullit të përgjithshëm austro-hungarez atje, kjo gjë nuk u kishte bërë përshtypje shqiptarëve, pasi territoret bullgare i konsideronin “*provinca të largëta*”. Madje, sipas Kral as lajmi për aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës, nuk dha efektin e dëshiruar nga xhonturqit¹³⁵.

Në rajonin e Mitrovicës aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe shpallja e pavarësisë së Bullgarisë, nuk shkaktuan ndonjë shqetësim. Sipas një raporti të konsullit von Cambaur, mitingjet e mëdha që ishin zhvilluar në Shkup, në kryeqytetin e vilajetit, nuk ishin përsërit në disa pjesë tjera të Vilajetit të Kosovës. Kjo sipas tij ishte ndoshta edhe rezultat i “*antipatisë*” që shqiptarët e Pejës, të Drenicës, të Vushtrrisë dhe të Prishtinës kishin për regjimin xhonturk. Prandaj, ata mund të afroheshin me secilin agjitacion që mund “*t’i shkaktonte ngatërresa xhonturqve*”¹³⁶.

Nga relacioni i një njeriu të besueshëm vjenez, bëhej e ditur se përpos tregtarëve shqiptarë, bojkotimin e mallrave austro-hungareze e kundërshtonin edhe deputetët në parlamentin osman dhe personalitete shqiptare me peshë në Stamboll. Si shpërblim për këtë, udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare kërkonin furnizimin me armë, në rast të një lufte me Malin e Zi dhe me Serbinë. Bojkotimin e mallrave austro-hungareze nuk e aprovonte as edhe një pjesë

¹³⁵ *AIH*, Vj. 18-6-676. Raport nr. 66, i konsullit të përgjithshëm Kral, për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Johan markez von Pallavicini. Shkodër, më 10 tetor 1908.

¹³⁶ *Po aty*, Vj. 18-12-1272. Raport nr. 73, i konsullit von Cambaur për ambasadorin austro-hungarez në Kostandinopojë, Johan von Palavicini. Mitrovicë, më 14 tetor 1908.

e mirë e shtypit shqiptar të kohës, që dilte jashtë vendit, sepse bojkotimi, sipas tij, i dëmtonte interesat e gjithë popullit shqiptar¹³⁷.

Për Faik Konicën aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria dhe shpallja e pavarësisë së Bullgarisë, ishin ngjarje që e afronin ditën e pavarësisë së Shqipërisë. Ai shprehej edhe kundër bojkotimit të mallrave austro-hungareze, sepse një gjë e tillë dëmtonte më së shumti tregun shqiptar¹³⁸. Faik Konica i takonte atij grupi të personaliteteve shqiptare, që aprovoi aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe pavarësimin e Bullgarisë. Sipas tij, ngjarjet e mësipërme ishin dëshmi se *status quo*—së në Ballkan po i afrohej fundi dhe nga kjo do të përfitonin edhe vetë shqiptarët.

Vjena pati kujdes të mos i prishte marrëdhëniet tradicionalisht të mira me shqiptarët. Ajo e shqetësuar për reagimet në Shqipëri për shkak të aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, kaloi në aksion diplomatik, duke u përpjekur përmes konsujve të saj në viset shqiptare t'u shpjegonte krerëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, se ajo nuk kishte bërë asgjë që e dëmtonte Shqipërinë. Diplomatët e saj, nga ana e tyre, duhej ta popullarizonin ndër shqiptarët idenë se shkakun i tërheqjes së trupave austro-hungareze nga sanxhaku i Jeni Pazarit (Tregut të Ri) ishte bërë në "*interes të tërësisë territoriale të tokave shqiptare*". Shkakun kryesor i tërheqjes së trupave austro-hungareze nga ky territor, ishte bërë me qëllim, siç theksonin diplomatët vjenazë, "*që të mos marrim asnjë pëllëmbë të një territori, i cili banohej prej shqiptarëve*" dhe në këtë mënyrë, vinin në dukje ata, Monarkia e Dyfishtë do të kontribuonte "*për zmadhimin e tokës që posedohet prej shqiptarëve*". Në udhëzimet që ministri i Jashtëm austro-hungarez, u dërgonte konsujve të tij në territoret shqiptare, kërkonte që ata t'u shpjegonin drejtuesve shqiptarë se territori që ishte braktisur nga trupat austro-hungareze, cilësohej

¹³⁷ Abdyli, Ramiz., *vep. e përm.*, f. 141.

¹³⁸ *По ату*, f. 134; Сенкевич, И. Г. 1959. *Освободительное движение Албанского народа в 1905-1912 гг.* Москва: Издательство Академии Наук СССР, с. 117-120.

prej Perandorisë Habsburge si “*territor shqiptar*”. Këtë hap të Vjenës, shqiptarët duhej ta kuptonin si veprim në interes të çështjes së tyre kombëtare. Më tej në udhëzim theksohej se Austro-Hungaria jo vetëm do të përkrahte integritetin e Shqipërisë, por do të pengonte çdo përpjekje që do të bëhej për copëtimin e saj¹³⁹. Theksohej gjithashtu se qeveria austro-hungareze kishte derdhur mjaft mjete në favor të çështjes shqiptare. Vjena ishte e interesuar për ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Në funksion të këtij synimi, konsullatat austro-hungareze në tokat shqiptare shpërndanë një manifest në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke. Në manifest vihej në dukje miqësia e mirë dhe tradicionale midis shqiptarëve dhe Perandorisë Austro-Hungareze, se kjo perandori kishte përcjellë prej kohësh ngjarjet në Shqipëri dhe kishte treguar një interesim të veçantë për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe¹⁴⁰. Ajo deklaronte se e konsideronte Sanxhakun tokë shqiptare dhe se ajo nuk do të lejonte që të tjerë shtete të rrëmbenin troje në dëm të Shqipërisë. Nëse do të mbahej ndonjë Konferencë, Austro-Hungaria do ta kundërshtonte ndarjen e Shqipërisë¹⁴¹. Aehrenthali i njoftonte përfaqësuesit e tij në Shqipëri “*se është krejt e huaj për ne të pretendojmë qoftë edhe një pëllëmbë toke shqiptare dhe se në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që të merret ndonjë vendim për copëtimin e Shqipërisë*”¹⁴². Nga sa më sipër mund të konstatojmë se qëllimi politikës ballkanike të qeverisë austro-hungareze, nuk ishte pushtimi i territoreve shqiptare, por pengimi i Serbisë për të siguruar dalje në det, nëpërmjet Bosnjës dhe Hercegovinës, me çka do

¹³⁹ Krah.: *AIH*, Vj. 18-7-753. Njoftim nr. 2604, 2603, 2607, 2608, 2609, 2610, 2611, 2612, 2613, i Ministrisë së Punëve të Jashtme për konsujt e saj: Kral në Shkodër, Dr. Ranzi në Janinë, Kraus në Vlorë, von Zambaur në Mitrovicë, Prohaska në Prizren, Lukes në Shkup, Johg në Manastir, Rappaport në Selanik dhe Pera në Stamboll. Vjenë, 3 dhjetor 1908; Abdyli, Ramiz, *vep. e përm.*, f. 140; Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, 323.

¹⁴⁰ Abdyli, Ramiz, *vep. e përm.*, f. 140.

¹⁴¹ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 323.

¹⁴² Prela, Zef. 1962. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912). Në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë). Tiranë, f. 142.

të pengohej shtrirja e sferës së ndikimit rus në pjesën Perëndimore të Gadishullit Ballkanik.

Në atë kohë Vjena ishte vetëm për një autonomi shqiptare, nën suazën e Stambollit, duke këshilluar nëpërmjet konsujve të saj, se krijimi i një shteti shqiptar, të ri, por shumë të brishtë, do të ishte pre e synimeve dhe veprimeve shoviniste të shteteve sllave, me udhëheqjen e Rusisë¹⁴³. Ajo nxiste dhe përkrahte zhvillimin arsimor të shqiptarëve dhe çdo përpjekje që bëhej për zhvillimin e tyre kulturor. Madje, qeveria austro-hungareze, nëpërmjet ambasadorit të saj në Stamboll, Pallaviçini, në vitin 1908, kërkoi nga Porta e Lartë “*të fuste mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore të viseve shqiptare*”¹⁴⁴. Me këto veprime, ajo siç mund të shihet, synonte të siguronte epërsinë në çështjen shqiptare, e cila po merrte rëndësi gjithnjë e më të madhe, sidomos midis dy rivalëve Vjenës dhe Romës.

Megjithatë, aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austro-Hungaria, shkaktoi reagime të ashpra në Stamboll. Si kundër-përgjigje ndaj këtij veprimi, pati zëra që kërkonin kufizimin e të drejtës së *Kultusprotektoratit** austro-hungarez në Shqipëri. Sipas

¹⁴³ Asllani, Uran. 2000. *Studentët shqiptarë në Austri dhe kontributi i tyre për shtetin shqiptar*. Tiranë: Ilar, f. 32-33.

¹⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i dytë, Rilindja Kombëtare, Vitet 30 të shek. XIX-1912*. 2002. Tiranë: Toena, f. 261, 387.

* *Kultusprotektorat*, nga gjuha gjermane: *Kult-besim* dhe *protektorat-mbrojtje*. Pra, *Kultusprotektorati* nënkuptonte mbrojtjen që i siguronte Perandoria Austro-Hungareze besimtarëve katolik të Perandorisë Osmane. Të drejtën e *Kultusprotektoratit* mbi popullsinë katolike shqiptare, Austro-Hungaria e siguroi në bazë të disa marrëveshjeve që nënshkroi me Perandorinë Osmane, siç ishin: pagja e Silvatorokut të vitit 1615, Traktati i Karllovacit (26 janar të 1699), Traktatin e Pozharevacit të 21 korrikut të vitit 1718 dhe të Beogradit të 18 shtatorit të 1739, si dhe në “*Letrat patente*” të lëshuara nga sulltani, sipas të cilave “*Austria trashëgoi nga Venediku të drejtën e mbrojtjes së Vendeve të Shenjta dhe të drejtën e paraqitjes së ipeshkëve katolikë të Rumelisë*”. Në këtë kuadër përfshihej edhe Shqipëria. Në bazë të këtyre marrëveshjeve, qeveria austriake (nga viti 1867 austro-hungareze), ushtronte të drejtën e protektoratit për sa i përket fesë katolike, kishës, priftërinjve dhe kuvendeve të tyre dhe kundrejt instituteve bamirëse. Nga viti 1837, Kuria Romake ia kalon perandorit të Austrisë

një telegrami sekret që i dërgohej Vjenës nga Selaniku, theksohej se delegatët e Komitetit Xhonturk kërkonin që Vjena të shfrytëzonte *Kultusprotektoratin*, “vetëm në çështje thjesht fetare”, në mënyrë që të mos cenonte sovranitetin e Perandorisë Osmane. Ky kufizim sipas tyre, do të ishte edhe njëfarë dëmshpërblimi për aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës¹⁴⁵.

Një fushë tjetër në të cilën qeveria vjeneze ndihmonte çështjen shqiptare ishte ajo zhvillimit të arsimit dhe të kulturës, ku bashkëpunimi i Austro-Hungarisë me shqiptarët tashmë kishte fituar një traditë gjysmëshekullore. Që nga viti 1861, Vjena kishte filluar me hapjen e shkollave të saj në territoret shqiptare, në të cilat mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe¹⁴⁶. Gjithashtu, ajo ndihmoi financiarisht botimin e teksteve shkollore, librave, gazetave në gjuhën shqipe; përkrahu financiarisht disa personalitete shqiptare të kohës; ndau bursa për nxënës dhe studentë shqiptarë, të cilët vijuan mësimet në shkollat e saj.

Megjithatë edhe në fillim të shek. XX, shqiptarët vazhdonin përballeshin edhe me mungesën e një alfabeti të njëjësuar për gjuhën shqipe. Përdorimi i shumë alfabeteve shkaktonte mjaft vështirësi për lexuesit shqiptarë; nxënësit e shkollave të ndryshme detyroheshin të mësonin sipas alfabetit me të cilin ishin shkruar tekstet, të cilat ishin siguruar nga shkolla. Këto vështirësi, i shtynë shumë intelektualë të kohës, të fillonin të mendonin rreth mundësisë së krijimit të një alfabeti unik, i cili do të përdorej nga të gjithë shqiptarët. Për arritjen e këtij qëllimi ishte e nevojshme, që të merreshin vesh

të drejtën e mbrojtjes së katolikëve shqiptarë, çka shënoi forcimin e ndikimit dhe të interesimit të Perandorisë Danubiane për Shqipërinë. [Për më tepër shih: Ramadani, Fehari. 2011. Fillimet e interesimit të Austrisë (Austro-Hungarisë) për çështjen shqiptare. Në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 40-2010. Prishtinë, f. 216-218].

¹⁴⁵ *AIH*, Vj. 18-13-1348. Telegram sekret, nr. 551 i agentit civil në Selanik, Rappaport, i cili nuk bëhet e qartë se kujt i drejtohej. Selanik, më 11 nëntor 1908.

¹⁴⁶ Për më tepër shih: Ramadani, Fehari. 2010. *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*. Tetovë: Arbëria Design, f. 25-30.

udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe sidomos disa nga ata që kishin përpiluar alfabetet e tyre, të cilët duhej të hiqnin dorë nga alfabetet ekzistuese, duke përkrahur njërin prej tyre ose të përpilonin një të ri, në mënyrë që të mos preknin ndjenjat e asnjërit grup, që përkrahnin alfabetet e ndryshme. Mundësia për t'u mbledhur udhëheqësit më të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duket se u krijua, në verën e vitit 1908, pas triumfit të revolucionit xhonturk, të cilët për sa kohë nuk e kishin konsoliduar pushtetin e tyre, u përpoqën të mos shkaktonin pakënaqësinë e popujve të nënshtuar të Perandorisë së tyre.

Ndryshimet politike që ndodhën në Stamboll, si rezultat i ngadhënjimit të revolucionit xhonturk, në vitin 1908, u pasqyruan edhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Shpallja e kushtetutës apo e Hyrietit (lirisë) – siç quhej në popull, u prit me entuziazëm të madh nga të gjithë popujt e shtypur të Perandorisë Osmane¹⁴⁷, pra edhe nga shqiptarët. Xhonturqit para se të merrnin pushtetin, vazhdimisht kishin deklaruar se ata ishin për respektimin e lirisë, të barazisë dhe të drejtësisë për të gjithë popujt e Perandorisë. Shqiptarët, si përkrahës të rëndësishëm të lëvizjes xhonturke¹⁴⁸ shpresuan se në rrethana të reja, kur turqit e rinj kishin marrë pushtetin, nuk do të hasnin në pengesa për sa i përket hapjes së shkollave e të botimeve në gjuhën shqipe, e sidomos të teksteve shkollore. Prandaj, disa muaj pas fitores së revolucionit, në nëntor të vitit 1908, në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Në Kongresi i Manastirit, i cili i zhvilloi punimet nga 14–22 nëntor 1908, morën pjesë rreth 50 delegatë (32 delegatë me të drejt vote dhe 18 të tjerë pa të drejt vote), të cilët përfaqësonin 26 qytete dhe

¹⁴⁷ Cana, Zekeria. 1982. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*. Tiranë: 8 Nëntori, f. 30; Horvat, Branko. 1988. *Kosovsko Pitanje*. Zagreb: Globus, s. 31.

¹⁴⁸ *AIH*, Vj. 19-8-838, Raport i konsullit von Kviatkowski, më 20 gusht 1909, mbi një bisedë me Fazil pashën dhe Fuad bej Toptanin; Buhberger, Karl. 1972. Vjetët e mija në Shqipëri. Në *Studime Historike*, Nr. 4 Tiranë, f. 144.

shoqëri të ndryshme brenda dhe jashtë atdheut¹⁴⁹. Në atë Kongres, i cili kishte karakter kulturor dhe rëndësi politike, u tubuan intelektualët shqiptarë¹⁵⁰, të cilët kishin për synim të përpilonin një alfabet unik, i cili do të përdorej nga të gjithë shqiptarët. Përveç seancave të hapura, që iu kushtuan çështjes së alfabetit, u mbajtën edhe seanca të fshehta, në të cilat u diskutuan rrethanat politike në Shqipëri. Për rrjedhojë, rezultuan 18 kërkesa që përafërsisht përkonin me kërkesat e mëparshme për autonominë e Shqipërisë¹⁵¹. Disa pjesëmarrës të Kongresit u ndihmuan financiarisht edhe nga qeveria austro-hungareze. Sipas, një urdhërese që Ministria e Jashtme austro-hungareze, i dërgonte konsullit të përgjithshëm të saj në Shkodër, në dhjetor 1908, e urdhëronte këtë të fundit, që t'i dërgonte Ministrisë dëftesat e Gjergj Fishtës, Dom Andrea (Ndre) Mjedës, Mati Logorecit dhe Selman Blloshmit, për ndihmat e mara nga ata prej Ministrisë së Jashtme, “*për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të tyre për në Kongresin shqiptar të Manastirit*”¹⁵². Më 7 janar 1909, Kral, i paraqiste Ministrisë së Jashtme dëftesat e Gjergj Fishtës (për marrjen e 315 frangave), të Andrea Mjedës (për marrjen e 345 frangave), të Mati Logorecit (për marrjen e 200 frangave) dhe të Selman Blloshmit (për marrjen e 340 frangave)¹⁵³. Sipas studiuesit, Robert Schwanke, konsulli i përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral, e dërgoi Selman Blloshmin me një mision sekret në Kongresin e Manastirit. Ai do të kishte për detyrë të përpiqej të sheshonte mosmarrëveshjet që ekzistonin midis përkrahësve të alfa-

¹⁴⁹ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 392; *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*. 2001. Prizren: Siprint, f. 149; Abdyli, Ramiz, *vep. e përm.*, f. 116; Vishko, Ali. 1992. *Kongreset e Alfabetit dhe të Shkollës Shqipe*. Shkup: Flaka e Vëllazërimit, f. 33-36.

¹⁵⁰ Abdyli, Ramiz, *vep. e përm.*, f. 128; Rexhepagiq, Jashar. 1970. *Zhvillimi i arësimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në teritorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*. Prishtinë, f. 211.

¹⁵¹ Abdyli, Ramiz, *vep. e përm.*, f. 125.

¹⁵² *AIH*, Vj. 18-8. Urdhëresë nr. 2886 e MPJ për konsullatën e përgjithshme në Shkodër. Vjenë, më 24 dhjetor 1908.

¹⁵³ *Po aty*, Vj. 19-30. Raport i konsullit të përgjithshëm në Shkodër, Kral, për MPJ. Shkodër, më 7 janar 1909.

beteve të ndryshme¹⁵⁴. Ndonëse, sipas studiuesit Zihni Haskajt, Austro-Hungaria financoi vetëm klerikët katolikë që morën pjesë në Kongres¹⁵⁵, nga të dhënat e mësipërme del se Ministria e Jashtme austro-hungareze ndihmoi, për atë qëllim edhe personaliteteve të cilët jo vetëm që nuk ishin klerikë, por për më tepër ishin mysliman. Qeveria e Vjenës ishte përkrahëse e hartimit të një alfabeti shqiptar, të bazuar në shkronja latine, prandaj nëpërmjet konsujve të saj, ajo bëri përpjekje të vazhdueshme që të ndihmonte në sheshimin e mosmarrëveshjeve midis atdhetarëve shqiptarë, përkrahës të alfabetëve të ndryshme.

Qeveria austro-hungareze prej kohësh kishte qenë e interesuar që shqiptarët të përcaktoheshin për përdorimin e një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe. Por, ajo nuk shprehu hapur preferencat e saj për njërin apo tjetrin alfabet. Ky qëndrim i Vjenës ishte i hershëm, që nga fundi i shek. XIX. Njëri ndër diplomatët më të njohur austro-hungarez, i cili kishte shërbyer në Shqipëri, konsulli Theodor Ippen*, në një shkresë që i drejtonte Ministrisë së tij të Punëve të Jashtme, më 20 prill 1899, ndër të tjera theksonte: “*Mbështetja jonë do t’i përkas atij alfabeti, i cili do të ketë përkrahësit më të shumtë, pra që do të ketë edhe shanset për të qenë alfabet zotërues*”¹⁵⁶.

Fitorja e Lëvizjes xhonturke mbi regjimin absolutist të sulltan Abdyl Hamidit II, si dhe goditjet e jashtme që pësoi qeveria xhonturke në

¹⁵⁴ Schwanke, Robert. December 1971. Roli i Austro-Hungarisë në Kongresin e Manastirit në vjetin 1908. Në *Perpjekja jone*- e përkohshme fetare e kulturore, vol. II, No. 3. New York, f. 101.

¹⁵⁵ Haskaj, Zihni. 1969. Roli reaksionar i klerit ndaj problemeve të alfabetit (1879-1912). Në *Studime Historike*, Nr. 1. Tiranë, f. 87.

* Më 27 shkurt 1897, Theodor Anton Ippen mori përsipër drejtimin e Konsullatës së Përgjithshme në Shkodër, duke iu përkushtuar me zell kësaj detyre. Atë detyrë e ushtroi deri në vitin 1904, me përjashtim të periudhës verë-tetor 1902, kur u largua për kurim. Gjatë asaj periudhe u zëvendësua nga zëvendës-konsulli von Bornemisza. Gjatë Konferencës së Ambasadorëve 1912-1913, Ippen shërbeu si këshilltar i ambasadorit austro-hungarez në Londër, kontit Mensdorff-Pouilly. (Wernike, Annelise. 2012. *Teodor Ippen dhe Shqipëria në Fokusin e Perandorisë Austrohungareze*. Tiranë: Plejad, f. 12-13, 17).

¹⁵⁶ Wernike, Annelise, *vep. e përm.*, f. 69.

tetor të vitit 1908, u reflektuan edhe në territoret shqiptare. Pasi morën pushtetin xhonturqit ishin të detyruar t'u njihnin disa të drejta popujve të nënshtruar, të cilët kishin përkrahur revolucionin e korrikut. Nëse qeveria e re xhonturke do të kishte shpalosur që në fillim politikën e saj osmaniste, ishte e kuptueshme që ata do t'i kishin kthyer në armiq bashkëpunëtorët e revolucionit. Një faktor tjetër që ndikoi në politikën "*liberale*" të pushtetarëve të rinj ishin edhe ngjarjet e jashtme. Ende pa e konsoliduar mirë pushtetin e tyre, xhonturqit u përballën me dy ngjarje të disfavorshme në politikën e jashtme: shpalljen e pavarësisë së plotë të Bullgarisë dhe aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Këto zhvillime politike, të brendshme dhe të jashtme e detyruan qeverinë e re të Stambollit që të ishte më e kujdesshme në raportet e saj me lëvizjet kombëtare të popujve të nënshtruar, në mënyrë që të mos i kthenin këto popuj në kundërshtarë të regjimit të tyre. Fillimisht qeveria e re xhonturke, e shtrenguar nga ngjarjet e mësipërme, lejoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe.

R e z y m e

Raportet e popullit shqiptar me Perandorinë Austro-Hungareze gjatë muajve tetor-nëntor 1908, karakterizohet nga dy ngjarje kryesore. E para ishte ajo e aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga qeveria vjeneze dhe e dyta mbajtja e Kongresit të Alfabetit në Manastir dhe interesimit të shtetit danubian për arritjen e një konsensusi midis intelektualëve shqiptarë të kohës, për përcaktimin e tyre për një alfabet unik për gjuhën shqipe.

Aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës shkaktoi pakënaqësi të madhe brenda Perandorisë Osmane, e cila zhvilloi propagandë të dendur ndër shqiptarët myslimanë për të bojkotuar mallrat austro-hungareze, në shenjë revolte ndaj këtij veprimi të qeverisë vjeneze. Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve osmane, lëvizja kundër bojkotimit të mallrave austro-hungareze, nuk pati jehonë të gjerë në territoret shqiptare. Si udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare

Shqiptare ashtu edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme austro-hungareze, nuk dëshironin që t'i prishnin marrëdhëniet tradicionale të mira midis tyre, prandaj të dyja palët bënë përpjekje që t'i tejkalonin mosmarrëveshjet që lindën, pas aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Pas sqarimeve që dha qeveria vjeneze se ajo nuk do të pushtonte territore shqiptare dhe se ajo kishte tërhequr trupat e saj ushtarake nga territoret e sanxhakut të Jeni Pazarit (Tregut të Ri), pasi ato i konsideronte si toka shqiptare kjo gjendje për disa muaj u tejkalua, fillimisht me rifillimin e tregtimit të mallrave midis tregtarëve shqiptarë dhe Austro-Hungarisë.

Çështja tjetër që ngjalli interes të shtuar të diplomatëve austro-hungarez, të cilët shërbenin në territoret shqiptare gjatë asaj kohe ishte edhe ajo e mbajtjes së Kongresit të Alfabetit në Manastir. Konsujt e informonin në vazhdimësi Ministrinë e tyre të Punëve të Jashtme për përpjekjet e personaliteteve të shquara kombëtare të kohës për përgatitjet dhe mbajtjen e Kongresit. Duke njohur qëndrimet e ndryshme që ekzistonin atë kohë midis intelektualëve, në lidhje me çështjen e zgjedhjes së alfabetit, Ministria e Punëve të Jashtme dërgoi me mision disa personalitete të shquara, të cilët do të kishin për detyrë të angazhoheshin për sheshimin e mosmarrëveshjeve të mundshme midis pjesëmarrësve.

MEMLI KRASNIQI

Instituti Albanologjik i Kosovës

DY RAPORTE TË SHOQËRISË BIBLIKE BRITANIKE MBI ENVER PASHËN DHE MID'HAT FRASHËRIN

Në raportet e Shoqërisë Biblike Britanike vëmendje i kushtoj, përpos punës dhe vështirësive në shpërndarjen e Biblave të botuara në shumë gjuhë, edhe ndryshimeve rrënjësore shoqërore. Kështu në raportin e saj të titulluar “Turqia e re”, do të bëhej fjalë për Revolucionin Xhonturk të vitit 1908 në Perandorinë Osmane, e cila shumëherë gabimisht njësohej me Turqinë.

Në këtë raport të botuar në revistën “The Book Above Every Book”, theksohej se viti 1908 i kishte ofruar botës një shembull të ndryshimeve, origjina e së cilave buronte nga ndikimet e përkthimeve dhe të botimeve të Shkrimeve të Shenjta. Në vazhdim, theksohej se të gjithë ata që e njihnin “Turqinë”, në të vërtetë Perandorinë Osmane, e pranonin se çfarë roli të madh kishte luajtur Bibla e përkthyer dhe e botuar në gjuhën e folur të vendit, pra në “turqisht”, më saktësisht në gjuhën osmane, për të krijuar “Turqinë e re”, me të cilën nënkuptohej Perandoria Osmane e pas revolucionit të vitit 1908.

Gjithashtu në raport përmenden edhe misionarët amerikanë, të cilët për shumë vite kishin punuar pothuajse në çdo provincë dhe vend nën zotërimin e Sulltanit dhe të cilët vetes i kishin caktuar si synim primar predikimin dhe shpërndarjen e Librit të Zotit. Në shkollat dhe kolegjet e tyre, theksohej, se misionarët amerikanë kishin rreth 40,000 nxënës të angazhuar në baza ditore për studimin sistematik të Biblës. Sigurisht, vazhdonte shkrimi në këtë revistë, është një fakt me rëndësi, kur Enver beu (me prejardhje nga qyteti i Manastirit,

nëna Aishe —shqiptare; babai—turk gagauz), lideri guximtar shqiptar, i cili rrezikoi gjithçka në interes të qeverisë kushtetuese në “Turqi”, pra në Perandorinë Osmane, do të deklaronte në Smirna (Izmir), jo shumë muaj pas shpalljes së kushtetutës, se ai dhe kolegët e tij nuk do të kishin kurrë guximin që t’i bënin hapat që tanimë i kishin bërë për krijimin e një qeverie të drejtë dhe të qëndrueshme, pa u mbështetur në themelet e shtruara nga shkollat e Misionit Amerikan gjatë pesëdhjetë viteve të fundit. Pra, mbrapa fuqisë së këtyre shkollave amerikane ka qëndruar Bibla e përkthyer dhe e botuar në gjuhën amtare, dhe se bota mahnitej kur e shihte Partinë e Re Turke duke dalë me parullat “Barazi” dhe “Vëllazëri”. Në raport theksohej se Islami kurrë nuk e kishte mbështetur asnjërin nga këto vlera, ndonëse Sheik—Ul—Islami, prijësi fetar i myslimanëve, ishte shprehur rishtazi se qeveria kushtetuese është e sanksionuar në Kur’an; se të krishterët, të cilët me të vërtetë besojnë në Zot, janë vëllezër të myslimanëve dhe se edhe ata do të kenë një vend në parajsë; se është detyrë e qeverisë muhamedane që t’i mbrojë të krishterët dhe hebrenjtë mu sikurse i mbron myslimanët dhe se, para qeverisë dhe para Zotit, të gjithë janë të barabartë.¹⁵⁷

Ndërsa, në raportin tjetër, të botuar në revistën “More Golden Than Gold”, bëhej fjalë për Mid’hat Frashërin, më saktësisht për Mit’hat bej Frashërin, siç theksohej në këtë botim. Duke e përshkruar zgjimin e patriotizmit tek shqiptarët, Z. H.N. Brailsford,¹⁵⁸ gazetari majtist britanik, theksonte se vetëm puna e

¹⁵⁷ Memli Krasniqi, Armend Mehmeti, përgatitës, *Dokumente të Shoqërisë Biblike Britanike dhe për të huajt* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016), 127.

¹⁵⁸ Henry Noel Brailford (1873-1958), gazetar i njohur britanik, i cili, së bashku me Edith Durham, ishte udhëheqës i Misionit të Ndihmave Britanike në zonën e njohur si “Maqedoni” (zyrtarisht në Perandorinë Osmane këto territore ishin të njohura si: Vilajeti i Kosovës, i Manastirit dhe i Selanikut- sqarim Memli Krasniqi) gjatë vitit 1903. Më 1906 në Londër, Henry Noel Brailford, do të botonte librin “*Macedonia: its Races and their Future*”, në të cilën flitet shumë edhe për shqiptarët. https://en.wikipedia.org/wiki/H._N._Brailsford; http://www.albanianhistory.net/1903_Brailsford/index.html, Qasja më 24 nëntor 2018.

Shoqërisë Biblike Britanike kishte bërë që këta malësorë të ndarë në fise, përkundër armiqësive dhe xhelozisë mes tyre, të fillonin të kërkonin një lloj bashkimi, të cilin ata e kishin gjetur në gjuhën e tyre të përbashkët. Fryma e re, vazhdonte gazetari britanik, kishte filluar me kultin e gjuhës shqipe, e cila ndihmoi në transformimin e mënyrës së të menduarit të njerëzve. Në mesin e pionierëve të vërtetë të kësaj lëvizjeje, z. Brailsford, do të veçonte kolporterët e Shoqërisë Biblike. Vetë shqiptarët me falënderim e pranojnë se ishte puna e gjatë dhe e mundimshme e këtij institucioni që për pesëdhjetë vite është përpjekur t'i sjellë atyre, në gjuhën amtare, njohuritë mbi Fjalën e Zotit. Ata, thekson z. Brailsford, e kanë parasysh se fryte të kësaj pune janë të gjitha arritjet progresive morale dhe intelektuale që i posedojnë shqiptarët tani.

Revista e Shoqërisë Biblike, kishte publikuar edhe artikuj specialë nga Mit'hat bej Frashëri, për të cilin shkruhej se ai ishte një poet kombëtar dhe redaktor i njëres prej gazetave më të lexuara në Shqipëri, pseudonimi i të cilit, Lumo Skendo, nënkuptonte një emër të njohur në atdheun e tij. Në këtë shkrim, potenciohej se Mit'hat Frashëri ishte më i shquari prej grupit të vogël të shkrimtarëve shqiptarë, zemra dhe shpirti i të cilëve qëndronte në detyrën e çuarjes së vendit të tyre drejt qytetërimit, edukimit dhe progresit paqësor. Në raport, theksohej se ndonëse ai ishte mysliman, Lumo Skendo, nënvizonte: "Para së gjithash, ndihem i detyruar që të ofroj një shenjë të vogël mirënjohjeje për Shoqërinë Biblike Britanike për shërbimet që ajo ia bëri vendit dhe letërsisë sonë, përmes përkthimeve të Shkrimeve të Shenjta që ajo i bëri në gjuhën shqipe. Është, në fakt, e pamundur të flitet për gjuhën dhe letërsinë shqiptare pa i kujtuar aktivitetet dhe përkushtimin e atyre njerëzve që për një kohë të gjatë dhe duke u përballur me vështirësi të shumta, kanë punuar në këtë çështje fisnike. Versionet në gjuhën shqipe të librave të caktuar, të Dhiatës së Vjetër dhe të Re në gegërishte dhe toskërishte, të cilat për aq shumë vite formuan po-

thua j gjithë literaturën e shtypur të Shqipërisë, bënë që Shoqëria Biblike Britanike të nderohet dhe të respektohet nga të gjithë patriotët shqiptarë, qofshin ata myslimanë apo të krishterë”.¹⁵⁹

¹⁵⁹ Memli Krasniqi, Armend Mehmeti, përgatitës, *Dokumente të Shoqërisë Biblike Britanike dhe për të huajt* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016), 129.

ENTELE KOMNINO

Studiuese, Tiranë

SHQIPJA, GJUHA RETORIKE

110 vjet më parë shqiptarët vendosën ta shkruajnë gjuhën e tyre ‘një tingull, një germë’. Kodifikimi, i dukur gjenial si prej kushteve praktike të arritjes së tij ashtu edhe nga përputhja me natyrën gjuhësore unike të sistemit të shqipes, e bën edhe më fenomenal veprën paravajtëse të firmëtarëve të gjuhës sonë. Shkrimi i shqipes rezulton maja e një ajsbergu gjuhësor i mbetur mbi ujë si për të shtuar misterin e akullit që e ngrin ujin edhe në ajër edhe në ujë vetë. Dukuria që ne paraqesim sot, sjell pikërisht një përbërje të tillë, kur ‘shqip’ duket të ketë treguar edhe gjuhën e shqiptarëve edhe oratorinë, duke e bërë të kuptohet oratori pas shqiptarit.

Deri në fillim të viteve 1600 priftërinjtë dhe çdo shqiptar që shkonte në kishë, e dinin se kur thuhej ‘shqip’, mund të riprodhoheshin me gojë formulën e shërbimit kishtar. Në mundësinë ‘shqip ose me letere’, Matzinger përmbyll me bindje pak vite më parë, se lexema ‘shqip’ ka treguar tek Buzuku dhe Budi kuptimin ‘qartë, dëgjueshëm, me zë të plotë dhe kuptueshëm’¹⁶⁰. Lexema ‘shqip’ ka treguar gjuhën etnike duke filluar nga Bogdani¹⁶¹. Personi i thirrur shqiptar, pra që fliste ‘shqip’, ishte ai që fliste rrjedhshëm e qartë, përmendësh dhe kuptohej si orator¹⁶², por Shuteriqi¹⁶³ citon edhe mbienmrin ‘i pa shqip’ si ‘pa moral’ në diasporën e hershme dhe më e avancuar paraqitet tek Mandala¹⁶⁴ kur ‘shqip’ përcakton statusin

¹⁶⁰ Matzinger, link <http://www.zeitschrift-fuer-balkanologie.de/index.php/zfb/article/view/337/334>,

¹⁶¹ Si më lart

¹⁶² Da Lecce i cituar si më lart

¹⁶³ Si më lart

¹⁶⁴ Si më lart

dhe rolin shoqëror që luajnë individët në gjirin e bashkësisë shoqërore ku bëjnë pjesë.

Ndalimi ynë tek fenomeni që thirrej ‘shqip’, është një pyetje dyfishe për shkak të natyrës së tij:

1. A është ‘shqip’ një gjuhë me retorikë të pashkruar (gjuhëzuar)?
2. Çfarë është retorika si gjuhë e një popullsie?

E dukur edhe pa prova shkrini për mijëvjeçarë, si fenomen dhe si emërtesë, ‘shqip’, nuk i ka kthyer sytë modernë nga retorika, e cila në vështrim të parë dukej madje inekzistente në letrat e shqipes. Shembulli i vërtetuar nuk na shtyn të përkufizojmë thjeshtë nëse ‘shqip’ tregonte specifikisht gjuhën e lutjes e për rrjedhojë riprodhimi duhej të ishte po i tillë, por se çfarë ka prapa leksemës ‘shqip’ për gjuhën që thirret sot me këtë emër dhe retorikën që ka shpërguar gjithë njerëzimin në librat e parë të saj. Në fakt,

I. Fenomeni i një gjuhe të veçantë si përdorim retorik nuk është i përshkruar

Mishërimi pa rregulla të artikuluar i retorikës në një gjuhë të veçantë nuk tregohet dot as për gjuhët me të cilat lexohen së pari rregullat e retorikës. Automatikisht, përdorimi i ‘shqip’ edhe si retorikë, do të përbënte një gjetje globale me detyrimin për të kërkuar shtresimet e funksioneve retorike në njësitë gjuhësore të shqipes. Sot, është njëri nga dy kuptimet e fjalës ‘shqip’¹⁶⁵ dhe kuptimi i tretë i fjalës ‘retorikë’¹⁶⁶, që në kontekstin historik të leksemës

¹⁶⁵ Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984, fq. 1188

¹⁶⁶ Link, <https://www.merriam-webster.com/dictionary/language>, Definition of rhetoric

1 : the art of speaking or writing effectively: such as

a : the study of principles and rules of composition formulated by critics of ancient times

b : the study of writing or speaking as a means of communication or persuasion

2a : skill in the effective use of speech

‘shqip’ e vendos sistemin gjuhësor që thirret me ‘shqip’ në një rrafsh kapacitetesh me korpusin e retorikës. Por përveç përshkrimit si fjalë, gjetja e një kohe kur ‘shqip’ ishte alternativë e ‘me leterë’, zbërthen shumë fenomene.

1. Riprodhimi, si proces qoftë edhe retorik është treguar me të njëjtën leksemë që tregohet edhe gjuha e popullsisë sot
2. ‘Shqip ose me leter’, që i përgjigjet sot ‘me gojë/ me shkrim’, ka qartësisht gjurmët e një kalimi me procesin e elokuencës.
3. Nëse riprodhimi në këtë rast është oratorik, ai paraqitet pa rregulla më vete (teknika e mnenes), por përmes të folurës së një sistemi gjuhësor
4. Kur kjo ende ndodhte me shqipen, rregullat e retorikës antike kishin bërë më së paku një jetë 2200 vjeçare si shkencë më vete duke mbërritur deri në ditët tona e përkufizuar vetëm si e tillë ose përdorim mendor i mësuar. Me një bilanc të thjeshtuar fenomenesh, në 2500 vjet retorikë, shqip ka të paktën 2200 vjet plazmim retoriko-gjuhësor.
5. Shqip lejohet të kuptohet si sistemi komunikativ, që e përdorte oratorinë edhe pa i patur rregullat retorike më vete
6. Kur popullsisë që e njihte këtë praktikë, iu desh të tregonte individualitetin e vet, e thirri gjuhën amtare njëlloj si oratoria me të cilën përsëriste formulat kishtarë¹⁶⁷
7. Sistemi gjuhësor që thirret sot ‘shqip’, ka njësi e funksione të përshkruara nga rregullat e retorikës
8. Oratoria dëshmohet të ketë qenë përbërës i ‘shqip’ si sistem komunikimi, ndërkohë që, që prej shkruajtjes së rregullave të të folurit, ajo ka qenë pjesë e retorikës së zbatuar

b : a type or mode of language or speech also : insincere or grandiloquent language

3 : verbal communication : discourse

¹⁶⁷ Elsi dëshmon nga autorë të tjerë se shqiptarët e përdornin pak latinishten në praktikat e tyre fetare

9. Formulatat që përsëriteshin me këtë praktikë tregonin që e mbajtura mend dhe riprodhimi i përshkruar në teknikën e mnenes së retorikës përputheshin.

Nëse e folura është një nga kuptimet sipas gjetjes së retorikës sot, pyetja e njerëzimit do të ishte:

II. Çfarë është gjuha që e mban të folurën (oratorinë) si një nga përdorimet e sistemit?

Kodi i shqipes sa më lart, sistemi që duket se nuk ka patur nevojë t'i shpjegojë më vete rregullat e të folurit dhe shkrimit, pra të çkodi-fikohet për t'u shkruar më tej, i ka mbartur gjuhësisht rregullat nga fillime që nuk dëshmojnë dot, por të gjendshme sot. Mbijetesa pas ndalimit 300 vjeçar na jep sot një argument shkencor për nga natyra e shqipes: ajo u tregua e paprekshme nga ndalimi i shkrimit dhe zhvlefësoi praktikatat e mbajtura të sofistikuara të administratave me gjuhë të shkruar, që u sollën si antimaterie gjuhësore, ushtruar me dekrete luftarake kundër substancave mendore dhe moshuar e vdekur si njerëzit që e prodhonin.

Shpjegimi i praktikës që një tekst mund të riprodhohej 'shqip' (përmendësh) ose 'me letere' (pra duke lexuar), pohon automatikisht shumë pikëpyetje të gjuhës që nuk ia ka 'besuar' kapacitetin stilistik përshkrimit të rregullave, ose nuk ka patur nevojë ta 'përkthejë' këtë kapacitet për ta kuptuar e mësuar. Në mënyrë shteruese për gjuhën e shqiptarit Fan Noli, ne kemi konstatuar vite më parë se pikërisht një rregull i përshkruar nga retorika për ndërtimin e hyrjes së bisedës (proemium) ishte njësi e stabilizuar gjuhësore siç e dëshmonte Fatmir Agalliu për 'dhanoren etike' të Fan Nolit¹⁶⁸.

Terreni i provave unike që ofron shqipja përkundrejt fenomenit ndeshet edhe tek një historik më i gjerë i fjalës. Faik Konica

¹⁶⁸ Përkime retorike në letrat e shqipes / Entela Komnino ne Buletin shkencor, 57 (2007)

përshtkruan lidhjen me ‘shqipoj’ që ‘thuhet se do të thotë **kuptoj**. Shqipëria, pra, do të thoshte disi Kuptimësia, vendi ku e kuptojnë njëri-tjetrin¹⁶⁹. Të njëjtën gjë ka gjetur edhe Hahn¹⁷⁰, duke shtuar tek kuptini i ‘shqiptar’ edhe ‘ai që kupton. Ky është cilësimi i tretë që dëshmohet me SHQIP pas **gjuhës etnike, asaj retorike, por një-het edhe si artikulum/shqiptoj**, ndërkohë që ndeshet edhe si **përkthim/shqipëroj**.

Në vijë me kuptimin popullor masiv për shqiponjën, Hahn dallon tre kapacitete të shqip/shqiptar sipas rrënjës shqip:

1. **Shkop**, sipas së cilës beson të ketë gjetur Qytetin dardan Shkopoi ose shkopion, të cilin e ka përmendur edhe Ana Komnena me emrin e sotëm Shkopia
2. **Shkrepije**, shkëlqim
3. **Skeptër**, mbajtësi i rrufeve.

Hahn përfundon se me fjalën që e tregon gjuhën, lidhet shqiponja, mbajtësi i skeptrit të Zeusit pelasgjik dhe ulet mbi të. Hahn citon Plutarkun që tregon se Pirro ‘kthehet me bujë dhe krenari në shtëpi, ku epirotët i dhanë emrin e tyre të shqiponjës¹⁷¹.

Arsyetimi gjuhësor i Muellerit gjen poetët që e krahasuan emrin me fjalë të ndryshme greke për çomange ose rrufë¹⁷², duke iu referuar

¹⁶⁹ Konica, Faik, Vepra 2, Rilindja 1997, fq. 154 ‘Kjo është njësoj sikur Anglia të quhej Yes-Land. Por pas së gjithash, përse jo? Kjo do të ishte një presedencë e lavdishme’.

¹⁷⁰ Hahn, Albanesisches Studien, <https://archive.org/details/ahy9953.0001.001.umich.edu/page/n249>,

¹⁷¹ Hahn, si më lart, Prej jush unë jam bërë një shqiponjë, dhe nuk kish si të ndodhte ndryshe përsa kohë përmes armëve tuaja lëkundësia (rritesha) mbi krahë të shpejtë’

¹⁷² Scipio, was originally a nickname meaning „staff, scepter” (as a sign of authority), but lost its nickname quality when it became inherited as a means to identify a sub-branch within the larger Cornelius clan; the last, Africanus, is the only equivalent of a nickname, Old Norse Nicknames Paul Peterson, link <https://skemman.is/bitstream/1946/12799/1/Old%20Norse%20Nicknames.pdf>,

fitoreve Scipionike¹⁷³, por edhe shkollën scipionike në Romë¹⁷⁴, kur ‘qindra njerëz mund të kenë shkruar me gramatikën dhe fjalorin e gjuhës Etruske, Oscane, apo Umbre’. Kultura etruske në Romë, nga një fenomen i mbajtur përgjithësisht në zonën e themeluesve të retorikës Korax dhe Teisios, bëhet e vendosshme edhe me fjalën e vjetër etruske, ‘etrurian’¹⁷⁵, emërtimi i hershëm i Toskanës së sotme, në një korrelacion mundësie shpjegimi me organin e të menduarit në shqip. Gati njëlloj siç mund të mendosh se pse anglezët e thërrasin sot të vërtetën ‘true’¹⁷⁶ në një linjë me ‘kuptimin’ e Konicës për ‘shqipoj’. Një dukje historike e ‘true’ me ‘trieve’/ ‘tri vë’ (shqip) do të lidhej me fenomenin e trinitetit që në vazhdim të shpjegimit tonë më parë gjendet tek fjala ndërkom-bëtare ‘Univers’¹⁷⁷. Fabula e mbetur bashkë me fjalët ‘vers’/‘vjershtë’ për poezinë, nga ku ‘Krishti poet’ bën sens trupëzimi, përmbahet e ruajtur me elementin ‘UNË’ edhe tek ‘triune’ që duket si ‘tre në një’, ashtu si dhe formimi tjetër në shqip për universin ‘gjithë/si’ e marrshme dhe si një e tërë, por dhe ‘gjithë sy’ ose ‘sy i gjithë’. Substanca e treguar si fillesë e UNË-it ose me SY, në variantin ‘tre unë’(UNË, VË, VETEN/sy), ndan tre gjendje substance (kujto

¹⁷³ Title: Chips from a German Workshop - Volume IV, Essays chiefly on the Science of Language, Author: Max Müller, Release Date: October 6, 2009 [EBook #30192], Character set encoding: ISO-8859-, <https://www.gutenberg.org/files/30192/30192-8.txt>

¹⁷⁴ prej nga citon fakte të tezës së tij se ‘greqishtja e latinishtja janë po aq motra sa dhe italishtja e frëngjishtja’

¹⁷⁵ **Etruscan (n.)** 1706, from Latin *Etruscus* "an Etruscan," from *Etruria*, ancient name of Tuscany (see **Tuscan**); of uncertain origin but containing an element that might mean "water" (see **Basque**) and which could be a reference to the rivers in the region.

¹⁷⁶ https://www.etymonline.com/word/true#etymonline_v_17889, **true (adj.)** Old English *triewe* (West Saxon), *treowe* (Mercian) "faithful, trustworthy, honest, steady in adhering to promises, friends, etc.," from Proto-Germanic **treuwaz* "having or characterized by good faith" (source also of Old Frisian *triuwi*, Dutch *getrouw*, Old High German *gatriuwu*, German *treu*, Old Norse *tryggr*, Danish *tryg*, Gothic *triggws* "faithful, trusty"), from PIE **drew-o-*, a suffixed form of the root **deru-* "be firm, solid, steadfast."

¹⁷⁷ Komnino, Entela, ‘E vërteta për Nolin’, Tiranë, 2017,

Aristotelin që mënyra-‘vë’ është më substancë se lloji), sa të figurueshme për proceset e krijimit dhe ekzistencës, aq dhe të pamundur për t’u rrokur nga syri dhe arsyeja njerëzore, mbi përpjekjet për të cilat kanë dalë në fakt formulat e kodet. Në kuptimin e filtrit mendor lidhet me thelbin e funksionimit të trurit: verifikimin përmes tri procesesh siç gjendet thelbi retoriko-gjuhësor tek fjala ligjërim.

Anglezët e hershëm e kanë përdorur ‘scip’ për të treguar anijen (ship)¹⁷⁸, por drejtuesin e anijes e trashëgojnë nga scip¹⁷⁹. Rrënja indoeuropiane ‘skei’, që shpesh lidhet e kryqëzuar në shpjegime me formimet e ‘ship’, nëse do të ndiqnim rrugëtimin shqip, do të ishte ‘shqit’ (ndaj), por edhe rrëshqit (si anija në ujë). Në një marrëdhënie të ‘shqit’ dhe ‘kuptoj’, ky kryqëzim –ndaj/kuptoj– i shpjeguar vetëm tingëllisht në anglisht, në shqip do të ushqente d.p.d. rrugëtimin kuptimor të shqipes si mekanizëm, pra njeti që shqit, sqaron, por edhe transporton e transportohet si gjuhë, e, përmes gjuhës, edhe kuptimi. Vetëm kështu do të mund të shpjegohej qendrueshëm përdorimi i treguar i ‘ship edhe si fjalëformues nga rrënja ‘scip’, duke kuptuar sqarimin, por edhe ndarjen bashkë me gjendjen. Dëshmimi i kuptimeve që kemi arsye t’i besojmë se pranëvendosen me kuptimet e leksemës ‘shqip’, **adresojnë provat që ka lënë në gjuhë vetë fjala që lidhet me kapacitetet retorike, duke dëshmuar ndaras edhe kuptimin e përkthimin.** Por ajo që i vë vulën çudive, qoftë edhe shkencore, është përkthimi në anglishten e

¹⁷⁸ ship (n.) Old English scip "ship, boat," from Proto-Germanic *skipa- (source also of Old Norse, Old Saxon, Old Frisian, Gothic skip, Danish skib, Swedish skepp, Middle Dutch scip, Dutch schip, Old High German skif, German Schiff), "Germanic noun of obscure origin" [Watkins].link, https://www.etymonline.com/word/ship#etymonline_v_23408,

¹⁷⁹ skipper (n.1) "captain or master of a ship," late 14c., from Middle Dutch skipper, from scip (see ship (n.)). Compare English shipper, used from late 15c. to 17c. in sense "skipper." Transferred sense of "captain of a sporting team" is from 1830.link, <https://www.etymonline.com/word/skipper>,

vjetër i krijuesit me *scieppan*¹⁸⁰. Duke mos u marrë në këtë moment me këtë çudi dhe 'pse?'—në e anglishtes që e ka përkthyer dikur 'Creator'—in me fjalë me rrënjën 'sciep', po e mbyllim argumentin parashtrues të domethënies në kohë të faktorit 'SHQIP': si fenomen dhe fjalë 'SHQIP' vërtetohet të vendoset në pyetjet e mëtejshme;

1. A tregon 'shqip' se gjuha e një popullsie mund të gjendet edhe në variantin si retorike?
dhe më tej;
2. A është gjuha retorike substanca primare gjuhësore afër proceseve formatuese të mendimit?
prej nga do të dilte;
3. A është shqipja substancë primare?

III. Gjuha retorike

Fenomeni me emrin e përcaktuar të një popullsie retorësh në Mesdhe sipas gjuhës retorike¹⁸¹, nuk ka dyshim që e dëshmon retorikën edhe si gjuhë dhe kjo gjuhë sot është shqip. Një barazim i thjeshtuar do të ishte: shqipja është 'gjuha retorike' dhe anasjelltas gjuha retorike shfaqet tek shqipja. Arsyetimi mbështetës për këtë, i nisur nga ekzistenca e retorikës si gjuhë, e bën retorikën e rregullave të shkruara, manual përdorimi të dalë nga deshifrimi i **retorikës natyrore**. Kjo e fundit, që duket si një kod i papërkufizueshëm për aparatin njerëzor, m'u bë e përkapshme në interpretimin e përkthi-

¹⁸⁰ **creator (n.)** c. 1300, "the Supreme Being, God considered as the creator of the universe" (also "the communion elements; a crucifix"), from Anglo-French *creatour*, Old French *creator* (12c., academic and liturgical, alongside popular *creere*, Modern French *créateur*), from Latin *creator* "creator, author, founder," from *creatus* (see **create**). Translated in Old English as *scieppend* (from verb *scieppan*; see **shape**(v.)). Not generally capitalized until KJV. General meaning "one who creates" in any sense is from 1570s. Fem. form *creatress* is from 1580s (Spenser); *creatix* from 1590s. Link, https://www.etymonline.com/word/creator#etymonline_v_29035,

¹⁸¹ Da lenne sipas Matzinger, si më lart

mit të Ungjillit të Shën Mateut nga Fan Noli, kur e quan 'Krishti, poeti i Nazaretit'. Sipas tij, ritmi i përdorur për memorje ka qenë qëllim dhe praktikë për t'u riprodhuar thjeshtë nga dishepujt, megjithëse sot e gjejmë të përshkruar si një stilistik. Me këtë nuk dua t'ju tregoj se prania e variantit 'scieppan' në shpjegimet e 'Creator'—it nuk është më e habitshme, se sa të ndërtoj në parim mundësinë për të përkufizuar fenomenin më konkret që na është dhënë ndonjëherë për substancën abstrakte të hartimit dhe paraqitjes së mendimit të shfaqur si retorikë përmes një gjuhe. Duke vërtetuar gjetjen e retorikës në gjendje gjuhe si emërtesë dhe kuptime funksionale, 'shqip' krijon një situatë të re në rrafshet e zbërthyeshme të komunikimit. Gjuha retorike si shumatore komplekse gjuhë etnike + rregullat e retorikës duket të jetë një gjendje e hershme e gjuhës. Por plazmimi retorik i komunikimit përmes një gjuhe amtare, në këtë rast i shqipes, do të ishte gjendja më konkrete e arritur deri tani e këtij kapaciteti të përdorur, e të pakapshëm në mekanizmat e krijimit. Në fakt edhe për disa fjalë të shqipes, koncepti si ai i përcjelljes së kulturave përmes rapsodëve të quajtur bardë¹⁸²

¹⁸²bard (n.) "ancient Celtic minstrel-poet," mid-15c., from Scottish, from Old Celtic bardos "poet, singer," from Celtic *bardo-, possibly from PIE *gwredho- "he who makes praises," suffixed form of root *gwere- (2) "to favor." In historical times, a term of great respect among the Welsh, but one of contempt among the Scots (who considered them itinerant troublemakers). Subsequently idealized by Scott in the more ancient sense of "lyric poet, singer." Poetic use of the word in English is from Greek bardos, Latin bardus, both from Gaulish. *gwere- (1) gwerə-, Proto-Indo-European root meaning "heavy." It forms all or part of: aggravate; aggravation; aggrieve; bar (n.4) "unit of pressure;" bariatric; baritone; barium; barometer; blitzkrieg; brig; brigade; brigand; brigantine; brio; brut; brute; charivari; gravamen; grave (adj.); gravid; gravimeter; gravitate; gravity; grief; grieve; kriegspiel; guru; hyperbaric; isobar; quern; sitzkrieg. It is the hypothetical source of/evidence for its existence is provided by: Sanskrit guruh "heavy, weighty, venerable;" Greek baros "weight," barys "heavy in weight," often with the notion of "strength, force;" Latin gravis, "heavy, ponderous, burdensome, loaded; pregnant;" Old English cweorn "quern;" Gothic kaurus "heavy;" Lettish gruts "heavy." *gwere- (2) gwerə-, Proto-Indo-European root meaning "to favor." It forms all or part of: agree; bard (n.); congratulate; congratulation; disgrace; grace; gracious; grateful; gratify; gratis; gratitude; gratuitous; gratuity; gratulation; ingrate; ingratiate. It is the hypothetical source of/evidence for its

plotëson me kuptime dhe emër atë që sot quhet gjuhë. Ky thelb i bartjes, madje përmes vjershës, e vë në pikëpyetje të natyrshme kodifikimin e të folurës me shkrim; **pse duhej të shpjegohej komunikiimi nëse gjuha ishte bërë për t'u kuptuar?** Pas kësaj, pyetja e mëparshme se pse shqip nuk i ka shkruar rregullat e retorikës më vete, e çon diskutimin edhe përtej shpjegimit të vetvetes dhe fenomenit të shkrimit në përgjithësi. Provuar të ketë ekzistuar pa shkrim, pra si domen i **paprekshëm dhe pakushtëzueshëm nga shkrimi dhe ndryshimet konvencionale, shqip ofrohet për shpjegim edhe për vetë retorikën si fjalë.** Ne kemi provuar më parë jo pa habi të japim një shpjegim për këtë fjalë¹⁸³, prej nga kuptimi i saj sipas gjedhit me 're', është një shteg tregues jo vetëm për prejar-dhjen e 'retor', sipas marrëdhënies së njohur të aktit gjuhësor me gjendjen e gjuhës, prej nga 'tor' lidhet me boshtin që shpjegon 'torua', çka më tej do të tregonte se vetë 'retorika' si leksemë del nga ushtrimi dhe jo si fjalë e parë. duke hipotekuar mbi gjedhin e njohur ndër-kombëtar të formimit me 're-' (si në formimin 're/form'), duke vënë re për herë të parë se fjalëformuesja 're-' ka kuptimin 'I ri/e re' në shqip, siç e tregon thelbi i gjedhit. Ky kuptim në gjuhët e tjera e bën që pjesëza të jetë vetëm morfemë dhe jo fjalë me kuptim. Duke njohur me këtë fenomenin, që, edhe një pjesëz fjalëformuese ka ende kuptim në procedime konvencionale brenda një sistemi gjuhësor (pra në shqip), ishte e thjeshtë që me kuptim aktiv 're-ja' kuadrohet si fenomen i tregueshëm aktualizimi. Pjesa 're' ka referencë ndaj kuptimit të vet 'i/e re', dhe për shkak të këtij kuptimi arrin ta tregojë kapacitetin e rrënjës 'tor'. Pra nëse ka një aktualizim në çdo përdorim të çdo shkalle e procesi mendor gjuhësor sipas varësisë, analogjisë e funksionalitetit, kapaciteti i çdo akti përmbahet kuptimisht tek 'tor', ndërsa kapaciteti i mundësisë së aktit përmbahet tek 're', çka do të përkonte edhe me kapacitetin e

existence is provided by: Sanskrit grnati "sings, praises, announces;" Avestan gar-"to praise;" Lithuanian giriu, girti "to praise, celebrate;" Old Celtic bardos "poet, singer." Link, https://www.etymonline.com/word/bard#etymonline_v_5240,

¹⁸³ Komnino, Entela, E vërteta për Nolin, Tiranë, 2017

zhvilluar më tej të rhema-s. ‘Tor’ përveç zbërthimit mitik që afron me një nga variantet e fjalës kullë (siç tregohet Kulla e Babelit), në shqip njihet si një fjalë me përdorim për shteg ose kuptim a vetëdije ‘tor/ua’, madje në kuptimin negativ d.m.th., ‘e humbi toruan’ (siç është edhe apeli i ndarjes së gjuhëve). Disa rrafshë njëherësh pro-vojnë origjinimin e fjalës dhe fenomenit retorikë:

- si gjedh,
- si pjesëmarrje kuptimi në morfema fjalëformuese dhe
- si histori fjale e thellë deri tek legjendat, madje
- e përmbajtshme ende në përdorim në shqipen e sotme.

Praktika ende ekzistuese e shqipes është gjithashtu edhe tek fjala që e shënon aktin e komunikimit, ligjërimit. **Paraqitja, mbrojtja dhe marrja e vendimit në të njëjtën fjalë**, ka indikacione në nivel fjale të tregimit të kalimit nga Deus legjislator tek ligji i natyrës dhe natyra e ligjit¹⁸⁴. Me përmbajtjen e kuptimeve të fjalës leg dhe logos dhe ecurisë së pandarë të tyre brenda një fjale, është e mundur të indikohet shumatorja sa më lart: gjuhë etnike si nivel natyre të ligjit, përkundrejt ligjit të natyrës që do paraqiste retorika natyrore ose e kodifikuar dhe të dyja së bashku përkundrejt gjuhës retorike si ‘deus legjislator’. Duke u njafuar në këtë nivel paraqitjeje deri tek faktet e sjella, do të donim ta kujtonim për përmbyllje përkimin e mësipërm të pranisë së trashit tek format e vjetra për ‘true’ në anglisht.

IV. Përfundime:

Gjuha retorike është një fenomen i ekzistuar dhe me gjurmë të qarta në sistemin e folur të shqipes sot.

Prania e saj në inventarin e kategorisë së gjuhëve të veçanta, dallon një gjendje të re, të papërshkruar të asaj që është mbajtur si retorikë deri më sot dhe gjendet si ‘shqip’ deri në shekullin XVII.

¹⁸⁴ Komnino, Entela, ‘E vërteta për Nolin, Tiranë, 2017,

E ndarë që nga Korax e Teisas në rregulla e zbatime, retorika e gjetur në ‘shqip’, përmbys klasifikimet dhe inventarin e shfaqjeve të saj si deri tani.

Fenomeni afron mundësinë e vëzhgimit të procedurave gjuhësore—mendore sipas një vendosjeje tjetër njësish gjuhësore e funksionesh.

Gjuha e sotme që e trashëgon dhe përmban këtë domen, sillet si substancë primare duke përmbajtur në inventar organik e në esencë funksione komunikimi të automatizuara dhe aktive njëkohësisht.

Për ne, pyetja se çfarë aktualizon e folura përkundrejt rregullave në rastin që nuk i njeh rregullat e retorikës, zgjidh si me magji natyrën e ndryshme të asaj që është quajtur retorikë sipas leksemës ‘shqip’.

Literaturë:

—Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1984,

—Hahn, Albanesische Studien, <https://archive.org/details/ahy9953.0001.001.umich.edu>,

—Kommnino, Entela, ‘Përkime retorike në letrat e shqipes’ tek ‘Bulletin shkencor’, 57 (2007)

—Kommnino, Entela ‘E vërteta për Nolin’

—Konica, Faik, Vepra 2, Rilindja 1997, fq. 154

—Matzinger, Joachim, Shqip bei den albanischen Autoren vom 16. bis zum frühen 18. Jahrhundert, <http://www.zeitschrift-fuer-balkanologie.de/index.php/zfb/article/view/337/334>,

—Merriam/webster dictionary, Link, <https://www.merriam-webster.com/dictionary/language>

—Online etymology dictionary, <https://www.etymonline.com/>

BESNIK RAMETI & ISAMET BAKIU

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

KLUBI “BASHKIMI”, PROMOTOR I ZGJIMIT KOMBËTAR

Periudha më e rëndësishme e popullit shqiptar ka qenë ajo e rilindjes kombëtare që ka filluar në vitet e 30-ta të shekullit të XIX-të. Rilindja Kombëtare Shqiptare ndahet në katër faza. Faza e katërt, ka filluar nga viti 1908, me formimin e Klubit “*Bashkimi*” më 31 korrik 1908, dhe mbajtjen e Kongresin e Manastirit, më 14–22 nëntor 1908 për unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe, organizator i së cilës ka qenë Klubi “*Bashkimi*”. Periudha e katërt e Rilindjes, përfundon me aktin e shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912 në Vlorë, që ishte kurorëzim i përpjekjeve të gjithë udhëheqësve dhe veprimtarëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare¹⁸⁵.

Pasojat e mungesës së një alfabeti shqip, ishin të mëdha. Platforma e delegatëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për autonomi në kuadër të Perandorisë Osmane dërguar Kongresit të Berlinit, ishte e shkruar me shkronja arabe dhe si e tillë aspak nuk u mor parasysh nga kancelari gjerman Otto fon Bismarku. Shqiptarët në atë kohë ende nuk kishin një alfabet të unifikuar.

Ideologët dhe veprimtarët si: Pandeli Sotiri, Thimi Mitko, Petro Nini Luarasi Gjerasi dhe Sevasti Qeriaz, Papa Negovani, e shihnin të arsyeshme për shqiptarët hapjen me çdo kusht të shkollës në gjuhën shqipe, e cila filloi me mësim më 7 mars të vitit 1887 në Korçë. Veprimtarët dhe ideologët e Rilindjes Kombëtare gjithmonë

¹⁸⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, v.II, (Rilindja Kombëtare - vitet 30 të shek XIX – 1912), 2002, Tiranë, 2002, f. 510

kanë thirrur në një tubim dhe organizim të përbashkët për të zgjidhur një alfabet të vetëm të gjuhës shqipe për të gjithë shqiptarët¹⁸⁶.

Rolin vendimtar për organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të Manastirit e mori Klubi “*Bashkimi*”, kryesia dhe anëtarët e tij në çdo qytet dhe krahinë të banuar me shqiptarë.

Pjesëmarrja e shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk

Revolucioni xhonturk zë një vend të rëndësishëm në historiografinë e Perandorisë Osmane, por edhe në atë ballkanike. Në maj të vitit 1889 u formua Komiteti i Fshehtë “*Bashkimi e Përparim*” (“*Ittihad ve Terakki*”), programi i Turqve të rij i formuluar në mënyrë më të përcaktuar nga grupi i Ahmed Rizajt, që ishte vendosur në mesin e viteve 90 në Paris, ku nxirrte gazetën “*Meshveret*” (“*Debatet*”)¹⁸⁷.

Është me interes të theksohet se shumë shqiptar, madje disa nga figurat e rëndësishme, si: Ibrahim Temo, themelues i “*Komitetit Bashkimi dhe Përparim*”, Nijazi Resnaja, Heroi i Revolucionit Xhonturk, Mehmet Rauf Leskoviku, dhe shumë nga themeluesit e degëve të tyre në pjesë të tjera njëherësh ishin edhe fuqi lëvizëse e xhonturqve, në të gjitha fazat. Po ashtu ndër veprimtarët e rëndësishëm të Komitetit “*Bashkimi dhe Përparim*” ishin Ismail Qemali, Dervish Hima, Shahin Kolonja, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, dhe të tjerë, të cilët do të luanin rol të rëndësishëm në drejtimin si dhe veprimtarinë e tij nga opozita deri në qeverisje. Derisa xhonturqit erdhën në pushtet me anë të revolucionit të verës së vitit 1908, ku rol përcaktues pati Kuvendi i Ferizajt¹⁸⁸

¹⁸⁶ Po aty, f. 381.

¹⁸⁷ Kontributi i shqiptarëve të Maqedonisë në Revolucionin xhonturk. në: *Shqiptarët e Maqedonisë*, Shkup, 1994, f. 273; *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e cit, f. 371.

¹⁸⁸ Jusuf Buxhovi, *Kosova, Perandoria Osmane*, Libri i dytë, Prishtinë, 2012, f. 348-349

Më 3 korrik të vitit 1908, garnizoni ushtarak i Resnjës, i udhëhequr nga komandanti me prejardhje shqiptare Njiazi Ahmed Beu, filloi kryengritjen duke refuzuar pranimin e pushtetit suprem të Sulltanit. Ngjarjeve të Resnjës menjëherë iu bashkua popullsia e vendit nga Dibra, Kërçova, Struga, Elbasani dhe vende të tjera. Ja një e dhënë konkrete në këtë drejtim, ku konstatohet si vijon: "*Ato (mendohet për efektivet ushtarake) që u ngritën në kryengritjet në Resnjë, gjithashtu hasën në ndihmën e popullsisë maqedonase dhe shqiptare*"¹⁸⁹. Qeveria e Sulltanit me dinakëri reagonte ndaj këtyre ngjarjeve, prandaj e dërgoi gjeneralin e saj, Shemsi Pashën, për të penguar dhënien ndihmë nga shqiptarët kryengritësve të garnizonit të Resnjës. Mirëpo, gjenerali nuk arriti të merr veprimet e planifikuara, sepse kur arriti në Manastir më 7 korrik 1908, u vra nga ana e pjesëtarëve të lëvizjes xhonturke. Gjenerali i vrarë osman u zëvendësua nga Marshalli Osman Feriz Pasha, por edhe ky rrëmbehet nga oficerët xhonturk dhe më pas trajtohet me shumë respekt prej tyre, pasi deklaroi se ishte në favor të shpalljes së kushtetutës¹⁸⁹.

Rol të rëndësishëm ka luajtur Kuvendi i Ferizajt (14 korrik 1908) ku janë mbledhur rreth 15.000 vetë të armatosur, kësaj thirrje ju përgjigjën të gjitha kazatë e Vilajetit të Kosovës të përfaqësuar nga atdhetarë të njohur si Isa Boletini, Ferhat Bej Draga, Bajram Curi, Idriz Seferi, Hasan Prishtina etj. Më 23 korrik pa ardhur ende përgjigja nga Stambolli, kryengritësit shqiptar e shpallën kushtetutën në Manastir, Selanik, Preshevë, Veles dhe në qendrat tjera. Kuvendi i Ferizajt ishte faktor vendimtar që përcaktoi fitoren e Revolucionit të xhonturk korrikut 1908¹⁹⁰.

Prandaj që e arsyeshme që fitorja e Revolucionit Xhonturk u prit me gëzim dhe entuziazëm të madh jo vetëm nga ana e popullsisë turke, por edhe nga kombësitë tjera (veçanërisht shqiptarëve), të cilat deri atëherë jetonin edhe paraqiteshin nën flamurin e Perandorisë Osmane. Nëpër qytetet shqiptare bëheshin manifestime

¹⁸⁹ Mehmet Maksudoglu, *Historia Osmane dhe institucionet*, Tiranë, 2012, f. 502

¹⁹⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e cit, f. 375-377

spontane, duke organizuar një bindje për solidaritet me revolucionin. Kryengritësit shqiptar lëshuan malet dhe të gëzuar u kthyen në shtëpitë e tyre, që ta vazhdojnë në kushte të reja luftën për sigurimin e autonomisë së Shqipërisë¹⁹¹.

Krerët e lëvizjes xhonturke u munduan me të gjitha forcat t'i shmangin manifestimet masive. Këtë e dëshmon qartë qëndrimi i tyre ndaj projekteve për organizimin e manifestimeve në Shkup më 24 korrik, pasi Shkupi do të bëhet qendra e kryengritësve për autonominë e Shqipërisë.¹⁹²

Përfaqësuesit e Rilindjes Kombëtare edhe pse hasën në kundërshtim me kërkesat e tyre në Lëvizjen Xhonturke, vazhduan programin e tyre kombëtar deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Themelimi i Klubit “Bashkimi” (31 korrik 1908) dhe roli i tij

Menjëherë pas shpalljes së Kushtetutës, në ditët e fundit të korrikut të vitit 1908, atdhetarët shqiptarë e panë të arsyeshme se për realizimin e programit kombëtar, duhej me çdo kusht të formohen klube¹⁹³.

Organizatorët kryesor për themelimin e klubit në Manastir ishin atdhetarët Fehim Zavalani, Gjergj Qiriazhi, Qenan Beu, etj. Pas shumë konsultimeve me veprimtarët dhe çetat e armatosura shqiptare, u vendos që emri i klubit të jetë “*Bashkimi*”. Më 31 korrik u themelua Klubi “Bashkimi” i Manastirit, me kryetar Fehim Zavalanin që sapo ishte liruar nga internimi, nënkryetar Gjergj Qiriazhin dhe sekretar Naum Naçin. Ishte ndër klubet më të mëdha dhe më

¹⁹¹Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15 – 21 Nëntor 1962) Tiranë, 1965, f. 75

¹⁹² *Kontributi i shqiptarëve të Maqedonisë në Revolucionin xhonturk*. në: ***Shqiptarët e Maqedonisë***, f. 275

¹⁹³ Dimitër Dishnica, *Veprimtaria dhe kontributi i familjes Qiriazhi në Manastir për zhvillimin e Arsimit e të Kulturë Kombëtare*, në: ***Shqiptarët e Maqedonisë***, Shkup, 1994, f. 311

të rëndësishme, që luajti një rol të veçantë në formimin e klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e regjimit xhonturk.

Menjëherë pas themelimit të tij, Klubi i Manastirit dërgoi në qytetet e tjera të vendit emisarët e vet për të propaganduar idetë kombëtare të shqiptarëve, siç ishin bashkimi i vilajeteve të Shqipërisë dhe ruajtja e tërësisë së saj. Klubi “*Bashkimi*” i Manastirit përbëhej nga përfaqësues të gjitha shtresave të popullsisë, duke përfshirë këtu, atdhetarë, intelektualë, mësues, tregtarë, fshatarë dhe të gjithë shtresat e tjera të popullsisë shqiptare.¹⁹⁴

Brenda një kohë të shkurtër do të themelohen edhe shumë klube nëpër qytetet shqiptare si: Klubi “*Bashkimi*” Shkup dhe klubet me të njëjtin emër në qytetet shqiptare Ohër, Strugë, Dibër, Kumanovë, Tetovë, Shkodër dhe shoqëria “*Bashkimi*” në Bukuresht etj. Të gjitha këto klube kishin një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijesimit kombëtar të popullatës shqiptare. Është me interes të theksohet se për Vilajetin e Kosovës rol të rëndësishëm ka luajtur Klubi “*Bashkimi*” në Shkup, anëtarët e të cilit ishin figura të shquara, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Nexhip Draga, etj. Klubi “*Bashkimi*” në Shkup, u themelua më 1 tetor 1908. Ai kishte *Rregullore*, që përmbante me 26 pika, nga të cilat do të veçojmë:

- *Nyj 5. Ai që linë shok në Klub ka me pasun një diftesë prej Pleqnisë të nënshkrume prej kryetarit, nënkryetarit, shkrimtarit e arkatarit ç'i i doftohetë se asht i njoftunë për shok i Klubit.*
- *Nyj 10. Pleqnia ka me pasë mbledhi dy here në javë e në kioft nevoja edhe ma shpesh për me shikue gjithë punët e nevojshme që duhen me punue për Klub*

¹⁹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e cit, f. 381; Nebi Dervishi, *Manastiri vatër e Rilindjes Kombëtare Shqiptare (shek. XIX- deri 1912)*, Shkup, 2018, f. 58

- *Nyj 15. Pleqnija ka me pasë nji regullore të pasaçme si ka m'u prue në punët e veta e detyrat e veta çu ka me pas gjith e cili prej pleqve.*
- *Nyj 19. Kërkush prej shokve s'ka me mujt me mar noj gjë send të Klubit, për me qitë jashta Klubit*¹⁹⁵.

Qëllimi dhe detyrat e këtij klubi janë theksuar edhe në shpalljen e tij, ku ndër të tjera thuhet: "*ERDHI ÇASTI I PËRSHTATSHËM PËR HISTORINË TONË, JO ME ARMËN E BARUT NË DORË, POR ME PENDË E ME LETËR*".¹⁹⁶

Me veprimtarinë e tyre, klubet dhe komitetet e fshehura luajtën një rol të rëndësishëm në organizimin e lëvizjes kombëtare, në këtë fazë të re të zhvillimit të saj. Me nismën e klubeve për here të parë në historinë e vendit, filluan të botoheshin brenda në Shqipëri dhe në disa qytete tjera të Perandorisë, gazeta në gjuhën shqipe. Në Korçë dolën njëra pas tjetrës Gazeta "*Korça*" (1908–1910), "*Lidhja Ortodokse*" (1909–1910), në Manastir "*Bashkimi i Kombit*" (1909–1910), në Shkup "*Shkupi*" (1910–1912), në Janinë "*Zgjinia i Shqipërisë*" (1909–1910), në Elbasan "*Tomori*" (1910), në Selanik "*Liria*" (1908–1910), "*Shqipëria*" në Stamboll, etj. Pranë Klubit të Manastirit e klubeve tjera u ngritë shtypshkronja për botimin e gazetave dhe të librave shqip. Jashtë Shqipërisë vijuan të botoheshin organe të tilla të rëndësishme të shtypi atdhetar shqiptar si: "*Shqypeja e Shqypnisë*" (1909–1911), në Sofije, në drejtimin e Josif Bagerit, "*Shkopi*" (1907–1908), dhe "*Rufëja*" (1909–1910), në Egjipt "*Dielli*" (1909–1910), në Boston "*Liria e Shqipërisë*" (1910–1915)¹⁹⁷.

Vlen të theksohet, se në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit 1908, shoqëria "*Bashkimi*" e Bukureshtit dërgoj në Shqipëri (Klubit

¹⁹⁵ *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Shkup (1908-1912)*, Dokumente, Shkup, 2012, f. 27-30

¹⁹⁶ Nebi Dervishi, *Klubet Kombëtare në Vilajetin e Manastirit, dhe Kosovë, (gusht 1908, dhjetor 1909)*, në: Gazeta "*Lajm*", Shkup 25.10.2012, f. 13

¹⁹⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e cit, f. 384

të Manastirit), 20.000 copë abetare e libra të tjerë shqip. Në Korçë, brenda disa javësh u shitën 15.000 abetare shqip. Kristo Luarasi në një nga letrat e tij, më 4 gusht shkruante se përveç 400 librave që kishte bërë gati për t'i dërguar në Shqipëri, do të çonte në Tiranë edhe 1.000 abetare gegërisht, dhe 800 libra të tjera që i kishte gati në Sofje. Më të kërkuarit ishin librat e Sami Frashërit, si “*Abetarja*”, “*Shkronjëtorja*”, “*Dheshkronja*”, “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*”. Librat e Naim Frashërit, “*Bagëti dhe Bujqësi*”, “*Lulet e verës*”, “*Skënderbeu*”. Librat e e Jani Vretos “*Mirëvetja e Numërtorja*”, e Gjergj Qiriazit “*Fizika*”¹⁹⁸.

Klubi “Bashkimi”, organizatori i Kongresit të Manastirit (14–22 Nëntor, 1908)

Pas shpalljes së kushtetutës së re më 23 korrik 1908, dhe formimit të Klubit “*Bashkimi*” të Manastirit më 31 korrik 1908, dhe hapja e klubeve tjera në të gjitha qendrat shqiptare të cilat morën iniciativë për ngritjen e shtypshkronjave për botimin e gazetave dhe librave në gjuhën shqipe, gjithashtu dhe hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe, tanimë ishte e nevojshme të krijohet unifikimi i alfabeti i gjuhës shqipe. Bartës kryesor për thirrjen e kongresit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe ishte Klubi “*Bashkimi*” i Manastirit, që luante rolin kryesor ndërmjet klubeve shqiptare¹⁹⁹.

Klubi “*Bashkimi*” i Manastirit, vendimin për thirrjen e një kongresi të tillë e mori në mbledhjen e kryesisë, me datë 22 gusht 1908, por zëdhënien (thirrjen) për mbajtjen e Kongresit e publikoi gjashtë ditë më vonë, pikërisht më 27 gusht 1908²⁰⁰.

Thirrja u shpërnda brenda dhe jashtë Shqipërisë, që të merrnin pjesë në Kongres. Kjo thirrje u pritë mire nga atdhetarët shqiptarë,

¹⁹⁸ *Po aty*, f. 390

¹⁹⁹ *Historia e Popullit Shqiptar II*, vep. e cit, f.391.

²⁰⁰ N. Dervishi, *Manastiri vatër e Rilindjes Kombëtare Shqiptare (shek. XIX- deri 1912)*, f. 65

klubet dhe shoqëritë patriotike brenda dhe jashtë vendit, që u trenguan të gatshëm të dërgonin përfaqësuesit e tyre në këtë Kongres²⁰¹.

Ky kongres i ftonte të bashkoheshin, “*Se pa ndihmën tuaj dhe të gjithë vëllezërve shqiptarë, nuk do të bëjm dot kaq punëra sa dëshirojmë*”. Kongresi i Manastirit punimet i filloi më 14–22 nëntor 1908, në kongres morën pjesë 32 delegat me të drejt vote që përfaqësonin 26 qytetet dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejt vote. Manastiri më 14 nëntor ishte qendra e takimit të figurave dhe personaliteteve më të shquara të popullit shqiptar, të cilët arritën nga të gjitha anët e Shqipërisë, Turqia, Amerika, Italia, Egjipti, Greqia, Rumania etj. Kjo ishte dita kur u takuan Mit’hat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Sotir Peci, e shumë të tjerë për të vënë themelet e alfabetit të përbashkët të gjuhës shqipe²⁰².

Kryetari i Komisionit u zgjodh Gjergj Fishta, u propozuan tri alfabetë, më vonë komisioni për mos me bërë përçarje, u pajtua si zgjidhje të jenë dy alfabetë, duke pranuar alfabetin e Stambollit dhe atë me shkronja latine.

Klubi Qendror “*Bashkim*” i Manastirit i cili me një “Qarkore”, drejtuar klubeve “*Bashkim*”, u theksonte shqiptarëve: “*Nuk duhej premtue kurësesi qi ndërnyjet shqiptarëve të dalin ngatresa e të lenë disa për shkak të alfabetit*”, duke theksuar se: “*Tashti për tashti, detyra jonë ma kryesore asht me përhapur në popullinë tone dritën e arsimit, me e forcu bashkimin tonë, e me ju rujt ndasisë*”. Atë që nuk e çoj dot deri në fund Kongresi i Manastiri, e zgjodhi përfundimisht vetë jeta e popullit shqiptar, alfabetin e thjesht latin.²⁰³

²⁰¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep. e cit, f. 392.

²⁰² D. Dishnica, *Veprimtaria dhe kontributi i familjes Qiriazi në Manastir...*, në: *Shqiptarët e Maqedonisë*, f. 311

²⁰³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vep e cit, f.394.

Klubi “*Bashkimi*” i Manastirit dhe klubet simotra në dhjetëra vendbanime shqiptare, luajtën rol të jashtëzakonshëm në zgjimin kombëtarë të shqiptarëve, të cilët si kurrë më parë i hapën horizontet e reja të dijes dhe emancipimit, duke u orientuar drejt vlerave evropërendimore.



Komisioni i Alfabetit të Manastirit, 1908 (foto Kel Marubi):

1. Gjergj Fishta, kryetar i Komisionit
2. Mit'hat Fashëri, kryetar i Kongresit, sekretar i Komisionit
3. Luigj Gurakuqi, anëtar i Komisionit
4. Gjergj Qiriazi, anëtar i Komisionit
5. Ndre Mjedja, anëtar i Komisionit
6. Gligor Cilka, anëtar i Komisionit
7. Taqi Buda, anëtar i Komisionit
8. Shahin Kolonja, anëtar i Komisionit
9. Sotir Peci, anëtar i Komisionit
10. Bajo Topuilli, anëtar i Komisionit
11. Nyzhdet Vrioni, anëtar i Komisionit.

Botues:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 23 – 2018

Kryeredaktor: Dr. Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky vëllim i 'Scupi-t' botohet me vendimin nr. 0201–492/9
të Këshillit të ITSHKSH–Shkup, në mbledhjen e mbajtur
më 09.11.2018

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

811.18'351(497.784)"1908"(062)
323.1(=18:497)(062)

NJËQIND e dhjetë vjet
110-vjet alfabet shqip : (aktivitete të mbajtura më
21-22.11.2018 në Shkup dhe Manastir) / [kryeredaktor Sevdail Demiri]. -
Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve,
2018. - 186 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v 23)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-82-0

1. Гл. ств. насл.

а) Битолски конгрес - Албански јазик - Унифицирана азбука - 1908 -
Собири б) Албанци - Национален идентитет - Балкан - Собири
COBISS.MK-ID 109150474